



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT**

Nr.434/6 Prot.

Tiranë, më 30/12/2020

Miratohet

**ARBEN SHEHU**

**RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS  
KRYETAR  
“ECURIA E BORXHIT TATIMOR”**



**Publik:** Ky dokument është pronësi e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ai përmban informacion publik dhe qëllimi i tij është transparenca tek palët e interesuara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin 154/2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Çdo citim i këtij dokumenti të bëhet referuar burimit të tij zyrtar.

*Adresa: Rruga “Abdi Toptani”, nr. 1, Tiranë*

## **RAPORT AUDITIMI**

### **“Ecuria e borxhit tatimor”**

---

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nr. 434/1 prot., datë 20.07.2020.

Projekt-raporti i auditimit mori formë përfundimtare më 09.10.2020 dhe iu dërgua subjektit nën auditim me shkresë nr. 434/2 prot., në përputhje me standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës e konkretisht; Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Prononcimet Profesionale të Auditimit të Performancës ISSAI 300, 3000, 3910, Kreun 6 të Manualit të Departamentit të Auditimit të Performancës, Indikatorët e Performancës, si edhe Rregulloren Institucionale të Procedurave të Auditimit.

Në përputhje me Ligjin 154/2014, në respektim të afatit 1-mujor, grupi i auditimit priti observacionet nga subjekti nën auditim. Me anë të shkresës nr. 434/3 prot., datë 13.11.2020, subjekti përcolli observacionet e tij, të cilat në përputhje me bazën ligjore e rregullatore të KLSH-së, kanë marrë përgjigje eksplicite me shkrim në raportin përfundimtar të auditimit.

Auditimi është kryer nga grupi i auditimit:

1. Znj. M. K (përgjegjëse e grupit të auditimit);
2. Znj. V.S (anëtare);
3. Znj. XH.K (anëtare).

## PËRMBAJTJA

1. Rëndësia e Auditimit.....	6
1.1 Konteksti i Problemit Social.....	6
1.2 Strategjia e KLSH-së në Auditimet e Performancës.....	7
1.3 Auditime të Mëparshme në këtë Fushë.....	8
1.4 Subjekti nën Auditim.....	8
1.4.1 Hyrje.....	9
1.4.2 Politikat e Institucionit .....	11
1.4.3 Peshat në buxhet dhe PBB.....	12
1.4.4 Risqet e aktiviteteve të subjekteve .....	14
1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjektit .....	15
1.4.6 Feedback-u i subjektit në fazën studimore .....	16
2. Qasja dhe Detajet e Auditimit.....	16
2.1 Objektivi dhe Problemi i Performancës.....	16
2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit.....	16
2.1.2 Objektivi i auditimit .....	19
2.3 Burime të Krieteve.....	21
2.3.1 Kriteret politike.....	21
2.3.3 Kriteret teknike .....	21
2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit.....	22
2.3.3 Kriteret e tjera/ Praktikave më të mira.....	22
2.4 Piramida e Pyetjeve Audituese.....	24
2.5 Qasja/Metodologjia e Auditimit.....	25
2.5.1 Metodatat/teknikat audituese.....	25
2.6 Rezultatet e parashikuara.....	25
2.6.1 Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë.....	25
2.6.2 Impakti për publikun dhe palët e interesit .....	26
2.6.3 Forma e publikimit .....	26
3. Shtjellimi i Piramidës së Pyetjeve Audituese.....	27
3.1 A është realizuar planifikimi i duhur për menaxhimin e borxhit tatimor?.....	27
3.1.1 A janë formuluar siç duhet Planet strategjike dhe ato operacionale për mbledhjen e borxhit tatimor?.....	27
3.2 A ka rezultuar efektiv implementimi i masave për mbledhjen e borxhit tatimor?.....	42
3.2.1 A janë zbatuar në mënyrë shteruese masat për menaxhimin e borxhit tatimor? .....	42
3.2.2 A është përmirësuar mbledhja e borxhit tatimor gjatë periudhës nën auditim? .....	73
4. Përmbledhje.....	101
5. Grupi i Punës dhe Përgjegjësitë Hierarkike .....	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>

## 📌 LISTA E SKEMAVE, GRAFIKËVE DHE TABELAVE

Skema 1: Organigrama e Pjesshme e Administratës Tatimore, Strukturat e Menaxhimit të Detyrimeve Tatimore të Papaguara .....	11
Skema 2: Modeli Logjik .....	18
Figura 1: Të ardhurat e taksave totale të fundvitit si përqindje e totalit të të ardhurave neto, 2017.....	96
Figura 2: Prapambetjet e taksave të arkëtueshme të fundvitit si përqindje e prapambetjeve të tatimeve të fundvitit, 2017.....	97
Grafiku 1: Borxhi tatimor si % ndaj shpenzimeve buxhetore dhe PPP.....	13
Grafiku 2: Borxhi sipas llojit të tatimit pa proceset gjyqësore.....	79
Grafiku 3: Borxhi tatimor viti 2016 krahasuar me vitin 2017.....	80
Grafiku 5: Stokut të borxhit sipas moshës dhe vlerës respektive më datë 31.12.2017.....	80
Grafiku 6: Gjendja e borxhit sipas llojit të tatimit.....	84
Grafiku 7: Borxhi sipas llojit të Tatimit viti 2017-2018.....	85
Grafiku 8: Mosha e borxhit.....	85
Grafiku 9: Borxhi sipas llojit të Tatimit viti 2018 -2019.....	86
Grafiku 10: Trendi i borxhit.....	91
Grafiku 11: Mosha e borxhit.....	92
Tabela 1: Borxhi Tatimor si Përqindje ndaj të Ardhurave Tatimore Vjetore .....	7
Tabela 2: Detyrimet e papaguara tatimore në raport me shpenzimet buxhetore .....	12
Tabela 3: Detyrimet e papaguara tatimore në raport me PBB .....	13
Tabela 4: Analiza SWOT.....	14
Tabela 5: Kategorizimi i riskut .....	14
Tabela 6: Aktivitetet, Indikatorët, Afatet dhe Strukturat Përgjegjëse sipas Planit Strategjik 2017-2021.....	29
Tabela 7: Numri i punonjësve dhe fondi i pagave për DMDTP për vitin 2017 .....	38
Tabela 8: Numri i punonjësve dhe fondi i pagave për DMDTP për vitin 2018 .....	39
Tabela 9: Numri i punonjësve dhe fondi i pagave për DMDTP për vitin 2019 .....	39
Tabela 10: Delegimi në nivel drejtues sipas DRT-ve.....	40
Tabela 11: Numri i trajnimeve për punonjësit e DMDTP për çdo DRT për vitet 2017-2019 .....	41
Tabela 12: Totali i stokut të borxhit tatimor dhe stoku i borxhit i marrë në shqyrtim nga grupi i auditimit, 2017-2019 .....	43
Tabela 13: Të dhëna mbi 20 tatimpaguesit e marrë në shqyrtim, në 13 DRT.....	45
Tabela 14: Borxhi jo i ndjekur me masa shtrënguese në DRT Dibër, gjatë viteve 2017-2019.....	46
Tabela 15: Borxhi jo i ndjekur me masa shtrënguese, në DRT Dibër gjatë vitit 2019 .....	47
Tabela 16: Tatimpaguesit debitorë për të cilët nuk ka patur përgjigje nga ish-ZRPP-të/ASHK dhe DRSHTRR-të/DPSHTRR.....	54
Tabela 17: Borxhi dhe fitimi i tatueshëm neto 2017-2019 për subjektin “ALB-MI” .....	59
Tabela 18: Akt-marrëveshjet e lidhura sipas numrit, llojit dhe vlerës për çdo lloj detyrimi të lidhur për vitet 2017-2019 .....	62
Tabela 19: Përmbledhëse e Akt-Marrëveshjeve për çdo DRT për vitin 2017 .....	63
Tabela 20: Përmbledhëse e Akt-Marrëveshjeve për çdo DRT për vitin 2018. ....	64
Tabela 21: Përmbledhëse e Akt-Marrëveshjeve për çdo DRT për vitin 2019. ....	65
Tabela 22: Akt - marrëveshjeve të lidhur në mënyrë të përsëritur për të njëjtin tatimpagues, sipas DRT-ve, për vitin 2018. ....	67
Tabela 23: Akt - marrëveshjeve të lidhur në mënyrë të përsëritur për të njëjtin tatimpagues, sipas DRT-ve, për vitin 2019. ....	67
Tabela 24: Akt-Marrëveshjet e anuluar, për të cilat janë paguar 0 këste, sipas DRT-ve, në vitin 2018. ....	68
Tabela 25: Akt-Marrëveshjeve e anuluar, për të cilat janë paguar 0 këste, sipas DRT-ve, në vitin 2019....	70

Tabela 26: Detyrimet tatimore të papaguara të vitit 2017.....	77
Tabela 27: Detyrimet tatimore të papaguara dhe në proces gjyqësor 2017 .....	77
Tabela 28: Detyrime të mbajtura jashtë sistemit .....	78
Tabela 29: Krahasimi midis viteve 2017 dhe 2016 për gjendjen e stokut në fund të vitit 2017 krahasuar me vitin 2016.....	80
Tabela 30: Borxhi i regjistruar më 31.12.2017 i ndarë sipas llojit të pronësisë .....	81
Tabela 31: Detyrimet tatimore të papaguara në vitin 2018.....	82
Tabela 32: Gjendja e borxhit në fund të vitit 2018 sipas DRT-ve.....	84
Tabela 33: Borxhi i regjistruar më 31.12.2018 i ndarë sipas llojit të pronësisë.....	85
Tabela 34: Detyrimet tatimore të papaguara viti 2019.....	86
Tabela 35: Mosha e borxhit.....	87
Tabela 36: Borxhi i regjistruar më 31.12.2019 i ndarë sipas llojit të pronësisë.....	87
Tabela 37:Trendi i borxhit për vitet 2017 -2019.....	90
Tabela 38: Detyrimet tatimore të papaguara nga viti 2017-2019, progresive deri më 31.12.2019 sipas DRT-ve.....	90
Tabela 39: Subjektet aktive dhe pasive.....	91
Tabela 40: Mosha e Borxhit.....	92
Tabela 41: Borxhi më i vjetër se 2-vite.....	93
Tabela 42: Efektiviteti i masave shtrënguese ndër vite .....	93
Tabela 43: Arkëtimet në raport me fondine pagave të shpenzuar për strukturat e mbledhjes me force .....	99

#### ✂ LISTA E SHKURTIMEVE

AT	Administrata Tatimore
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
3E	Ekonomiciteti, Eficienca, Efektiviteti
BE	Bashkimi Evropian
C@TS	<i>Custom and Taxation System</i>
DHT	Drejtoria e Hetimit Tatimor
DMDTP	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPSHTRR	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
DRSHTRR	Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DRT	Drejtori Rajonale Tatimore
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GDP	Prodhimi i Brendshëm Bruto ( <i>Gross Domestic Product</i> )
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit ( <i>The International Organisation of Supreme Audit Institutions</i> )
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ( <i>International Standards of Supreme Audit Institutions</i> )
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik ( <i>The Organisation for Economic Co-operation and Development</i> )
PS 2017-2021	Plani Strategjik i DPT-së 2017-2021
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
ZVRPP	Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

## **1. RËNDËSIA E AUDITIMIT**

Auditimi në përgjithësi ka të bëjë me ekzaminimin sistematik dhe të pavarur të dokumentacionit tërësor të një institucioni, ndërsa auditimi i performancës lidhet me auditimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit dhe synon, krahas të tjerave, formalizmin e ekonomisë, mirëmenaxhimin e financave dhe fondeve publike, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe përdorimit të tyre, në luftë me abuzimin dhe shpërdorimin, vjedhjen dhe korrupsionin dhe keqpërdorimin e tyre.

KLSH, nëpërmjet auditimeve, bën transparente përdorimin e fondeve publike, administrimin e pronës publike dhe burimeve natyrore kombëtare, kryerjen në kohë, me cilësi dhe kosto optimale të shërbimeve publike, etj. Kryerja e auditimeve në përgjithësi dhe atyre të performancës në veçanti nga KLSH bëhet në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe EUROSAI, të cilat gjejnë pasqyrim në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2018-2022.

Me shtimin e zhvillimeve të reja të cilat sjellin me vete edhe risqe të reja, auditimi i performancës sa vjen edhe bëhet më i rëndësishëm për të siguruar mbrojtjen e interesit publik. Për këtë, Kontrolli i Lartë i Shtetit gjithmonë e më shumë po vendos theksin në rritjen e numrit dhe të cilësisë të auditimeve, veçanërisht atyre të performancës. KLSH është në linjë me konkluzionet dhe rekomandimet e rezolutave dhe kongreseve të INTOSAI-t për një qasje gjithëpërfshirëse drejt auditimeve të performancës dhe inkurajim për auditime të përbashkëta dhe për një shkëmbim më intensiv të njohurive.<sup>1</sup>

Në përputhje me këtë prioritet, krahas Departamentit të Performancës, edhe Departamentet e tjera në KLSH kanë nisur të kryejnë auditime performance. “Ecuria e borxhit tatimor”, është një auditim performance i cili u krye nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit në KLSH, në bashkëpunim me Departamentin e Auditimit të Performancës.

Ky auditim kishte në fokus menaxhimin e detyrimeve tatimore të papaguara në afat nga taksapaguesit debitorë, si një çështje me rëndësi nga pikëpamja e financave publike, gjithashtu edhe nga ana e funksionimit të administratës tatimore. Rritja e detyrimeve të papaguara tatimore, reflektohet në më pak të ardhura të vjelura për buxhetin e shtetit me anë të të cilave financohen investimet, të mirat dhe shërbimet publike, etj.

Nëpërmjet këtij auditimi, KLSH vlerësoi performancën e mbledhjes së borxhit tatimor referuar të dhënave dhe analizave të subjekteve nën auditim, indikatorëve dhe indekseve ndërkombëtare, plotësinë dhe përshtatshmërinë e strukturave përgjegjëse, zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për menaxhimin e detyrimeve tatimore të papaguara dhe ndërmarrjen e masave shtrënguese nga administrata tatimore me qëllim mbledhjes e tyre.

Bazuar në sa më sipër, si dhe në faktin që Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me funksionin e tij kushtetues, ka për kompetencë auditimin me qëllim mbrojtjen e interesave publike, Departamenti i Auditimit të Buxheti të Shtetit në KLSH ndërmori auditimin e performancës me temë “ Ecuria e borxhit tatimor”.

Nëpërmjet këtij auditimi, i cili përfshiu një periudhë tre-vjeçare (01.01.2017-31.12.2019) dhe shqyrtoi kuadrin ligjor dhe rregullator, strukturat përgjegjëse, si dhe masat e ndërmarrja për të menaxhuar mbledhjen e detyrimeve të papaguara tatimore, u dhanë rekomandime në drejtim të përmirësimit të procesit të mbledhjes së tyre.

### **1.1 KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL**

Paratë e siguruar nga tatimet dhe taksat janë të ardhurat kryesore në buxhetin e një shteti, për të financuar shpenzimet publike. Në vendin tonë, Administrata tatimore (e cila përfshin Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe drejtoritë rajonale) është e ngarkuar me administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel kombëtar dhe vendor. Referuar vlerësimeve të kryera nga OECD, vendet në zhvillim kanë një nivel të ulët të të ardhurave tatimore që variojnë 10-20% e PBB-së. Përkundrazi, në vendet të zhvilluara, taksat e ardhurave tatimore 15% e PBB-së, konsiderohet si pragu nën të cilin qeveritë

---

<sup>1</sup> KLSH: Strategjia e Zhvillimit Institucional 2018-2022, fq. 37.

bashkëkohore e kanë të vështirë të financojnë funksionimin dhe shërbimet e tyre themelore.<sup>2</sup> Nga vlerësimet e kryera nga grupi i auditimit, për vitin 2019 të ardhurat e mbledhura nga tatimet në vendin tonë, ishin rreth 15% e PBB-së, normë e cila është në pragun e financimit me vështirësi të shërbimeve dhe të mirave publike.

Në këto kushte, për vendin tonë bëhet edhe më e rëndësishme mbledhja e detyrimeve tatimore nga subjektet debitoare, të cilat kanë një peshë të konsiderueshme krahasuar me të ardhurat tatimore vjetore. Mbledhja efektive dhe efiçente e borxhit tatimor është një nga funksionet më të rëndësishme të Administratës Tatimore. Për vitin 2019, referuar të dhënave të TADAT-FMN (të vëna në dispozicion grupit të auditimit, nga DPT) detyrimet tatimore të papaguara në afat ishin rreth 45% e të ardhurave vjetore tatimore, tregues i cili ka ardhur në rritje nga viti në vit.

Tabela 1: Borxhi Tatimor si Përqindje ndaj të Ardhurave Tatimore Vjetore

	(mln lekë)		
Të dhënat/vitet	2017	2018	2019
Të ardhurat tatimore vjetore	228,578	246,577	259,461
Borxhi tatimor vjetor	95,506	107,701	116,994
Borxhi si % e të ardhurat tatimore	42%	44%	45%

Burimi: DPT

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në vitin 2017 u miratua Plani i ri Strategjik i DPT-së, sipas të cilit mbledhja efektive dhe efiçase e borxhit tatimor është një nga nën-objektivat strategjik të DPT-së për periudhën 2017-2021. Në po të njëjtin vit u miratua edhe ligji i ri për faljen/shuarjen e një pjese të detyrimeve tatimore të papaguara.<sup>3</sup>

Me gjithë sa më sipër, gjatë periudhës 2017-2019 stoku i borxhit tatimor në vendin tonë ka vijuar të rritet si në vlerë, ashtu edhe në numër subjektësh debitoare. Detyrimet e papaguara tatimore në fund të vitit 2019 ishin 117 mld. lekë dhe i përkasin 151,279 subjekteve debitoare nga 137,633 subjekte debitoare që rezultojnë në fund të vitit 2017.

## 1.2 STRATEGJIA E KLSH-SË NË AUDITIMET E PERFORMANCËS

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të objektivave të parashtruara në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022, në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit (ISSAI) dhe praktikave më të mira evropiane, si një ndër sfidat kryesore të tij ka përcaktuar shtimin e numrit të auditimeve të performancës dhe përmirësimin e cilësisë së këtyre auditimeve.

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Prononcimet Profesionale të Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3910 & 3920), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas eksperiencës britanike dhe praktikat më të mira audituese në Evropë, të cilat shërbejnë si udhërrëfytes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performancë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të

<sup>2</sup> Instituti i Studimeve të Zhvillimit, Mbretëria e Bashkuar: “Barrierat në rritjen e të ardhurave tatimore në vendet në zhvillim”, 2017, fq. 3.

<sup>3</sup> Ligji nr.33/2017, datë 19.04.2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore.”

institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficientia dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

Në linjë me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022 për të gjeneruar një numër më të madh auditimesh performance, me një fokus në rritje për çështjet makro-ekonomike, krahas atyre mikro-ekonomike, si dhe duke realizuar auditime procesi më shumë sesa auditime institucioni<sup>4</sup>, etj., KLSH ndërmori auditimin "Ecuria e borxhit tatimor". Ky është një auditim performance i cili u krye nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit, në bashkëpunim me Departamentin e Auditimit të Performancës.

Si një çështje me ndikim të rëndësishëm në të ardhurat e buxhetit të shtetit e rrjedhimisht në të mirat dhe shërbimet publike ofruar qytetarëve shqiptar, KLSH nëpërmjet këtij auditimi synoi të paraqesë situatën aktuale në mbledhjen e detyrimeve të papaguara tatimore, masat e ndërmarra në këtë drejtim nga strukturat përgjegjëse dhe rezultatet e arritura, si dhe të japë rekomandime për të përmirësuar aty ku ishte e mundur.

### **1.3 AUDITIME TË MËPARSHME NË KËTË FUSHË**

KLSH bazuar në ligjin e tij organik ka kryer periodikisht çdo vit auditime ligjshmërie dhe përputhshmërie në fushën e sistemit tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe organet e saj të varësisë, drejtoritë rajonale tatimore. Gjatë vitit 2017 dhe 2018, nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit, janë ushtruar në DPT auditimi me temë: "*Mbi Përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë*" dhe në vitin 2019 auditimi me temë: "*Mbi Përputhshmërinë*" në DPT.

Nga auditimet e ushtruara ka dalë se mbikëqyrja dhe mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara të subjekteve tatimpaguese ka qenë e dobët dhe nuk zbatohen me përpikëri të gjitha hapat dhe mekanizmat e përcaktuar në legjislacionin tatimor, për të siguruar mbledhjen e tyre.

Gjatë vitit 2017, nga Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH, është ushtruar një auditim performance në DPT dhe MFE me temë: "*Efektiviteti i masave të marra nga Organet Tatimore në mbledhjen e detyrimeve të papaguara tatimore të subjekteve tatimpaguese*". Mesazhi i këtij auditimi ishte:

*"Menaxhimi i detyrimeve tatimore të papaguara në afat nga Administrata Tatimore Qendrore ka patur mangësi të theksuara. Rritja e lartë e këtij treguesi si në numër subjektësh dhe në vlerë ka ardhur si pasojë e efektivitetit të ulët të masave organizative dhe shtrënguese, duke rritur së tepërmi detyrimet me vjetërsi mbi 2 vjet dhe pamundësinë e arkëtueshmërisë së tyre, duke ndikuar kështu edhe në mosvjeljen e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka krijuar kushtet për zbatimin efikas të masave ligjore në mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara në afat nga drejtoritë rajonale dhe veprimtaria mbikëqyrëse dhe kontrolluese e saj ndaj drejtorive rajonale në drejtim të grumbullimit të detyrimeve tatimore të papaguara ka qenë e dobët. Në situatën aktuale, bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore ka qenë i pjesshëm si pasojë e mangësive në dispozitat ligjore përkatëse dhe pengesave të nxjerra prej tyre, duke ndikuar kështu pak në mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara në afat."*

"Ecuria e borxhit tatimor" është auditimi i dytë i performancës i fokusuar në problematikën e rëndësishme dhe shqetësuese për realizimin e të ardhurave të buxhetit të shtetit, siç është administrimi i detyrimeve tatimore të papaguara si nga pikëpamja e financave publike, ashtu edhe nga ana e funksionimit të administratës tatimore.

### **1.4 SUBJEKTI NËN AUDITIM**

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është një institucion shtetëror, i cili administron sistemin tatimor në Shqipëri në përputhje me objektivat e qeverisë dhe strategjinë e Financave Publike duke nxitur përmbushjen vullnetare dhe duke kërkuar nga të gjithë kuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore.

Subjekt i këtij auditimi ishin Administrata Tatimore qendrore dhe rajonale, me fokus strukturat përkatëse për menaxhimin e detyrimeve të papaguara tatimore, si Drejtoritë apo Sektorët e

---

<sup>4</sup> Strategjia e Zhvillimit Institucional 2018-2022 KLSH, fq. 39

Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara. Me qëllim për të mbledhur detyrimet e papaguara tatimore, DMDTP duhet të bashkëpunojë edhe me struktura të tjera brenda administratës tatimore. Për këtë, subjekt i këtij auditimi ishin edhe njësi të tjera brenda administratës tatimore, të cilat bashkëpunojnë dhe janë të përfshira në menaxhimin e detyrimeve tatimore të papaguara, në varësi të nevojave që lindën gjatë realizimit të auditimit.

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara si në DPT dhe DRT është e organizuar dhe funksionon në zbatim të Rregullores së Brendshme të DPT “Për miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin e administratës tatimore qendrore” dhe të “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Tatimore Rajonale” miratuar me Urdhërin nr. 19, datë 22.02.2017 të ish Titullarit të MFE.

### 1.4.1 Hyrje

**Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (ish-DMF)**, si struktura kryesore e DPT që merret me menaxhimin e detyrimeve të papaguara nga subjektet tatimpagues ka si objekt udhëheqjen metodologjike dhe monitoruese mbi DRT në lidhje me mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara.

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve realizon detyrat e mëposhtme:

- Përbush detyrat dhe funksionet duke zbatuar parimin e analizës së riskut, me koston më të ulët të mundshme, ndërkohë që sigurohet respektimi i të drejtave të tatimpaguesve.
- Mbështet Drejtoritë Rajonale dhe siguron zgjidhje për problemet e hasura nga ana e tyre gjatë procedurave të mbledhjes së detyrimeve tatimore.
- Zgjidhjet e ofruara duhet të jenë në përputhje me ligjin e Procedurave Tatimore në R.SH, i ndryshuar, të kuptueshme dhe të menaxhueshme.

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtori të Përgjithshme të Tatimeve përbëhet nga:

✚ Sektori i Menaxhimit & Analizës së Detyrimeve të Papaguara;

✚ Sektori i Monitorimit të Marrëveshjeve.

● Sektori i Menaxhimit & Analizës e Detyrimeve të Papaguara ka si objektiva:

- Hartimin e planeve menaxhuese të mbledhjes së detyrimeve të papaguara, zbatimin me korrektesë të Manualit të Mbledhjes, përpunimin e informacionit të ardhur dhe raportimin;
- Propozon masa apo zgjidhje me qëllim përmirësimin e mbledhjes dhe administrimit të detyrimeve të papaguara
- Bashkërendimin e punës me Drejtoritë Rajonale, si dhe me drejtoritë e tjera në DPT. Përgatitjen e materialeve për zbatimin e ligjit dhe zgjidhjen e fenomeneve të hasura;
- Evidentimin e problematikave dhe zgjidhjen e trajtimin e rasteve që hasen në praktikë, orientimin e strukturave të varësisë dhe hartimin e qarkoreve dhe qëndrimeve unifikuese për rastet e hasura në praktikë;
- Rekomandimin e masave apo zgjidhjeve me qëllim përmirësimin e mbledhjes dhe administrimit të detyrimeve të papaguara;
- Përgatitjen e raporteve dhe strategjive bazuar në analizën e riskut; etj.
- Sektori i Monitorimit të Marrëveshjeve kryen:
  - Mbledhjen e informacionit nga Drejtoritë Rajonale, për çështje të cilat lidhen me marrëveshjet e pagesës me këste. Përpunimin e informacionit të grumbulluar, dhe hartimin e raporteve dhe evidencave përmbledhëse, në bazë të nevojave për informacion që ka funksionimi i Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë, apo edhe sektorë ose palë të tjera të interesuara.
  - Mbajnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, regjistër përmbledhës për të gjitha marrëveshjet e pagesës me këste, lidhur nga çdo DRT, dhe monitorojnë zbatimin korrekt, siç parashikon ligji, të të gjitha marrëveshjeve të lidhura.
  - Hartimin e qarkoreve të ndryshme për çështje specifike të cilat lidhen me përmirësimin e funksionimit të mbledhjes së detyrimeve nëpërmjet marrëveshjeve të pagesës me këste.

- Identifikimin e problemeve të lindura gjatë zbatimit të procedurave, dhe ofrimin e alternativave për zgjidhjen e këtyre problemeve,
- Ndihmesa ndaj drejtorive rajonale për procedurat ligjore lidhur me çështje të marrëveshjeve të pagesës me këste.  
Nëpërmjet vizitave në DRT:
- Monitoron dhe ndjek zbatimin e procedurave siç parashikohen në ligj, rregullore, dhe Manualin e Mbledhjes me Forcë të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, për mbledhjen e detyrimeve tatimore, me anë të marrëveshjeve të pagesës me këste;
- Ofron këshillime dhe udhëzime të specializuara për marrëveshjet të cilat lidhen me tatimpagues në kushte të veçanta, përfshirë hartimin e përbashkët të marrëveshjes.
- Analizon dhe kontrollon në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme mbi ecurinë e punës dhe performancën e sektorit të marrëveshjeve në DRT, si dhe përcaktimin e detyrave për përmirësimin e mëtejshëm të punëve për periudhat në vazhdim.
- Për kontrollet në DRT, harton raporte përmbledhëse për monitorimet e kryera, të cilat ja drejton Drejtorit të Mbledhjes me Forcë, apo edhe Drejtorit Rajonal, ku përfshihen, identifikimi i problematikave të hasura dhe sugjerimet për përmirësimet e nevojshme procedurale, lidhur me mirë funksionimin e Sektorit të Marrëveshjeve.

**Drejtoria/Spektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara** në DRT ka si objekt kryesor mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara, menaxhimin e borxhit me qëllim reduktimin e tij dhe mos krijimin e borxhit të ri.

Struktura e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara është e organizuar si sektor në 7 DRT, dhe si drejtori në 6 DRT.

Nga DRT-të, subjekt i këtij auditimi ishin Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe DRT Tirana. Një pjesë e pyetësorëve që grupi i auditimit realizoi iu dërguan të gjitha Drejtorive Rajonale Tatimore.

Detyrat kryesore të kësaj strukture janë:


- Përbush detyrat dhe funksionet duke zbatuar parimin e analizës së riskut, me koston më të ulët të mundshme, ndërkohë që sigurohet respektimi i të drejtave të tatimpaguesve;
- Mban në monitorim dhe ndjek borxhin duke synuar uljen e tij, veçanërisht të borxhit të ri, por edhe atë të vjetër në të njëjtën kohë; etj.

Drejtoria/Spektori i Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtorinë Rajonale ka si objekt kryesor mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara dhe deklaratave të padorëzuara.

Në përgjigje të observacionit të dërguar nga DPT, me shkresën nr. 434/3 prot., datë 13.11.2020 me objekt “*Observacion për projekt-raportin e auditimit të performancës Ecuria e borxhit tatimor*”, sqarojmë si më poshtë vijon:

- ***Pretendimi i subjektit:*** DEPA nuk funksionon më dhe nuk gjen pasqyrim në Rregulloren dhe Manualin e Mbledhjes me Forcë të Detyrimeve tatimore të papaguara.
- ***Qëndrimi i Grupit të auditimit:*** Observacioni pranohet.

Skema 1: Organigrama e Pjesshme e Administratës Tatimore, Strukturat e Menaxhimit të Detyrimeve Tatimore të Papaguara



Burimi: Të dhëna të DPT  
Përpunoi: Grupi i auditimit

### 1.4.2 Politikat e Institucionit

Përmirësimi i menaxhimit të borxhit tatimor është pjesë e objektivit kombëtar për mbledhjen e të ardhurave tatimore, i parashikuar në dy strategjitë kombëtare për menaxhimin e financave publike, që kanë qenë në zbatim gjatë periudhës nën auditim 2017-2019. Referuar Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020, me anë të rishikimit të politikave të taksave dhe reformimit të administratave tatimore dhe doganore do të arrihet përmirësimi i borxhit.<sup>5</sup> Referuar Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022, *Menaxhimi i përmirësuar i borxhit tatimor*<sup>6</sup>, do të arrihet duke shënuar progres në drejtim të<sup>7</sup>:

a) *Rishikimit të procesit të menaxhimit të borxhit;*

<sup>5</sup> Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020, fq. 5

<sup>6</sup> Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022, fq. 22.

<sup>7</sup> Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022, fq. 55

- b) Përmirësimin të kuadrit ligjor;
- c) Krijimin të një baze të dhënash të saktë për të mundësuar analizë të hollësishme të stokut të borxhit;
- d) Përmirësimin të sistemit IT për të mundësuar automatizimin e proceseve që lidhen me mbledhjen e zbatimit;
- e) Trajnimit të personelit lidhur me ndryshimet në legjislacionin tatimor
- f) Reduktimit të stokut të borxhit dhe mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara.

Sipas dokumentit strategjik institucional të DPT (Planit Strategjik 2015-2019), përbushja e detyrimit të pagesës nga ana e tatimpaguesve do të arrihet nëpërmjet aplikimit të sistemeve të plota dhe të efektshme të monitorimit të përbushjes së detyrimit dhe të mbledhjes së detyrimeve të prapambetura tatimore.<sup>8</sup> “DPT do të synojë të rrisë përqindjen e pagimit në kohë”<sup>9</sup> të detyrimeve tatimore nga taksapaguesit.

Në dokumentin strategjik Plani Strategjik 2017-2021, DPT për herë të parë ka përcaktuar një nën-objektiv specifik, të lidhur me mbledhjen e borxhit tatimor “Mbledhja efikase dhe efektive e borxhit”<sup>10</sup>.

Referuar këtij dokumenti, mbledhja efikase dhe efektive e borxhit tatimor do të arrihet nëpërmjet realizimi të aktiviteteve të mëposhtme:

- Rritja e mundësive për analizën e të dhënave nga burime të ndryshme në vlerësimin e riskut të sjelljes së tatimpaguesve me detyrime të papaguara;
- Trajtimi i mbledhjes së borxhit publik në përshtatje me sjelljen dhe llojin e detyrimit të papaguar të tatimpaguesve;
- Përdorimi i metodave që do të sigurojnë pagesa vullnetare të detyrimeve të papaguara me qëllim shmangien e fillimit të zbatimit të masave shtrënguese;
- Monitorimi i veçantë për ecurinë e stokut të borxhit dhe rishikimi i proceseve të mbledhjes me forcë;
- Zgjerimi i mëtejshëm në sistemin informatik tatimor të automatizimit të proceseve që kanë të bëjnë me mbledhjen e borxhit.

Referuar planeve operacionale vjetore të DMDTP për periudhën 2017-2019, Mbledhja efikase dhe efektive e borxhit është nën objektiv i objektivit strategjik “Implementimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor”.

### 1.4.3 Pesha në buxhet dhe PBB

Referuar Raporteve Vjetore të DPT, rezultojnë se detyrimet e papaguara në fund të vitit 2019, janë në nivel më të lartë se detyrimet e vitit në 2017 dhe 2018. Gjithashtu dhe numri i subjekteve është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Detyrimet e papaguara tatimore në fund të vitit 2019 janë 117 mld. lekë dhe i përkasin 151,279 subjekteve debitore nga 137,633 subjekte debitore në fund të vitit 2017. Krahasuar me shpenzimet buxhetore pesha e detyrimeve të papaguara tatimore sipas viteve paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2: Detyrimet e papaguara tatimore në raport me shpenzimet buxhetore

(mil. Lek)

Zërat/Viti	2017	2018	2019
Borxhi tatimor	95,500	107,700	116,994
Shpenzime buxhetore	461,410	476,146	491,897
<i>Borxhi tatimor/Shpenzime buxhetore</i>	<i>20.6%</i>	<i>22.6%</i>	<i>23.8%</i>

Burimi: DPT dhe MFE

Përpunoi: Grupi i auditimit

<sup>8</sup> Plani Strategjik DPT 2015-2019, fq. 11.

<sup>9</sup> Plani Strategjik DPT 2015-2019, fq. 4.

<sup>10</sup> Plani Strategjik DPT 2017-2021, fq. 8.

Sikurse mund të vërehet nga tabela e mësipërme, gjatë periudhës nën auditim detyrimet e papaguara tatimore janë rritur në përqindje, vit pas viti, ndaj shpenzimeve buxhetore. Në vitin 2019, ky tregues është 3.2% më i lartë se në vitin 2017. Krahasuar me Produktin e Brendshëm Bruto, pesha e detyrimeve të papaguara tatimore sipas viteve, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3: Detyrimet e papaguara tatimore në raport me PBB

(mil. Lek)


Zërat/Viti	2017	2018	2019
Borxhi tatimor	95,500	107,700	116,994
PBB <sup>11</sup>	1,550,644	1,635,715	1,678,431
<i>Borxhi tatimor/PBB</i>	<i>6.16%</i>	<i>6.58%</i>	<i>6.97%</i>

Burimi: DPT dhe Departamenti Makroekonomik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Përpunoi: Grupi i auditimit

Referuar të dhënave të mësipërme, gjatë periudhës nën auditim, borxhi tatimor si përqindje ndaj PBB ka vijuar të rritet vit pas viti. Në vitin 2019, pesha relative e detyrimeve tatimore të papaguara ishte rreth 7% e PBB-së.

Grafiku 1: Borxhi tatimor si % ndaj shpenzimeve buxhetore dhe PPP



Burimi: DPT dhe MFE

Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga grafiku i mësipërm evidentohet se, gjatë periudhës 2017-2019 pesha e borxhit tatimor është rritur vit pas viti kundrejt shpenzimeve buxhetore, dhe PBB-së.

<sup>11</sup> PBB vjetore deri më 30.09.2020, të dhëna paraprake.

#### 1.4.4 Risqet e aktiviteteve të subjekteve

Tabela 4: Analiza SWOT

	<b>Fuqitë (S)</b>	<b>Dobësitë (W)</b>
<b>Faktorë të brendshëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Marrëveshjet me institucione të tjera shtetërore dhe bankat e nivelit të dytë për shlyerjen e detyrimeve tatimore të papaguara,</li> <li>Marrëveshjet me biznesin për shlyerjen e detyrimeve të papaguara, me këste,</li> <li>Plani Strategjik i Administratës Tatimore 2017 – 2021, etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Strukturat e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore, jo të plotësuara me staf,</li> <li>Planet strategjike dhe operacionale jo- SMART,</li> <li>Raportet manaxheriale të Mbledhjes me Forcë, që përmbajnë pasaktësi<sup>12</sup>,</li> <li>Hendeqe në politikat ekzistuese për shuarjen e borxhit të pambledhshëm<sup>13</sup>,</li> <li>Moszbatimi i masave shtrënguese në çdo rast,</li> <li>% e lartë e marrëveshjeve me këste të anuluar,</li> <li>Vështirësi në mbledhjen e borxheve të reja dhe borxheve me vlera të mëdha<sup>14</sup>,</li> <li>Bashkëpunim i dobët me institucione të tjera publike, qendrore dhe vendore për të vënë në zbatim masat shtrënguese, etj.</li> </ul>
	<b>Shanset (O)</b>	<b>Kërcënimet (T)</b>
<b>Faktorë të jashtëm</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Asistenca e FMN-së,</li> <li>Studime të shumta nga organizata ndërkombëtare si OECD, Banka Botërore, etj. mbi menaxhimin e suksesshëm të borxhit tatimor,</li> <li>Praktika të mira ndërkombëtare,</li> <li>Indekset ndërkombëtare për të matur performancën e AT-së, në menaxhimin e borxhit tatimor, etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjendja ekonomike e vendit dhe situata e biznesit,</li> <li>Ngjarje të jashtëzakonshme, si: tërmeti, pandemia, etj,</li> <li>Shkalla e informalitetit në ekonomi,</li> <li>Evazioni fiskal,</li> <li>Moszbatimi i marrëveshjeve nga institucionet e tjera shtetërore dhe bizneset, për shlyerjen e detyrimeve të papaguara tatimore, etj.</li> </ul>

Përpunoi: Grupi i auditimit KLSH

Risqet e aktivitetit të subjekteve janë ato me të cilat përballen Administrata Tatimore për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësi për menaxhimin e detyrimeve tatimore të papaguara në afat, që rrjedhin nga kuadri ligjor e rregullator në fuqi. Risqet e aktivitetit të subjekteve janë analizuar dhe evidentuar të klasifikuara fillimisht sipas analizës SWOT: fuqitë, dobësitë, shanset, kërcënimet, detajuar në faktorë të brendshëm dhe të jashtëm.

Në vijim, grupi i auditimit ka paraqitur një ndarje të risqeve të veprimtarisë duke i kategorizuar ata në strategjike, financiare, juridike dhe operacionale.

Tabela 5: Kategorizimi i riskut

<b>Nr.</b>	<b>Risku i Subjektit</b>	<b>Kategorizimi i riskut</b>	<b>Niveli i Riskut</b>
1	Plane strategjike dhe operacionale jo-SMART	Risk Strategjik	I Lartë
2	Bashkëpunim i dobët me institucione të tjera publike, qendrore dhe vendore për të vënë në zbatim masat shtrënguese		I Mesëm

<sup>12</sup>Regjistrat e Riskut 2018, 2019 & 2020, DPT

<sup>13</sup>Regjistrat e Riskut 2018, 2019 & 2020, DPT

<sup>14</sup>Regjistrat e Riskut 2018 & 2020, DPT

3	Hendeqe në politikat ekzistuese për shuarjen e borxhit të pambledhshëm		I Lartë
4	Rritje e stokut të borxhit	Risk Financiar	I Lartë
5	Vështirësi në mbledhjen e borxheve të reja dhe borxheve me vlera të mëdha		I Lartë
6	Moszbatimi i masave shtrënguese në çdo rast	Risk Rregullator dhe Juridik	I Lartë
7	Mosrespektimi i marrëveshjeve të lidhura ndërmjet administratës tatimore dhe subjekteve me detyrime tatimore		I Mesëm
8	Raporteve menaxheriale të Mbledhjes me Forcë, që përmbajnë pasaktësi	Risk Operacional	I Lartë
9	Struktura e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore, jo e plotësuar me staf.		I Lartë
10	Moszbatimi i metodës së analizës së riskut në menaxhimin e detyrimeve tatimore.		I Mesëm

Përpunoi: Grupi i auditimit KLSH

### 1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjektit

Administrata Tatimore sipas dispozitave të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kreu XI, nenet 88-104, ka detyrimin ligjor nëpërmjet ushtrimit të kompetencës të mbledhë detyrimin tatimor të papaguar brenda afateve ligjore sipas burimeve të krijimit. Mbledhja e detyrimeve të papaguara kryhet nga drejtoritë përgjegjëse të mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Drejtoria e Mbledhjes me Forcë është struktura në DPT e cila merret me menaxhimin e detyrimeve të papaguara nga subjektet tatimpagues dhe ka si objekt të saj udhëheqjen metodologjike dhe funksionin monitorues mbi drejtoritë rajonale tatimore, lidhur me procedurat e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara bazuar në Rregulloren e Brendshme të DPT miratuar me Urdhërin nr.19, datë 22.02.2017 të ish Titullarit të MFE “Për miratimin e rregulloreve së brendshme për funksionimin e Administratës Tatimore Qendrore”.

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara kryen aktivitetet dhe prodhon dokumentet e mëposhtme:

- Përgatit *strategjinë menaxhuese dhe planet operationale* të drejtorisë dhe përgatit *raporte mujore* ku përmbledh realizimin e detyrave kundrejt planit dhe informacioni i marrë nga raportet i vihet në dispozicion Drejtorit të Përgjithshëm;
- Harton udhëzimet sqaruese për procedurat tatimore që kanë të bëjnë me mbledhjen e detyrimeve tatimore si dhe zbatimin e masave shtrënguese;
- Harton dhe propozon politikat e menaxhimit të riskut sipas DRT në seleksionimin e rasteve për mbledhjen me forcë të detyrimeve
- Shqyrton raportet e përgatitura nga punonjësit e DMDTP lidhur me borxhet e klasifikuara si të paarkëtueshme dhe i jep mendim Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve lidhur me situatat e tatimpaguesve për deklarimin e detyrimit tatimor si i pambledhshëm;
- Krijon *programe inspektimi për monitorimin dhe ecurinë* e Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë në Drejtoritë Rajonale;
- Harton raporte përmbledhëse nëpërmjet evidencave të ndryshme periodike të DRT në lidhje me marrëveshjet me këste;
- Harton *raportin vjetor të veprimtarisë së DMDTP*;
- Mbi bazën e planeve të inspektimit dhe të inspektimeve të veçanta në drejtoritë rajonale përgatit *raporte për çdo vizitë inspektimi* ku evidentohen problematikat dhe lihen rekomandimet;
- Harton *regjistrin e marrëveshjeve me këste*;
- Harton raporte periodike dhe të menaxhimit të databazës së tatimpaguesve debitor.
- Harton *raporte mujore dhe vjetore në lidhje me mbledhjen e detyrimeve*.

Drejtoria/sektori i mbledhjes me forcë në Drejtorinë Rajonale, vepron si pikë kontakti midis DPT-së dhe drejtorive rajonale për çështjet operacionale lidhur me mbledhjen e detyrimeve tatimore dhe përgatit raporte mujore ku përmbledh realizimin kundrejt planit lidhur me zbatimin nga punonjësit ish-DMF dhe informacioni i marrë i vihet në dispozicion drejtorit rajonal.

#### **1.4.6 Feedback-u i subjektit në fazën studimore**

Gjatë fazës studimore, grupi i auditimit ka mbledhur të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si dhe për drejtorinë rajonale tatimore të cilat ka në varësi. Nga takimi paraprak me drejtuesit e ish-DMF-së u krijua një tablo më e qartë mbi ecurinë e detyrimeve tatimore të papaguara për periudhën e auditimit. Subjekti ka vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar, sipas rastit edhe në format elektronik, në përgjigje të Kërkesës për informacion drejtuar Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve. Në pamundësi për zhvillimin e intervistave paraprake me stafin e ish-DMF-së, e kushtëzuar kjo nga situata e pandemisë Covid- 19, është kërkuar përgjigje me shkrim për pyetjet e intervistës në përputhje me dispozitat e nenit 15, pika (dh) (e) të Ligjit 154/2014 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”. Në përgjithësi, subjekti nën auditim ka qenë i disponueshëm në garantimin e informacionit dhe dokumenteve të kërkuara.

Gjatë fazës analitike grupi i auditimit ka mbledhur të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si dhe nga Drejtorinë Rajonale Tatimore. Grupi i auditimit ka zhvilluar takime me stafin në DPT, si dhe në DRT Tirana. Gjatë kësaj periudhe, strukturat e mbledhjes me forcë të borxhit tatimor kanë qenë në proces ristrukturimi, si dhe, si rezultat i situatës së krijuar nga Covid-19, stafi ka punuar me grafik. Ka patur vonesa të shumta në përcjelljen e informacionit të kërkuar nga grupi i auditimit.

*Në përgjigje të observacionit të dërguar nga DPT, me shkresën nr. 434/3 prot., datë 13.11.2020 me objekt “Observacion për projekt-raportin e auditimit të performancës Ecuria e borxhit tatimor”, sqarohet si më poshtë vijon:*

- **Pretendimi i subjektit:** Në lidhje me faktin se ka patur vonesa të shumta në përcjelljen e informacionit të kërkuar nga grupi i auditimit, kjo nuk është e vërtetë pasi me gjithë situatën e krijuar nga pandemia dhe punimi me grafik, grupit të auditimit materialet i janë venë në dispozicion brenda afateve.
- **Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Grupi i auditimit ka të dokumentuara datat kur është bërë kërkesa për informacion dhe datat kur janë përcjellë përgjigjet nga subjekti, të cilat janë në tejkalim të afateve. Megjithatë, sikurse e kemi trajtuar edhe në Feedback, situata e krijuar nga pandemia dhe puna me grafik në DPT është marrë në konsideratë nga grupi i auditimit.

## **2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT**

### **2.1 Objektivi dhe problemi i performancës**

Auditimi me temë “Ecuria e borxhit tatimor” synoi të siguronte një vlerësim të paanshëm dhe objektiv nëse burimet publike janë menaxhuar me përgjegjësi duke informuar publikun dhe Kuvendin e Shqipërisë mbi efektivitetin e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e borxhit tatimor. Në këtë mënyrë, konkludoi se deri në çfarë mase ka qenë efektive veprimtaria e institucioneve subjekt auditimi.

#### **2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit**


Menaxhimi i detyrimeve tatimore të papaguara është një ndër funksionet më të rëndësishme të administratës tatimore. Rritja e borxhit tatimor shkakton të ardhura të munguara në buxhetin e shteti, të ardhura këto të nevojshme për të financuar shërbimet dhe të mirat publike ofruar qytetarëve shqiptar. Për të menaxhuar në mënyrë të suksesshme mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara është thelbësore përcaktimi i objektivave të qartë, të matshëm dhe relevant, si strategjik ashtu edhe operacional për të orientuar dhe monitoruar punën e administratës tatimore në këtë drejtim. Krahas formulimit të objektivave SMART, me rëndësi kyçe shfaqen edhe realizimi në

mënyrë shteruese i aktiviteteve për arritjen e objektivave të synuar për borxhin tatimor, monitorimi i zbatimit të masave shtrënguese nga Drejtoritë Rajonale si marrja e masave për përmirësim aty ku është e nevojshme. Rezultati i pritur është rritja e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara dhe reduktimi i borxhit tatimor.

Për të vlerësuar ekonomicitetin, auditimi përgjithësisht fokusohet tek inputet, për të vlerësuar eficiencën fokusi vendoset tek inputet e përdorura dhe outputet e prodhuara, ndërsa për të vlerësuar efektivitetin fokusi vendoset tek rezultatet e arritura në raport me objektivat e synuara.

Ky auditim synoi të paraqesë një tablo të strukturave përgjegjëse për menaxhimin e borxhit tatimor, aktivitetet e ndërmarra për mbledhjen e tij, si dhe të vlerësojë ecurinë e borxhit tatimor gjatë periudhës 2017-2019. Më vijim, paraqitet Modeli Logjik i menaxhimit të detyrimeve tatimore të papaguara. Referuar Modelit Logjik, duke u fokusuar tek objektivat dhe rezultatet e arritura, grupi i auditimit analizoi efektivitetin e veprimtarisë së institucioneve subjekt auditimi dhe politikave që synojnë përmirësimin e menaxhimit të borxhit tatimor, duke vlerësuar gjithashtu zbatimin e masave të parashikuara në kuadrin ligjor dhe rregullator për këtë qëllim.

## Skema 2: Modeli Logjik



### 2.1.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Ecuria e borxhit tatimor” u shtri në periudhën 2017–2019 dhe analizoi efektivitetin e strukturave subjekt auditimi të cilat janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbledhjen efektive dhe eficiente të borxhit tatimor.

Nisur nga rëndësia që ka mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara, si faza e fundit e ciklit të përmbushjes tatimore, ky auditim synoi të paraqesë një tablo të qartë të ecurisë së detyrimeve tatimore të papaguara, evidentimin e shkaqeve, veprimtaritë e mbledhjes së detyrueshme dhe dhënien e rekomandimeve në drejtim të përmirësimit të situatës.

*Për sa më lart, objektivi kryesor i këtij auditimi ishte vlerësimi i efektivitetit të sistemit të ngritur për menaxhimin e borxhit tatimor, përgjatë periudhës 2017-2019.*

### 2.2 Përkufizimet dhe terminologjia

- **“Auditimi i performancës”** vlerëson ekonomikitetin, efektivitetin dhe eficientësinë e veprimtarisë dhe përdorimit të fondeve nga njësi e sektorit publik në përmbushjen e objektivave.
- **“Administratë tatimore”** përfshin Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, drejtoritë rajonale të ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel kombëtar dhe njësitë tatimore të qeverisjes vendore, të ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel vendor; me përjashtim të akcizës.
- **“Auditimi i përputhshmërisë”** nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord.
- **“Auditimi i rregullshmërisë”**- Auditimi i përgjegjësive financiare, i integritetit dhe i përputhshmërisë së vendimeve të subjektit.
- **“Auditimi i Brendshëm”**- Tërësia e instrumenteve, procedurave, metodave, sistemeve të krijuara nga një subjekt, për t’u siguruar se veprimtaria e tij përputhet me rregullat dhe kërkesat e jashtme e të brendshme (ligjet), rregulloret, direktivat e drejtimit.
- **“Detyrime tatimore të regjistruara në llogarinë e subjektit”** nënkuptohen ato detyrime, njoftim vlerësimi për të cilat është lëshuar deri në datën 31.12.2019.
- **“Efektivitet”** është masa në të cilën arrihen objektivat ose përputhshmëria midis rezultatit të produktit dhe rezultatit social për një aktivitet të caktuar.
- **“Eficiencë”** është raporti ndërmjet rezultateve të produktit dhe burimeve të përdorura për prodhimin e tij.
- **“Ekonomicitet”** është minimizimi i kostos së burimeve publike të përdorura për kryerjen e veprimtarisë, pa cënuar cilësinë.
- **“Kontribut”** është detyrimi monetar i detyrueshëm për t’u paguar si shpërblim për një shërbim specifik apo ushtrim të të drejtave, për sigurimin shoqëror dhe shëndetësor të të punësuarve.
- **“Kontribuues”** janë të gjithë personat, fizikë dhe juridikë, të detyruar t’i paguajnë kontribute Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
- **“Periudhë tatimore”** është periudha e njëjtë me vitin kalendarik, me përjashtim të rasteve kur ky ligj ose ligje të tjera tatimore parashikojnë ndryshe.
- **“Person Juridik”** organizime kolektive që e drejta i ka njohur si subjekte të veçanta të saj, duke iu dhënë zotësinë për të pasur të drejta dhe detyrime juridike.
- **“Subjekt”** përfshin individin, personin fizik, personin juridik.
- **“Tatim”** është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që nuk bëhet në shkëmbim të mallrave dhe shërbimeve të caktuara;
- **“Taksë”** është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që paguhet nga çdo person, që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik në territorin e Republikës së Shqipërisë. Dispozitat e këtij ligji për tatimet dhe detyrimet tatimore zbatohen njëjloj edhe për taksat;

- **“Tatimpagues”** është personi apo individi, i cili detyrohet nga ligji të paguajë tatime, taksa ose kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe agjenti i mbajtjes së tatimit në burim;
- **“Njoftim dhe kërkesë për të paguar”**- Njoftimi i tatimpaguesit për të paguar detyrimet tatimore, del pas 10 ditëve nga ana e administratës tatimore dhe ky afat fillon të llogaritet nga data kur tatimpaguesi ka pasur detyrimin për ta paguar atë. Tatimpaguesi ka mundësi të paguajë detyrimin brenda 7 (shtatë) ditësh për të shmangur vijimin e masave të Mbledhjes me Forcë.
- **“Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit”**- Pasi kanë kaluar 10 (dhjetë) ditë pune nga “Njoftim dhe kërkesë për pagesë”, inspektori i mbledhjes me forcë gjeneron “Urdhër Bllokimit të llogarive bankare dhe të llogarive depozitë të tatimpaguesit”. Ky Urdhër i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë që operojnë në R. Sh. Kur përgjigja rezulton pozitive, bëhet ekzekutimi bankar në mënyrë shkresore, duke bashkëlidhur Urdhër Pagesat për detyrimin përkatës të tatimpaguesit.

Pas përfundimit të afatit të bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit debitor dhe detyrimet tatimore janë ende të pashlyera, atëherë Inspektori i Mbledhjes, brenda 10 (dhjetë) ditëve gjeneron masat e sigurimit të detyrimit tatimor sipas sistemit C@TS dhe në mënyrë shkresore, në të gjitha format e mëposhtme:

- **“Njoftim Tatimpaguesit për vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor”**- Ky njoftim bëhet me qëllim që tatimpaguesi të marrë dijeni për vendosjen e masës së sigurimit mbi pasuritë e tij dhe të ketë mundësinë e ushtrimit të të drejtës së ankimit, bazuar në legjislacionin në fuqi
- **“Njoftim i Përgjithshëm për vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor”**- Ky njoftim publikohet në faqen zyrtare të WEB-it të administratës tatimore dhe bëhet për faktin, që personat e tretë të marrin dijeni për fillimin e këtyre procedurave, dhe që organet apo institucionet të cilët kanë regjistrime të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të tatimpaguesit debitor të regjistrojnë detyrimin tatimor të papaguar si barrë mbi këto pasuri.
- **“Njoftim për vendosjen e Barrës Hipotekore”**- “Akti me anë të të cilit kërkohet të vendoset hipoteka, i dërgohet Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ku ndodhet pasuria e paluajtshme e tatimpaguesit, apo ku ndodhet selia e tij, si dhe Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.”<sup>15</sup>
- **“Njoftim për vendosjen e Barrës Siguruese”**- “Për vendosjen e barrëve siguruese administrata tatimore do të veprojë në përputhje me Ligjin Nr. 8537, datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese", të ndryshuar, Rregulloren e Barrëve Siguruese të miratuar nga Ministri i Ekonomisë, Energjetikës dhe Tregtisë Nr. 493, datë 06.07.2006, si dhe në përputhje me Udhëzimet e nxjerra nga Kryeregjistruesi i Barreve Siguruese.”<sup>16</sup> Kur nga ana e administratës tatimore identifikohen pasuritë e luajtshme mbi të cilat mund të vendoset barra siguruese, Drejtoria Rajonale është përgjegjëse për njoftim pranë Regjistrimit të Barrëve Siguruese për këto pasuri mbi të cilat është vendosur barra siguruese.<sup>17</sup> (Trajtohet më gjerësisht në vijim).
- **“Pezullim të aktivitetit në Doganë”** – “Në rastet kur tatimpaguesi, si pjesë të aktivitetit të tij tregtar, kryen importe dhe/ose eksporte, nga ana e organit tatimor, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe asaj të Doganave, “Mbi informimin reciprok për pezullimin e operatorëve ekonomikë deri në përmbushjen e plotë të detyrimeve”, kërkohet si masë siguruese për mbledhjen e detyrimit tatimor të papaguar, pezullimi i aktivitetit të operatorit ekonomik, deri në përmbushjen e detyrimeve tatimore.”

<sup>15</sup> Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 91 “Masa e sigurimit të detyrimit tatimor”, fq. 91.2.3

<sup>16</sup> Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 91 “Masa e sigurimit të detyrimit tatimor”, fq. 91.2.5.

<sup>17</sup> Udhëzuesi i Përgjithshëm i Procedurave të Mbledhjeve me Forcë, 2018 DPT, pika 6.

- Sekuestrimi i pasurisë “*Urdhër Sekuestro*”<sup>18</sup>-“Administrata tatimore për efekt të arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara, ka të drejtë të sekuestrojë pasurinë e tatimpaguesit debitor dhe ta shesë atë sipas parashikimeve në ligj.” “Administrata tatimore procedurën e sekuestrimit duhet ta përdorë vetëm kur masat shtrënguese të mëparshme nuk kanë qenë të suksesshme për të mbledhur plotësisht borxhin e prapambetur dhe nuk ka mënyrë tjetër për rikuperimin e borxhit tatimor.” “Urdhri i Sekuestrimit bëhet me shkrim nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore”. “Për këtë qëllim administrata tatimore e cila ka kompetencën e kryerjes së sekuestros, njofton zyrën ku ajo ka regjistruar barrën siguroese, dhe Zyrën Qendrore dhe Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në rastin kur sendet janë në hipotekë.”
- **Konfiskimi i pasurisë së sekuestruar**- “Me kalimin e afatit 15 ditor nga dita e marrjes së njoftimit të sekuestrimit nga ana e tatimpaguesit, i cili ende nuk ka shlyer detyrimin tatimor, sendet e paluajtshme ose të luajtshme të sekuestruara nga administrata tatimore, prej tatimpaguesit, konfiskohen dhe i nënshtrohen procesit të shitjes së tyre, me qëllim arkëtimin e detyrimit tatimor”<sup>19</sup>
- **Shitja e pasurisë së konfiskuar**- “Drejtoria Rajonale Tatimore, i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për fillimin e procedurës së ankandit publik. Në këtë rast administrata tatimore vepron në përputhje me të gjitha rregullat e parashikuara në ligjin “Për ankandin publik”. Në zbatim të procedurave të shitjes, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si Autoritet Tatimor Qendror është autoriteti shitës, i cili është përgjegjës për realizimin e ankandit publik në përputhje me ligjin ‘Për ankandin publik’.<sup>20</sup>

*Në përgjigje të observacionit të dërguar nga DPT, me shkresën nr. 434/3 prot., datë 13.11.2020 me objekt “Observacion për projekt-raportin e auditimit të performancës Ecuria e borxhit tatimor”, sqarohet si më poshtë vijon:*

- **Pretendimi i subjektit:** Në lidhje me përkufizimet e cituara nga grupi i auditimit, shumica prej tyre nuk përkojnë me ligjin 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar.
- **Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Termat: “Detyrime tatimore të papaguara”, “Detyrime tatimore të evidentuara në llogarinë e subjektit” dhe “Masat shtrënguese”, si rezultat se nuk ka përkufizime të mirëpërcaktuara në ligj, me qëllim për të rritur kuptueshmërinë e materialit për lexuesit, ishin shpjeguar nga grupi i auditimit. Pjesa tjetër e termave janë cituar në përputhje me Ligjin nr.154/ 2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Performancës të KLSH-së, Ligjin 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar dhe Manualin e Mbledhjes me Forcë të DPT. Observacioni pranohet pjesërisht.

## 2.3 Burime të Kritereve

### 2.3.1 Kriteret politike

- Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike, 2014-2020;
- Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike, 2018-2022;
- Plani strategjik i DPT 2015-2019;
- Plani strategjik i DPT 2017-2021.

### 2.3.3 Kriteret teknike

- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ;

<sup>18</sup>Manuali i Mbledhjes me Forcë 2017, DPT pika 4.5.1, pika 4.5.2 dhe 4.5.4.

<sup>19</sup>Manuali i Mbledhjes me Forcë 2017, DPT pika 4.5.9

<sup>20</sup>Manuali i Mbledhjes me Forcë 2017, DPT pika 4.5.10

- Ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 “ Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 33/2017, datë 19.04.2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore , detyrimeve të pagueshme në doganë , si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore ”;
- Ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2008 “ Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “ Për taksat kombëtare”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “ Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 1234, datë 16.12.2009 “Për përcaktimin e formatit dhe të elementeve të njoftimit për barrën siguroese dhe/ose barrën hipotekore”;
- Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse;
- Urdhër nr.19, datë 22.02.2017 i Ministrit të Financave: “Rregullore e Brendshme për funksionimin e Administratës Tatimore Qendrore”;
- Urdhër nr. 19, datë 22.02.2017 i Ministrit të Financave: “Rregullore për funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore”;
- Udhëzimi nr. 14, datë 03.05.2017 “Për zbatimin e ligjit nr.33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë , si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore”;
- Manual i Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë;
- Udhëzues i përgjithshëm i procedurave të mbledhjes me forcë;
- Marrëveshje e bashkëpunimit me nr. 12819, datë 19.06.2018 ndërmjet DPT dhe DPD;
- Shkresë nr. 5730, datë 15.03.2018 me objekt "Për vendosjen e barrës hipotekore, sekuestrimi i pasurisë" drejtuar Drejtorive Rajonale Tatimore, nëpërmjet së cilës është sqaruar procedura në zbatim të nenit 95 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me objekt “Pasuria, objekt i sekuestrimit”.

### **2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit**


- Planet operationale të strukturave përgjegjëse për menaxhimin e borxhit tatimor;
- Raportimet periodike mbi menaxhimin e borxhit tatimor;
- Raporti vjetor 2018 i DPT;
- Raporti vjetor 2019 i DPT;
- Progres - Raporti i Bashkimit Evropian për Shqipërinë 2019;
- FMN: “Raporti i Asistencës Teknike – Administrimi i të ardhurave: Mbështetja dhe arritja e Agjendës së Reformës”, 2019;
- Banka Botërore: “Raporti i Vlerësimit të Performancës për Shqipërinë”, dhjetor 2017;
- Indikatorët e performancës së mbledhjes së borxhit tatimor, OECD 2019.

### **2.3.3 Kriteret e tjera/ Praktikrat më të mira**

- Komisioni Evropian: “Një vlerësim i sistemit italian të mbledhjes së borxhit tatimor”, 2015;
- OECD: “Administrata Tatimore 2019-Informacion krahasues për OECD dhe ekonomitë e tjera të përparuara dhe ato në zhvillim”, 2019;

- Universiteti i Ekonomisë dhe Biznesit në Poznan: “Krahasimi i efektivitetit të mbledhjes së borxhit tatimor në Gjermani, Poloni dhe Mbretërinë e Bashkuar”, 2015;
- OECD: “Forumi për Administrimin e Tatimeve”, 2013;
- OECD: “Menaxhimi i suksesshëm i borxhit tatimor, matja e maturimit dhe mbështetja e ndryshimeve”, 2019.
- Organizata Intra-Evropiane e Administratave Tatimore: “Analiza e Rrezikut në Menaxhimin e Borxhit Tatimor”, 2016.

## 2.4 PIRAMIDA E PYETJEVE AUDITUESE



## **2.5 Qasja/metodologjia e auditimit**

Paradigma e këtij auditimi ishte: *“Menaxhimi i suksesshëm i detyrimeve të papaguara tatimore shërben për të mbledhur të ardhura për buxhetin e shtetit, me qëllim ofrimin e shërbimeve dhe të mirave publike për qytetarët shqiptarë”*

Në këtë auditim performance, grupi i auditimit, pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjektet e përfshira dhe kuadrin ligjor e rregullator të fushës, gjykoi si më të përshtatshme për arritjen e objektivave të auditimit *qasjen pragmatike*, një ndërthurje midis qasjes cilësore dhe asaj sasiore. Në funksion të qasjes pragmatike u përdorën kritere të përcaktuara në program, ku përfshihen baza ligjore e rregullatore, si dhe dokumentet strategjike të Administratës Tatimore. Grupi i auditimit gjykon se kjo qasje siguroi një trajtim shterues të fokusit të auditimit.

Ky auditim performance u orientua kryesisht kah procesit, pasi analizoi strukturat përgjegjëse dhe aktivitetet e ndërmarra prej tyre për të mbledhur borxhin tatimor.

### **2.5.1 Metodatat/teknikat audituese**

Për shkak të situatës në DPT si rezultat i Covid-19 dhe për të respektuar distancimin fizik gjatë pandemisë, faza studimore e këtij auditimi është kryer kryesisht nga zyra. Janë zhvilluar dy takime me stafin e DPT-së, dhe kryesisht informacioni është siguruar nëpërmjet kërkesave për informacion dhe intervistave me shkrim. Metodatat dhe teknikat audituese që u përdorën gjatë fazës studimore dhe fazës analitike ishin:

- Mbledhje, shqyrtim dhe analizim i dokumentacionit gjatë auditimit;
- Analiza dhe krahasimi i akteve normative me procedurat konkrete të zhvilluara gjatë periudhës së auditimit;
- Testime, analiza sasiore dhe cilësore e informacionit të vënë në dispozicion nga subjektit nën auditim;
- Rishikim dhe vlerësim i të dhënave dhe dokumentacionit të grumbulluar gjatë fazës studimore;
- Intervista dhe pyetësor me drejtuesit dhe specialistët e subjektit nën auditim.

## **2.6 Rezultatet e parashikuara**

Ky auditim performance, duke u fokusuar më së shumti në procesin e mbledhjes së borxhit tatimor, synoi të paraqesë një tablo të detajuar të elementëve kyç në këtë proces, përfshirë rolin e autoriteteve dhe strukturave përkatëse në menaxhimin e borxhit tatimor, në drejtim të kryerjes së detyrave në mënyrë efektive, në përputhje me kuadrin ligjor e procedural të të gjithë procesit.

### **2.6.1 Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë**

Kontrolli i Lartë i Shtetit synoi që nëpërmjet këtij auditimi të paraqesë një panoramë të problematikave të procesit të mbledhjes së detyrimeve të papaguara tatimore në Shqipëri, si rrjedhojë e veprimtarisë së strukturave përgjegjëse. Rezultatet e këtij auditimi performance kanë impakt për Kuvendin, pasi i krijojnë atij mundësinë për t'u njohur me hapësirat që kanë nevojë për përmirësim në menaxhimin e borxhit tatimor, duke i paraqitur njëkohësisht edhe rekomandimet në drejtim të përmirësimit. Raporti përfundimtar, i cili përfshinë gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet, ndihmon ekzekutivin, në funksion të hartimit dhe implementimit të politikave efektive dhe bashkërendimit të mëtejshëm të veprimtarisë së strukturave në fjalë.

### **2.6.2 Impakti për publikun dhe palët e interesit**

Duke audituar aktivitetin e Administratës Tatimore, KLSH u përpoq të bëjë transparente veprimtarinë e strukturave përgjegjëse në administrimin e detyrimeve tatimore të papaguara. Nëpërmjet vlerësimit të efektivitetit dhe eficiencës së këtij procesi, KLSH synoi përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë së këtyre strukturave nëpërmjet rekomandimeve përkatëse.

### **2.6.3 Forma e publikimit**

Në përfundim të auditimit u përgatit Projekt-Raporti i Auditimit, i cili iu dërgua subjekteve të përfshira në këtë auditim.

Pas marrjes së opinioneve dhe vlerësimit të tyre u përgatit Raporti Final i Auditimit dhe Vendimi përkatës, të cilët, pas aprovimit të Kryetarit, iu përcillen përsëri subjektit nën auditim.

Raporti Final do të publikohet në faqen e Web-it të KLSH-së, shtypin e përditshëm apo dhe në workshop-e të ndryshme dhe analiza vjetore të institucionit.

### 3. SHTJELLIMI I PIRAMIDËS SË PYETJEVE AUDITUESE

Lidhur me pyetjen kryesore u arrit në këtë mesazh auditimi:

---

*Menaxhimi i borxhit tatimor në nivel strategjik është mbështetur në një planifikim të dobët si rezultat i mungesës së një angazhimi të kujdesshëm dhe të efektshëm në ndarjen e strukturave përgjegjëse për kryerjen e aktiviteteve strategjike, si dhe mungesës së treguesve të matshëm për të vlerësuar realizimin e këtyre aktiviteteve vit pas viti, duke shkaktuar kështu pamundësinë për të monitoruar dhe vlerësuar realizimin e nën objektivit strategjik “Mbledhja efikase dhe efektive e borxhit”, nëpërmjet treguesve të përcaktuar në strategji. Mungesa e stafit të nevojshëm në Drejtoritë/Sektorët e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në drejtoritë rajonale, gjatë periudhës nën auditim 2017-2019, ka ndikuar negativisht në zbatimin e masave shtrënguese për mbledhjen e borxhit tatimor, si dhe në monitorimin e procesit. Për 20 tatimpaguesit me vlerë më të lartë borxhi të secilës prej 13 DRT-ve të marrë në shqyrtim nga grupi i auditimit, të cilët gjatë vitit 2019 kanë shtuar borxhin tatimor me 8,825,112 mijë, niveli i arkëtimeve nga zbatimi i masave shtrënguese ka qenë i ulët. Mos identifikimi i të gjitha pasurive të luajtshme të tatimpaguesve debitorë, si dhe mos regjistrimi i barrëve siguruese në Regjistrin e Barrëve Siguruese ka ndikuar negativisht në mbledhjen dhe menaxhimin e borxhit tatimor. Në vitin 2019, për 30 tatimpagues me vlerë borxhi 13,411,106 mijë lekë, si rezultat i mungesës së bashkëpunimit midis institucioneve që regjistrojnë pasuri të luajtshme/të paluajtshme dhe Drejtorive/Sektorëve të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, këto të fundit nuk kanë mundur të zbatojnë masat shtrënguese në mënyrë shteruese. Problematika janë evidentuar edhe në marrëveshjet me këste të lidhura, dhe rastet e tatimpaguesve debitorë për përcjellje tek DHT. Në vitin 2019, në DRT Dibër borxhi në vlerë 129,404 mijë lekë i 35% të tatimpaguesve debitorë të marrë në shqyrtim, nuk është ndjekur me masa shtrënguese në mënyrë shteruese. Kjo situatë ka sjellë që niveli i borxhit tatimor në fund të vitit 2019 të ketë arritur në vlerën 116,994,227 mijë lekë, çka tregon se procesi i mbledhjes së borxhit tatimor nga strukturat e mbledhjes me forcë në Drejtoritë Rajonale Tatimore nuk ka qenë efektiv.*

---

#### **3.1 A është realizuar planifikimi i duhur për menaxhimin e borxhit tatimor?**

##### **3.1.1 A janë formuluar siç duhet Planet strategjike dhe ato operacionale për mbledhjen e borxhit tatimor?**

Auditimi u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:

Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Administrata Tatimore Qendrore Plani Strategjik 2017-2021.

Planet operacionale për vitin 2017, 2018 dhe 2019 të DMDTP-së.

Urdhrat për miratimin e Strukturës së DPT: Nr. 126 datë 02.08.2016; Nr. 49 datë 27.02.2019; Nr. 86 datë 03.05.2019.

Urdhrat për ngritjen e Komitetit të Reformës, Komitetit Operacional, Komitetit të Përmbushjes për vitet 2017-2019.

Vendimet e Komitetit të Reformës, Komitetit Operacional, Komitetit të Përmbushjes për vitet 2017-2019 si dhe dokumentacioni bashkëlidhur.

➤ **Plani Strategjik i DPT-së**

Plani Strategjik 2017-2021 është dokumenti më i lartë në hierarkinë e dokumenteve të Administratës Tatimore Qendrore, i miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.12.2016 në mbledhjen e Komitetit të Reformave si niveli më i lartë i menaxhimit i ATQ, i publikuar në faqen zyrtare të internetit të saj, dhe si i tillë konsiderohet version final dhe i gatshëm për implementim gjatë viteve në vijim. Ky dokument, jo vetëm përcakton rrugën për një Administratë Tatimore moderne dhe efikase në shërbim të shoqërisë, duke u bërë një burim kryesor i të hyrave për shtetin shqiptar në një periudhë afatgjatë, por përbën edhe një detyrim që rrjedh nga marrëveshjet me partnerët ndërkombëtarë, si Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bashkimin Evropian.

Në këtë plan strategjik janë përcaktuar vendime përsa i përket: 1. Përcaktimit të vizionit, filozofisë dhe misionit të organizatës. 2. Hartimit të objektivave afatgjata për arritjen e këtij misioni. 3. Zgjedhjes së strategjive që do të përdoren për arritjen e objektivave të organizatës, konkretisht:

**Misioni:** Mbledhja e të ardhurave tatimore dhe kontributeve shoqërore, duke nxitur përmbushjen vullnetare dhe duke kërkuar nga të gjithë kuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore.

**Vizioni:** Një Administratë Tatimore moderne dhe efikase në shërbim të shoqërisë, për të garantuar një nivel të lartë të transparencës dhe modernizimit të shërbimeve, duke u bërë një burim kryesor i të hyrave për shtetin Shqiptar.

**Synimet Strategjike:** Modeli i përmbushjes vullnetare duhet të përbëjë objektivin kryesor të veprimtarisë së ATQ-së. Ky model është një qasje e strukturuar për t'i mundësuar ATQ-së të përdorë dhe menaxhojë faktorët që ndikojnë në sjelljen e tatimpaguesve për sa i përket pajtueshmërisë të detyrimeve të tyre në përputhje me kuadrin ligjor fiskal.

*“Përzgjedhja e instrumenteve të përshatshme për trajtimin e risqeve, si dhe të kuptuarit e arsyeve se përse tatimpagues të ndryshëm, nuk janë në përputhje me legjislacionin tatimor dhe të kontributeve shoqërore, mundësojnë administratën të përdorë dhe përqendrojë burimet e saj në mënyrë efektive”<sup>21</sup>.*

Planifikimi strategjik i institucionit hartohet nga një grup specialistësh pune, marrës vendimesh në nivel institucioni, drejtorie dhe funksioni, të cilët duke njohur qëllimin e institucionit, mjedisin në të cilin ai operon, burimet dhe kapacitetet për arritjen e qëllimit, mbledhin dhe përpunojnë informacione, analizojnë situatën duke adresuar ku duhet impaktet dhe duke u fokusuar në atë që është e rëndësishme nga pikëpamja strategjike, hartojnë një proces manaxhimi strategjik të aplikueshëm dhe të zbatueshëm duke synuar arritjen e një performace të lartë institucionale.

Grupi i auditimit kërkoi si nëpërmjet hartimit të pyetësorëve ashtu edhe me anë të komunikimit elektronik dokumentimin e gjurmës së procesit të hartimit të këtij plani dhe nga ana e subjektit nuk u paraqitën shkresa zyrtare apo dokumente mbështetëse.

Nga auditimi i procesit të hartimit të Planit Strategjik 2017-2021 të administratës tatimore, si dhe nga përgjigjet e pyetësorëve dhe informacioneve me postë elektronike nga ana e strukturës përgjegjëse, grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion shkresa mbi ngritjen e grupit të punës në hartimin e Planit Strategjik.<sup>22</sup> Për hartimin e Planit Strategjik 2017-2021 nuk rezultojnë të jenë kryer analiza apo vlerësime mbështetur në mbledhjen dhe përpunimin e informacioneve të drejtorive në varësi të saj, të cilat do të orientonin në krijimin e alternativave strategjike dhe parashikimin e rezultateve që do të kenë në të ardhmen vendimet menaxheriale.<sup>23</sup>

---

<sup>21</sup> Administrata Tatimore Qendrore Plani Strategjik 2017-2021.

<sup>22</sup> E-mali zyrtar datë 21.07.2020 i dërguar nga grupi i auditimit anëtarit të Sekretariatit Teknik (K.R).

<sup>23</sup> Në vijim të e-mail-it zyrtar që grupi i auditimit i dërgoi anëtarëve të Sekretariatit Teknik, datë 21.07.2020 në lidhje me këtë pikë, nuk u përcollën analiza dhe vlerësime të kryera për hartimin e Planit Strategjik 2017-2021.

Mbledhjen e borxhit tatimor ATQ e ka vendosur në Planin Strategjik 2017-2021 të saj si nën-objektiv të objektivit strategjik nr. 2, konkretisht:

**Objektivi Strategjik 2.** Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor. **Nën-objektivi 2.3: Mbledhja efikase dhe efektive e borxhit.**

Me qëllim që menaxhimi dhe punonjësit të kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë në organizatë, si dhe të monitorojnë dhe të vlerësojnë punën e tyre, njësitë publike duhet të realizojnë Menaxhimin sipas Objektivave. “Menaxhimi sipas objektivave (MsO) është procesi i përcaktimit të objektivave brenda organizatës në mënyrë që menaxhimi dhe punonjësit së bashku të bien dakord për objektivat dhe të kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë në organizatë, që t’i arrijnë ato<sup>24</sup>”. “Qëllimet/Objektivat për të qenë të suksesshëm duhet të formulohen duke përdorur teknikat SMART; ato duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshëm, relevant dhe të lidhura me kohën<sup>25</sup>”.

Për të siguruar progres në drejtim të arritjes së objektivave strategjik të institucionit duhet që ata të jenë SMART<sup>26</sup>:

S – Specifik (objektiva të qartë, përgjegjësi të qarta),

M – I matshëm (mund të matet me shifra),

A – I arritshëm (masat e marra ndikojnë në arritjen e qëllimit),

R – Relevant (objektivi nuk është as shumë i lartë dhe as shumë i ulët),

T – Me afat (ka një kohë të caktuar për arritjen e objektivit).

### Specifik

Në Planin Strategjik 2017-2021 të DPT-së, është përcaktuar nën-objektivi strategjik “Mbledhja efektive dhe efikase e borxhit tatimor”<sup>27</sup>, i cili i përgjigjet fokusit të këtij auditimit. Për këtë nën-objektiv janë parashikuar 5 aktivitete strategjike, indikatorët e performancës, afatet e përfundimit dhe strukturat përgjegjëse, si më poshtë:

Tabela 6: Aktivitetet, Indikatorët, Afatet dhe Strukturat Përgjegjëse sipas Planit Strategjik 2017-2021.

	<b>Aktivitetet</b>	<b>Indikatori</b>	<b>Afati</b>	<b>Strukturat përgjegjëse</b>
<b>Nën-objektivi 2.3</b> “Mbledhja efektive dhe efikase e borxhit tatimor”	1. Rritja e mundësive për analizën e të dhënave nga burime të ndryshme në vlerësimin e riskut të sjelljes së tatimpaguesve me detyrime të papaguara.	<b>IP7a-</b> Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve, pas trajtimit, <i>reduktimi i numrit të tatimpaguesve me risk.</i>	2017	Drejtoria e Mbledhjes me Forcë dhe Drejtoria e Menaxhimit të Riskut
	2. Trajtimi i mbledhjes së borxhit publik në përshtatje me sjelljen dhe llojin e detyrimit të papaguar të tatimpaguesve.	<b>IP9-</b> Numri i tatimpaguesve me borxh ndaj numrit total të tatimpaguesve	2018	
	3. Përdorimi i metodave që do të sigurojnë pagesa vullnetare të detyrimeve të papaguara me qëllim shmangien e fillimit të zbatimit të masave shtrënguese.	<b>IP-10-</b> Numri i tatimpaguesve që kanë paguar detyrimet tatimore randa afatit ligjor, ndaj numrit të përgjithshëm të tatimpaguesve që kanë deklaruar një detyrim.	2017	
	4. Monitorimi i veçantë për ecurinë e	<b>IP7a-</b> Zvogëlimi i riskut të	2017	

<sup>24</sup> Udhëzim nr. 21, datë 25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të gjitha niveleve”, pika 6.1.3.

<sup>25</sup> Gjykata e Audituesve.

<sup>26</sup> Udhëzim nr. 21, datë 25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të Gjitha Niveleve”, pika 6.1.3.

<sup>27</sup> Administrata Tatimore, Plani Strategjik 2017-2021, fq. 10.

	stokut të borxhit dhe rishikimi i proceseve të mbledhjes me forcë.	sjelljes së tatimpaguesve, pas trajtimit, <i>reduktimi i numrit të tatimpaguesve me risk.</i>		
	5. Zgjerimi i mëtejshëm në sistemin informatik tatimor të automatizimit të proceseve që kanë të bëjnë me mbledhjen e borxhit.	<b>IP11- Raporti i detyrimeve të paguara brenda afatit ndaj shumës së përgjithshme të detyrimeve të deklaruar.</b>	2020	

Burimi: Administrata Tatimore, Plani Strategjik 2017-2021.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Referuar Planit Strategjik 2017-2021, strukturat përgjegjëse për këtë nën-objektiv janë dy: Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (ish-DMF) dhe Drejtoria e Menaxhimit të Riskut.

### Gjetje:

- Nga dokumenti strategjik, si dhe nga komunikimet me DMDTP dhe DMR është e paqartë se cila është përgjegjësia specifike e këtyre dy strukturave për 5 aktivitetet e lidhura me nënobjektivin strategjik “Mbledhja efektive dhe efikase e borxhit tatimor”.
- Nga analizimi i planeve vjetore rezulton se vetëm 4 (aktiviteti 1, 3, 4 dhe 5) prej 5 aktiviteteve të pasqyruara në tabelën e mësipërme, janë reflektuar në planin vjetor 2017 të DMDTP-së.
- Në planin vjetor 2018 të DMDTP-së janë reflektuar 3 (aktiviteti 1, 4 dhe 5) nga 5 aktivitetet e mësipërme.
- Në planin vjetor 2019 të DMDTP-së janë reflektuar 2 (aktiviteti 1 dhe 4) nga 5 aktivitetet e mësipërme.

### Konkluzion:

- *Për shkak se në Planin Strategjik strukturat përgjegjëse janë përcaktuar në nivel nën-objektivi dhe nuk janë të lidhura në mënyrë të qartë dhe specifike me aktivitetet të cilat ato duhet të kryejnë, të paktën njëri prej aktiviteteve strategjike për mbledhjen e borxhit tatimor, nuk është reflektuar në planet vjetore të asnjërës prej strukturave përgjegjëse për periudhën 2017-2019 dhe rrjedhimisht nuk ka gjetur zbatim.*

### **I Matshëm, i Arritshëm, Relevant dhe i lidhur me kohën.**

Monitorimi i zbatimit të planit strategjik është vendimtar për të vlerësuar arritjen e rezultateve të parashikuar, si dhe për të evidentuar shmangiet nga rezultatet e pritura me qëllim marrjen e masave për përmirësim.

Për këtë, *“Është e nevojshme të përcaktohen treguesit e performancës që do të përdoren nga strukturat drejtuese për të siguruar arritjen e vizionit të Administratës Tatimore dhe feedback të saktë mbi realizimin e aktiviteteve, mbështetur dhe promovuar përgjegjshmërinë dhe përmirësimin e vazhdueshëm, informimin e stafit për mënyrën se si është zbatuar Strategjia përmes punës së tyre, etj., çka do të siguronte instrumente për të vlerësuar performancën e strukturave të administratës tatimore dhe individëve, si dhe informacion të paanshëm që do të përdorej për analiza dhe ndryshime të Strategjisë, nëse do të ishte e nevojshme.”*<sup>28</sup>

<sup>28</sup> Administrata Tatimore e Malit të Zi: “Strategjia e administratës tatimore 2014-2019”, fq. 17.

*“Për të siguruar rezultate të matshme, është e rëndësishme që Strategjia të monitorohet dhe të vlerësohen në përputhje me metodologjinë e pranuar të treguesve të performancës.”<sup>29</sup>*

Për të arritur sa më sipër, është e domosdoshme që në dokumentin strategjik të administratës tatimore, të përcaktohen *treguesit e performancës* me anë të të cilëve do të vlerësohen rezultatet e arritura për çdo aktivitet, si dhe *targetat/ rezultatet* e synuara për çdo tregues, për periudhën që strategjia mbulon.

*“Treguesit e performancës janë indikatorë të matshëm, të cilat janë rënë dakord më parë, dhe që pasqyrojnë faktorët kritikë të suksesit të një organizate. Çdo tregues i performancës duhet të pasqyrojnë qëllimet e organizatës, të jetë thelbësore për suksesin e saj, si dhe të jetë i matshme.”<sup>30</sup> “Standardet (ose targetat) janë norma, korniza kohore ose drejtime (të tilla si: rritje, etj.) që i mundësojnë një organizate të përdor treguesit e performancës për të gjykuar mbi performancën.”<sup>31</sup>*

Përcaktimi i indikatorëve të performancës dhe targetave për secilin prej tyre është i rëndësishëm për të siguruar informacione të krahasueshme lidhur me rezultatet e synuara dhe rezultatet faktike të arritura për çdo aktivitet gjatë periudhës së implementimit të strategjisë, pra për të konkluduar mbi performancën e arritur.

Me qëllim monitorimin e vazhdueshëm dhe identifikimin në kohë të hapësirave për përmirësim, është e nevojshme që treguesit e performancës për çdo aktivitet të përcaktuar në strategji, të maten në bazë vjetore. *“Administrata Tatimore bën një vlerësim zyrtar të treguesve të performancës së Strategjisë, mbi baza vjetore”<sup>32</sup>*. Vlerësimi i treguesve të performancës në bazë vjetore dhe më pas, krahasimi i rezultateve me targetat e paracaktuar (synuar) i mundëson administratës tatimore, evidentimin e progresit të bërë apo shmangiet nga pritshmëritë, si dhe ndërmarrjen në kohë të veprimeve korrigjuese.

Referuar Ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, pika 6.1.3, njësitë publike për të ushtruar funksionin e kontrollit duhet që aktivitetet strategjike të markohen me treguesit e performancës dhe objektiva të matshëm/targeta. Kjo do të siguronte monitorimin e zbatimit të strategjisë nëpërmjet krahasimit plan-fakt.<sup>33</sup>

Nga analizimi i Planit Strategjik 2017-2021, identifikohet se, për aktivitetet e parashikuara për mbledhjen e borxhit tatimor janë parashikuar 4 tregues performance, me anë të të cilëve do të monitorohet realizimi i 5 aktiviteteve strategjike.

## **Gjetje:**

- Për asnjërin prej aktiviteteve dhe treguesve të performancës të parashikuar në Planin Strategjik 2017-2021 nuk janë përcaktuar rezultate të synuar apo targeta për t’u arritur vit pas viti.
- Nga analizimi i Planit Strategjik 2017-2021 vërehet se, megjithëse është një dokument strategjik, pra afatgjatë, 3 nga 5 aktivitetet strategjike të vendosura kanë afatin për t’u arritur në vitin e hartimit të strategjisë, konkretisht:
  - 3 prej 5 aktiviteteve strategjike kanë afatin për t’u arritur në vitin 2017.
  - 1 prej 5 aktiviteteve strategjike ka afatin për t’u arritur në vitin 2018.
  - 1 prej 5 aktiviteteve strategjike ka afatin për t’u arritur në vitin 2020.

<sup>29</sup> Administrata Tatimore e Kroacisë: “Strategjia e administratës tatimore 2014-2020”, fq. 25.

<sup>30</sup> FMN: “Administrimi i të ardhurave: Matja e performancës në administratën tatimore”, 2010, fq.5.

<sup>31</sup> FMN: “Administrimi i të ardhurave: Matja e performancës në administratën tatimore”, 2010, fq.5.

<sup>32</sup> Administrata Tatimore e Kroacisë: “Strategjia e administratës tatimore 2014-2020”, fq. 25.

<sup>33</sup> Udhëzim Nr. 21, datë 25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të Gjitha Niveleve”, Pika 6.2.1.

Në mungesë të targetave të përcaktuar në Planin Strategjik 2017-2021, grupi i auditimit u përpoq të identifikonte dhe analizonte trendin e rezultateve të arritura referuar treguesve të performancës të këtij plani strategjik.

- Në planet vjetore të DMDTP-së, nuk gjejnë pasqyrim treguesit e performancës të përcaktuar në Planin Strategjik 2017-2021.
- Referuar përgjigjeve të stafit të DMDTP, në intervistat zyrtare të drejtuara nga grupi i auditimit, treguesit e performancës të përcaktuar në strategji janë të pamatshëm<sup>34</sup>. Megjithatë, nga analizimi i planeve vjetore rezultoi se kjo Drejtori ka përdorur tregues të tjerë të sugjeruar nga FMN dhe të parashikuar në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike, për të matur ecurinë e mbledhjes së borxhit tatimor.
- Nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut nuk pati përgjigje mbi pyetësonin e dërguar nga grupi i auditimit<sup>35</sup>, por nga intervistat e zhvilluara me drejtues të këtij sektori kanë shpjeguar se “.. zhvillimi i metodave të reja të analizimit të të dhënave në mënyrë elektronike gjatë kontrollit tatimor i shërbejnë realizimit të nën-objektivit 2.3, por ato nuk janë të matshëm.”.
- Nga analizimi i procesit të hartimit të Planit Strategjik 2017-2021, nuk rezultoi të jenë kryer analiza apo vlerësime lidhur me relevancën e indikatorëve të performancës (të përcaktuar për të monitoruar progresin në drejtim të nën-objektivin 2.3 të Strategjisë), apo mundësinë praktike për t'i matur këto tregues.
- Nga konsultimi i minutave të takimeve të mbajtura në Komitetin e Përmblidhjes dhe Komitetin e Reformave gjatë periudhës 2017-2019, nuk rezultoi të jetë ngritur dhe diskutuar problematika e lidhur me aftësinë e cunguar e treguesve të përcaktuar në Strategji, për të monitoruar dhe vlerësuar performancën e mbledhjes së borxhit tatimor. Gjithashtu, nga konsultimi i vendimeve të dala nga Komitetet gjatë periudhës 2017-2019, nuk rezultoi që këto tregues të performancës të parashikuar në Planin Strategjik 2017-2021, të jenë “shfuqizuar” për të mos u përdorur për monitorimin e zbatimit të Strategjisë.

#### **Konkluzione:**

- *Mospërcaktimi i rezultateve të synuar për asnjë prej aktiviteteve/treguesve të performancës të parashikuar në Strategji nuk krijon mundësinë për të krahasuar (banchmarking) rezultatet e arritura nga implementimi i aktiviteteve me rezultatet e pritshme, çka e bën të pamundur vlerësimin nëse aktivitetet janë përmblidhur apo jo. Mungesa e rezultateve të pritshme të matshme (targetave), pas implementimit të 5 aktiviteteve të parashikuara për mbledhjen e borxhit tatimor, nuk siguron rezultate solide mbi të cilat mund të mbështetet monitorimi i vazhdueshëm dhe ndërhyrja në kohë e masave korigjuese nga strukturat drejtuese.*
- *Në mungesë të targetave vjetor është e pamundur të vlerësohet realizimi i këtyre aktiviteteve vit pas viti.*
- *Si rezultat se treguesit e performancës të vendosur në Strategji nuk janë të matshëm dhe nuk mund të përdoren për të monitoruar arritjen e nën-objektivit strategjik 2.3, Drejtoria ka përdorur tregues të sugjeruar nga FMN dhe tregues të përcaktuar në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike, për të matur ecurinë e borxhit tatimor.*

#### ➤ **Planet operationale**

---

<sup>34</sup>Përgjigja zyrtare e DMDTP, për Intervistën zyrtare të datës 13.07.2020 drejtuar nga grupi i auditimit, pika E. 25.

<sup>35</sup>E-maili zyrtar, datë 24.07.2020 që grupi i auditimit i ka drejtuar personit të caktuar si pikë kontakti, Drejtorit të DMR dhe P/Sektorit të Menaxhimit dhe Analizës së DMDTP, për të cilin nga DMR nuk pati përgjigje.

Krahas treguesve të performancës të përcaktuar në Planin Strategjik 2017-2021, të cilët vijojnë të jenë “në fuqi” për të monitoruar zbatimin e strategjisë, në planet operationale të DMDTP vjetore janë përcaktuar këto targeta sipas viteve:

- Për vitin 2018 rritje e arkëtimeve në masën 15% më shumë se viti i mëparshëm,
- Për vitin 2019 rritje e arkëtimeve në masën 10% më shumë se viti i mëparshëm,

Në kushtet kur borxhi tatimor ka vijuar të rritet vit pas viti, ndërsa targeti i vitit 2019 për mbledhjen e borxhit tatimor është ulur me 5% krahasuar me atë të vitit 2018, grupi i auditimit u përpoq të identifikonte analizat e kryera për përcaktimin dhe miratimin e targetave vjetorë nga Komitetet e menaxhimit të punës në DPT.

### **Gjetje:**

- Për pyetjen e drejtuar nga grupi i auditimit nëpërmjet intervistës zyrtare datë 13.07.2020. “Çfarë analizash keni kryer për përcaktimin e targetave vjetor të Drejtorisë për mbledhjen e borxhit tatimor”, DMDTP është përgjigjur “*Targeti nuk është vendosur nga drejtoria jonë dhe nuk na është kërkuar asnjë analizë e tillë*”<sup>36</sup>.
- Nga zbardhja e minutave të vendimeve të Komiteteve të menaxhimit të punës së DPT-së të vënë në dispozicion për G.A rezulton se, në mbledhjen e mbajtur në Komitetin e Përbushjes më datë 21.02.2019, Drejtori i DMDTP ka argumentuar se targeti i vendosur për vitin 2019 nuk është në përputhje me ligjin i cili kërkon mbledhjen e të gjithë detyrimeve tatimore, dhe vendosja e një targeti të tillë nuk motivon mbledhjen e detyrimeve tatimore në total “.. Ky indikator nuk mund t’i shërbej grupit të punës dhe aq më tepër të bëhet pjesë e metodologjisë për detajimin e planit si një tregues i pritshëm ku mund të mbështetet më pas realizimi.”<sup>37</sup> Pra, targetat operacionale dhe indikatorët e vendosur për mbledhjen e borxhit tatimor janë vendosur nga Komiteti i Përbushjes, pa marrë në konsideratë argumentimet e DMDTP-së.
- Për periudhën e auditimit në asnjë prej vendimeve të Komiteteve të menaxhimit të punës në DPT apo në konsultimin e minutave të mbledhjes së tyre, të vëna në dispozicion grupit të auditimit nuk rezulton përcaktimi apo miratimi i targetave si tregues për performancën e borxhit tatimor.

### **Konkluzion:**

- *Targetat operacionale të vendosur për vitet 2018-2019 nuk janë të miratuar duke mos siguruar kështu relevancën e tyre për të matur arritjen e objektivave operacionale.*

### **Rekomandime:**

1. Komiteti i Reformave të përditësojnë Planin Strategjik 2017-2021, duke lidhur në mënyrë specifike dhe të qartë aktivitetet strategjike me strukturat përgjegjëse për zbatimin e tyre. Mbështetur në analiza, të përditësohet strategjia me indikatorë të matshëm, të arritshëm dhe relevant, si dhe të përcaktohen dhe miratohen targetat/rezultatet e pritshëm strategjik dhe operacionale, me shifra dhe narrative, me qëllim që të forcohet më shumë funksioni i menaxhimit të detyrimeve tatimore të papaguara, rritja e efektivitetit të këtij procesi,

---

<sup>36</sup>Përgjigja zyrtare e DMDTP, për Intervistën zyrtare të datës 13.07.2020 drejtuar nga grupi i auditimit, pika E, fq. 3

<sup>37</sup> Referuar e mail-it zyrtar, të datës 22.02.2019 i vënë në dispozicion të G.A, nëpërmjet së cilës Drejtore e DMDTP-së në DPT i dërgon Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe gjithë anëtarëve të Komitetit të Përbushjes, prezentë në mbledhjen e zhvilluar në datë 21.02.2019.

përmirësimi i përmbushjes vullnetare të tatimpaguesve dhe roli i DPT-së në mbledhjen e borxhit.

*Qershor 2021*

➤ **Roli dhe funksionimi i Komiteteve të menaxhimit në DPT**

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili kryen detyrat e përcaktuara në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi bazuar në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore, miratuar me Urdhrin nr. 19, datë 22.2.2017 të Ministrit të Financave.

Për menaxhimin e institucionit për çështjet e reformës, për operacionet e përditshme dhe përmbushjes së detyrimeve si dhe në zbatim të rekomandimeve të FMN-së janë ngritur komitetet e menaxhimit të cilat kanë përbërje dhe detyra të caktuara. Kryetar i të tre komiteteve është Drejtori i Përgjithshëm i DPT-së dhe anëtarë janë tre Zv/Drejtorë të Përgjithshëm dhe drejtorë të drejtorive në DPT. Komitetet e menaxhimit të punës janë ngritur dhe kanë funksionuar si më poshtë:

Me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 17, datë 31.01.2014 “Për ngritjen e Komiteteve të menaxhimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për çështjet e reformës, për operacionet e përditshme dhe përmbushjes së detyrimeve” janë ngritur 3 komitete të menaxhimit të punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Në urdhër janë përcaktuar përbërja, numri, detyrat kryesore dhe të veçanta të secilit komitet, si më poshtë:

Komiteti i Reformave (10) i përbërë nga 2 bashkë Kryetarë (Zv/Ministër i Financave dhe Drejtori i DPT-së) dhe 8 anëtarë (3 Zv/Drejtorë të Përgjithshëm të DPT dhe 5 drejtorë drejtorie në DPT, 1 Drejtor i Drejtorisë Rajonale të TPM, 1 Drejtor i DRT Tiranë).

▪ Detyra kryesore: Drejtimi strategjik i DPT-së dhe mbikëqyrja e zbatimit të planit të reformave.

Komiteti i Operacioneve të Përditshme (9) i përbërë nga 1 Kryetar (Drejtori i DPT-së) dhe 8 anëtarë (3 Zv/Drejtorë të Përgjithshëm të DPT, 2 drejtorë drejtorie në DPT, 1 Drejtor i Drejtorisë Rajonale të TPM, 1 Drejtor i DRT Tiranë dhe 1 përfaqësues i MF).

▪ Detyra kryesore: Administrimi i procesit të planifikimit vjetor dhe monitorimit të performancës së DPT-së.

Komiteti i Përmbushjes së Detyrimeve (11) i përbërë nga 1 Kryetar (Drejtori i DPT) dhe 10. Anëtarë (3 Zv/Drejtorë të Përgjithshëm të DPT, 3 drejtorë drejtorie në DPT, 1 Drejtor i Drejtorisë Rajonale të TPM, 1 Drejtor i DRT Tiranë, 1 P/Spektori dhe 1 përfaqësues i MF).

▪ Detyra kryesore: Zbatimin e një sistemi modern të menaxhimit të rrezikut të pajtueshmërisë dhe promovimin e zhvillimit të strategjive të integruara të përmirësimit të pajtueshmërisë.

Kryetarët e Komiteteve përgatisin rregulloren e funksionimit të punës së Komitetit.

Me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 31, datë 07.04.2017 “Për ngritjen e Komiteteve të menaxhimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për çështjet e reformës, për operacionet e përditshme dhe përmbushjes së detyrimeve” është pakësuar me një anëtar Komiteti i Përmbushjes dhe është shfuqizuar Urdhri i Ministrit të Financave Nr. 17, datë 31.01.2014. Përbërja, numri, detyrat kryesore dhe të veçanta të secilit komitet janë të njëjta.

Me shkresë nr. 1226 prot., datë 18.01.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve drejtuar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është propozuar shfuqizimi i Urdhrit të Ministrit të Financave Nr. 31, datë 07.04.2017 sipas së cilës përbërja dhe statusi i të gjitha komiteteve dhe grupeve të punës të hartohen nga Drejtori i Përgjithshëm, kjo në vijim të rekomandimit të FMN-së, në raportin e dhjetorit të vitit 2017, i cili thekson heqjen e përfaqësuesit të MFE-së nga

Komitetet menaxheriale të DPT-së, pasi janë grupime menaxheriale të lidhura ngushtësisht me vendimet e institucionit.

Aktualisht Komiteti i Reformave (8), Komiteti Operacional (9) dhe Komiteti i Përbushjes (12) gjatë periudhës nën auditim janë ngritur e kanë funksionuar bazuar në 3 Urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së përkatësisht Nr. 16, datë 02.03.2018, Nr. 50, datë 14.08.2019 dhe Nr. 16/1, datë 21.03.2019, referuar dokumentacionit mbështetës i vënë në dispozicion të grupit të auditimit si dhe të intervistës zyrtare drejtuar strukturës drejtuese, datë 11.06.2020<sup>38</sup>, sipas së cilave ka pasur ndryshime në përbërje dhe numër anëtarësh. Ndërsa në Urdhrin nr. 16, datë 02.03.2018 është hequr pika ku Kryetarët e Komiteteve raportojnë tek Ministri, në baza mujore mbi punën e kryer dhe në Urdhrin Nr. 16/1, datë 21.03.2019 Komiteti i Reformave miraton Planet Operacionale vjetore dhe siguron harmonizimin dhe përputhshmërinë e tyre me planin strategjik të administratës tatimore.

Sekretariati Teknik i cili mbështet të tre komitetet e menaxhimit gjatë periudhës nën auditim është ngritur e ka funksionuar bazuar në 3 Urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së përkatësisht Urdhrit nr. 26, datë 26.04.2017 (3 anëtare); Urdhrit nr. 53, datë 04.09.2019 (3 anëtare); Urdhrit nr. 5, datë 28.01(3 anëtare), në të cilat janë përcaktuar edhe detyrat e tij.

Pas përgjigjeve të pyetësorëve dhe kërkesës për vënien në dispozicion të dokumentacionit shkresor mbi funksionimin, vendimet dhe minutat e mbajtura të takimeve të komiteteve të punës të DPT-së, grupit të auditimit iu paraqitën si vijon:

Nga Komiteti i Reformave për periudhën e auditimit 2017-2019 u paraqitën gjithsej 7 Vendime:

- Për vitin 2018 u paraqit 1 Vendim.
- Për vitin 2019 u paraqitën 6 Vendime.

Në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së Nr.16, datë 02.03.2018 përcaktohet se ky komitet mblidhet minimalisht një herë në 3 muaj<sup>39</sup>.

Nga Komiteti Operacional për periudhën e auditimit 2017-2019 u paraqitën gjithsej 9 Vendime:

- Për vitin 2018 u paraqitën 7 Vendime. Midis tyre:
- Për vitin 2019 u paraqitën 2 Vendime.

Në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së Nr. 16, datë 02.03.2018 përcaktohet se ky komitet mblidhet minimalisht një herë në muaj<sup>40</sup>.

Nga Komiteti Përbushjes për periudhën e auditimit 2017-2019 u paraqitën gjithsej 12 Vendime:

- Për vitin 2017 u paraqitën 3 Vendime.
- Për vitin 2018 u paraqitën 7 Vendime
- Për vitin 2019 u paraqitën 2 Vendime.

Në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së Nr.16, datë 02.03.2018 përcaktohet se ky komitet mblidhet minimalisht çdo 3 muaj<sup>41</sup>.

---

<sup>38</sup>Përgjigja zyrtare e DMDTP, për Intervistën zyrtare të datës 11.06.2020 drejtuar nga grupi i auditimit, pika 33, 34, faqe 5, 6.

<sup>39</sup> Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së Nr. 16, datë 02.03.2018, pika 1. 1, “Për ngritjen e Komiteteve të menaxhimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si dhe përcaktimi i rregullave të funksionimit për grupet e përhershme të punës”.

<sup>40</sup> Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së Nr. 16, datë 02.03.2018, pika 1.2, “Për ngritjen e Komiteteve të menaxhimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si dhe përcaktimi i rregullave të funksionimit për grupet e përhershme të punës”.

<sup>41</sup> Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së Nr. 16, datë 02.03.2018, pika 1.3, “Për ngritjen e Komiteteve të menaxhimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si dhe përcaktimi i rregullave të funksionimit për grupet e përhershme të punës”.

Të tre komitetet (Reformave, Operacioneve të Përditshme, i Përmbushjes së Detyrimeve) kanë mbi supe drejtimin, përgjegjësinë dhe autoritetin ligjor të vendimmarrjes në drejtimin strategjik, mbikëqyrjen e zbatimit e planit të reformave, administrimin e procesit të planifikimit vjetor, monitorimin e performancës së DPT-së, zbatimin e një sistemi modern të rrezikut të pajtueshmërisë dhe promovimin e strategjive të integruara të përmirësimit të pajtueshmërisë<sup>42</sup>. Duke shqyrtuar në vijueshmëri urdhrat e ngritjes së komiteteve të menaxhimit të punës në DPT-së, si dhe nga intervistat, informacionet në postë elektronike, për periudhën e auditimit 2017-2019 rezultojnë sa më poshtë.

### **Gjetje:**

- Nuk ka përgjigje nga MFE për miratimin e shkresës nr. 1226 prot., datë 18.01.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve drejtuar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në të cilën është propozuar shfuqizimi i Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 31, datë 07.04.2017<sup>43</sup>. Në mungesë të përgjigjes së MFE për të shfuqizuar urdhrin nr. 31, titullari ka kaluar kompetencat duke ndryshuar përbërjen e komiteteve, numrin e tyre dhe detyrat kryesore dhe specifike të secilit prej tyre.
- Nuk janë hartuar rregulloret mbi funksionimin e komiteteve dhe të sekretariatit teknik nga Kryetarët e Komiteteve të menaxhimit të punës së DPT-së, duke mos gjetur zbatim Urdhri i Ministrit të Financave Nr. 31, datë 07.04.2017 përsa kohë që nuk rezultojnë i shfuqizuar<sup>44</sup>.
- Komiteti i Reformave, për vitin 2017, për vitin 2018 është mbledhur 1 herë nga 4 herë minimalisht që duhej të mbledhej në vit; për vitin 2019 nuk është mbledhur në 3/mujorin e fundit të vitit.
- Në vendimet e këtij komiteti për periudhën e auditimit rezultojnë vetëm një vendim për DMDTP edhe ky për rishikim të ligjit tatimor që lidhet me marrëveshjet me këste, me synim zgjerimin e mundësisë së lidhjes së këtyre marrëveshjeve edhe për më shumë detyrime tatimore.
- Pra, Komiteti Operacional për vitin 2017 nuk është mbledhur; për vitin 2018 nuk është mbledhur 7 herë (prill, maj qershor, korrik, gusht, tetor, dhjetor) dhe për vitin 2019 nuk është mbledhur 10 herë (shkurt, mars, prill, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor) dhe nuk ka asnjë vendim referuar DMDTP-së.
- Komiteti i Përmbushjes për vitin 2017 nuk është mbledhur 3/mujorin e parë, 3/mujorin e tretë; për vitin 2018 nuk është mbledhur 3/mujorin e parë dhe për vitin 2019 nuk është mbledhur 3/mujorin e dytë, të tretë dhe të katërt. Nga zbardhja e minutave të takimeve të Komitetit të Përmbushjes nuk rezultojnë asnjë vendim i adresuar DMDTP-së.

### **Konkluzione:**

- *Komitetet e menaxhimit të punës së DPT-së nuk janë mbledhur sipas afateve të përcaktuara në pikat 1.1, 1.2, 1.3, të Urdhrit nr. 16, datë 02.03.2018 i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.*

---

<sup>42</sup> Detyra të përcaktuara që nga Urdhri nr. 17, datë 31.1.2014 të MF- së e në vijimësi sipas gjithë Urdhërove të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së (Urdhri i fundit të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së nr. Nr. 50, datë 14.08.2019).

<sup>43</sup>Referuar e-mail-it zyrtar të datës 24.07.2020 që grupi i auditimit i ka drejtuar personit të caktuar si pikë kontakti.

<sup>44</sup>Referuar Urdhrit të Ministrit të Financave Nr. 31, datë 07.04.2017 “Për ngritjen e Komiteteve të menaxhimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për çështjet e reformës, për operacionet e përditshme dhe përmbushjes së detyrimeve”, pika 11, faqe 3.

- *Nga konsultimi i minutave të mbajtura në Komitetin e Reformave, Komitetin e Operacional dhe Komitetin Përbushjes gjatë periudhës 2017-2019, nuk rezulton të jetë ngritur dhe diskutuar problematika e lidhur me aftësinë e cinguar e treguesve të përcaktuar në Strategji, për të monitoruar dhe vlerësuar performancën e mbledhjes së borxhit tatimor.*
- *Komitetet e menaxhimit të punës së DPT-së nuk i kanë kryer me përgjegjësi detyrat e ngarkuara dhe aq më tepër si menaxherë të punës në krye të ATQ-së për të cilën borxhi tatimor ka pasur një trend rritje ndër vite dhe ka qenë gjithmonë një shqetësim për të gjitha qeveritë, por edhe për institucionet ndërkombëtare që kanë asistuar vendin.*

### **Rekomandime:**

2. Komitetet menaxheriale të punës në DPT të forcojnë rolin e tyre në drejtimin menaxherial nëpërmjet zhvillimi të takimeve në përputhje me Urdhrin nr.16, datë 02.03.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së dhe të monitorojnë zbatimin e Strategjisë së DPT-së në lidhje me menaxhimin e borxhit tatimor, me qëllim arritjen e objektivave dhe rritjen e performancës së institucionit.

*Shkurt 2021 dhe në vazhdimësi*

3. Komiteteve menaxheriale të punës në mbledhjet e tyre, të kenë një agjendë të mirëpërcaktuar për trajtimin e problematikave të lidhura me menaxhimin e borxhit tatimor.

*Janar 2021 dhe në vazhdimësi*

### **➤ Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Mbledhjes së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara.**

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara ka varësi nga Zv/Drejtori i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve dhe si objekt të saj ka udhëheqjen metodologjike dhe funksionin monitorues mbi drejtoritë rajonale tatimore, lidhur me procedurat e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara.

Struktura e DMDTP (ish-DMF) ka funksionuar me Urdhrin nr.126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit deri në 27.02.2019, me Urdhrin e ri nr.49, datë 27.02.2019 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 126 datë 2.08.2016 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të administratës tatimore Qendrore” dhe me Urdhër nr.86, datë 03.05.2019 “Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, të ndryshuar, në lidhje me DMDTP-në, struktura paraqet ndryshimin vetëm në emërtesë: Nga Drejtoria e Mbledhjes me Forcë në Drejtori e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara.

Rregullorja e brendshme e miratuar me Urdhër.19, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për funksionimin e Administratës Tatimore Qendrore” përcakton rregullat dhe detyrat për organizimin, funksionimin dhe marrëdhëniet, ndërmjet njërive të brendshme administrative dhe nëpunësve që ushtrojnë aktivitet në DPT dhe DRT. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara ka të miratuar në strukturë 8 punonjës: 1 Drejtor Drejtorie, 1 përgjegjës sektori, 6 inspektorë të parë.

Si ka funksionuar Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore (ish-DMF) krahasuar me strukturën e miratuar në nivel qendror dhe rajonal.

pozicionet e punës së drejtorit dhe p/sektorit të DMDTP-së në DPT paraqiten si në vijim:

-B.SH – me Urdhër nr.27 datë 03.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së “Për caktimin e një nëpunësi për ushtrimin e përkohshëm të funksioneve” nga Drejtore Drejtorisë së Mbledhjes

së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtor i DRT Tiranë, *pra nga 03.05.2019 e në vazhdim ky sektor ka rezultuar i paplotësuar me pozicionin e drejtorit të drejtorisë.*

-F.L – me Vendim nr. 282, datë 03.05.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së për delegim kompetencash nga inspektore e parë në P/Sektorin në Sektorin e Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve të Prapambetura.

Struktura e Drejtorisë së Mbledhjes të Detyrimeve Tatimore të Papaguara (ish-DMF) në nivel rajonat për çdo vit ka funksionuar si më poshtë:

Tabela 7: Numri i punonjësve dhe fondi i pagave për DMDTP për vitin 2017

Nr	DRT	Nr. punonjësve		Vendvakt	Numri punonjësve Fakt					Gjithsej Fondi pagave bruto/ lekë
		Plan	Fakt		Drejtor/P.Sekt	Sektori Menaxhim & Analizë Detyrim Prapambetura		Sektori Mon. Marrëvesh		
						Fakt	Diferencë	Fakt	Diferencë	
1	DPT	1+1+6	1+1+5	1	1	1+3	1 inspektor	2		6,840,000
2	DTM	1+2+7	1+2+6	1	1	1+4	1 inspektor	1+2		9,196,870
3	Tiranë	1+3+35	1+3+31	4	1	2+26	4 inspektor	1+5		28,159,074
4	Durrës	1+2+13	1+0+13	2	1	0+11	1 p/sectori	0+2	1 p/sekt	11,843,454
5	Elbasan	1+7	7	1	Delegim 1muaj	7				5,665,456
6	Fier	1+2+1+10	0+0+0+10	4	Delegim	0+10	1 p/sectori		2 insp	5,302,859
7	Korcë	1+7	1+7	0	1	7	-			7,622,481
8	Shkodër	1+2+1+8	1+2+0+7	2	1	0+7	1p/sekt, 1insp	2		7,467,824
9	Vlorë	1+6	0+6	1	-	6	1p/sectori			5,615,229
10	Dibër	1+3	0+1	3	-	1	3inspektor			3,163,653
11	Kukës	1+3	0+1	3	-	1	1p/sek, 2 inspektor			1,919,080
12	Gjirokastrë	1+4	1+2	2	1	2	2inspektor			4,159,327
13	Sarandë	1+3	0+3	1	-	3	1P/sekt			2,793,964
14	Lezhë	1+5	1+2	3	1	2	3 insp			2,943,840
15	Berat	1+6	1+5	1	1	5	1 inspektor			5,655,945

Burimi i të dhënave: DBNJ në DPT

Përpunoi: Grupi i auditimit

- Për vitin 2017, duke krahasuar numrin gjithsej të punonjësve sipas strukturës së planifikuar (152 punonjës) me numrin gjithsej të punësuar në fakt (123 punonjës) rezulton se kjo drejtori në nivel institucional të jetë e plotësuar rreth 81% ose 29 punonjës më pak, mungesa e të cilëve *grykojmë se shoqërohet me risk të lartë në mirëfunksionimin e punës.*
- Për vitin 2017, për DMDTP në nivel institucional fondi i pagave rezulton rreth 85 % i realizuar në krahasim me fondin e pagave të planifikuar.
- Sa më sipër nga drejtoritë rajonale të cilat janë të organizuara në drejtori rezultojnë të paplotësuar funksionet drejtor drejtorie (2) përkatësisht: DRT Elbasan dhe DRT Fier. Papolotësuar pozicioni i punës, Përgjegjës sektori në Sektorin e Menaxhimit & Analizës së Detyrimeve të Papaguara dhe në Sektorin e Monitorimit të Marrëveshjeve (3) përkatësisht: DRT Durrës, DRT Fier dhe DRT Shkodër.
- Nga drejtoritë rajonale të cilat janë të organizuara në sektorë rezultojnë të paplotësuar në funksionet drejtuese në pozicionin e përgjegjës sektorit (4) DRT: DRT Vlorë, DRT Dibër, DRT Kukës dhe DRT Sarandë.

Tabela 8: Numri i punonjësve dhe fondi i pagave për DMDTP për vitin 2018

Nr.	Sipas DRT	Nr. punonjësve		Vend vakant	Numri punonjësve Fakt					Gjithsej Fondi pagave bruto
		Plan	Fakt		Drejtor/P.Sekt	Sektori Men & Anal. Det Prap.		Sektori Mon. Marrëveshjeve		
						Fakt	Diferencë	Fakt	Diferencë	
1	DPT	1+1+6	1+0+5	2	1	0+4	1p/sektori	1	1inspektor	6,745,800
2	DTM	1+2+7	1+2+7	-	1	1+5		1+2		8,513,257
3	Tiranë	1+3+35	0+3+33	3	Deleguar 6 muaj	2+28	2 insp	1+5		32,041,391
4	Durrës	1+2+13	0+0+13	3	Deleguar 3 muaj	0+11	1p/ insp	0+2	1p/ insp	10,192,059
5	Elbasan	1+7	0+7	1	Deleguar 5 muaj	4	3 insp			5,273,800
6	Fier	1+2+1+10	0+0+1+10	3	Deleguar 9 muaj	1+10	2 insp		2 insp	6,880,193
7	Korcë	1+7	1+7	-	1	7		2		7,817,579
8	Shkodër	1+2+1+8	1+1++1+7	2	1	1+7	1p/insp&1 insp	2	-	7,468,263
9	Vlorë	1+6	1+5	1	1	5	1 insp			5,017,542
10	Dibër	1+3	0+1	3	-	1	2 insp			1,398,683
11	Kukës	1+3	0+2	2	-	Deleguar 3 muaj	2 insp			718,200
12	Gjirokastrë	1+4	1+2	2	1	2	2 insp			3,743,207
13	Sarandë	1+3	1+3	-	1	3				2,802,241
14	Lezhë	1+5	1+4	1	1	4	1 insp			3,968,857
15	Berat	1+6	1+5	1	1	5	1 insp			5,051,601

Burimi i të dhënave: DBNJ në DPT, punoi grupi i auditimit

- Për vitin 2018, duke krahasuar numrin gjithsej të punonjësve sipas strukturës së planifikuar (152) punonjës me numrin gjithsej të punësuar në fakt (128 punonjës) rezulton se kjo drejtori në nivel institucional të jetë e plotësuar rreth 84%, pra 24 punonjës më pak, mungesa e të cilëve *grykojmë se shoqërohet me risk të lartë në mirëfunksionimin e punës.*
- Për vitin 2018, për DMDTP në nivel institucional fondi i pagave rezulton 85 % i realizuar në krahasim me fondin e pagave të planifikuar.
- Sa më sipër drejtoritë rajonale të cilat janë të organizuara në drejtori rezultojnë të paplotësuar funksionet drejtor drejtorie (4) përkatësisht: DRT Tiranë, DRT Durrës, DRT Elbasan dhe DRT Fier.  
Paplotësuar pozicioni i punës, Përgjegjës sektori në Sektorin e Menaxhimit & Analizës së Detyrimeve të Papaguara dhe në Sektorin e Monitorimit të Marrëveshjeve (3): DPT, DRT Durrës, DRT Shkodër.
- Nga drejtoritë rajonale të cilat janë të organizuara në sektorë rezultojnë të paplotësuar në funksionet drejtuese në pozicionin e përgjegjës sektori në (2): DRT Dibër dhe DRT Kukës.

Tabela 9: Numri i punonjësve dhe fondi i pagave për DMDTP për vitin 2019

Nr.	Sipas DRT	Nr. punonjësve	Vend	Numri punonjësve Fakt			Gjithsej, Fondi pagave bruto
				Drejtor/P.	Sektori Men & Anal.	Sekt. Monitorim	

				Vakant	Sektori	Detyrime të Prapamb.		Marrëveshjeve		
		Plan	Fakt			Fakt	Diferencë	Fakt	Diferencë	
1	DPT	1+1+6	0+1+6	1	0	1+4		2		6,920,000
2	DTM	1+2+7	1+2+7	-	1	1+5		1+2		9,500,851
3	Tiranë	1+3+35	0+1+35	3	Delegim	1+30	1p/sekt	5	1p/sekt	33,694,366
4	Durrës	1+2+13	0+2+12	2	Delegim	1+10	1 insp	1+2	-	10,192,059
5	Elbasan	1+7	0+7	1	Delegim	7				4,883,543
6	Fier	1+2+1+10	1+2+1+10	-	1	1+10		2		8,407,121
7	Korcë	1+7	1+7	-	1	7				6,893,681
8	Shkodër	1+2+1+8	1+2+1+8	-	1	1+8		2		9,482,833
9	Vlorë	1+6	1+6	-	1	6				5,622,725
10	Dibër	1+3	0+1	3	-	1	2 insp			1,322,581
11	Kukës	1+3	1+2	1	1	2	1 insp			244,000
12	Gjirokastrë	1+4	1+2	2	1	2	2 insp			3,878,109
13	Sarandë	1+3	1+3		1	3				2,833,640
14	Lezhë	1+5	1+5		1	5				4,590,813
15	Berat	1+6	1+5	1	1	5	1 insp			4,758,520

Burimi i të dhënave: DBNJ në DPT, punoi grupi i auditimit

- Për vitin 2019, duke krahasuar numrin gjithsej të punonjësve sipas strukturës së planifikuar (152 punonjës) me numrin gjithsej të punësuar në fakt (138 punonjës) rezulton se kjo drejtori në nivel institucional të jetë e plotësuar rreth 91%, pra 14 punonjës më pak, mungesa e të cilëve *gjykojmë se shoqërohet me risk të lartë në mirëfunksionimin e punës*.
- Për vitin 2019, Për DMDTP në nivel institucional fondi i pagave i realizuar rezulton 90 % në krahasim me fondin e pagave të planifikuar.
- Sa më sipër drejtoritë rajonale të cilat janë të organizuara në drejtori rezultojnë të paplotësuar (4) funksionet drejtor drejtorie përkatësisht: DPT, DRT Tiranë, DRT Durrës dhe DRT Elbasan.
- Nga drejtoritë rajonale të cilat janë të organizuara në sektorë rezultojnë të paplotësuar në funksionet drejtuese në pozicionin e përgjegjës sektorit (1 DRT) përkatësisht: DRT Dibër.

Referuar Raportit të Asistencës Teknike për Shqipërinë, “*ndarja e burimeve dhe numri i zyrave rajonale dhe struktura e tyre janë joefikase, duke u bazuar në raportet e të ardhurave tatimore me vendosjen e stafit në të gjithë vendin dhe duke pasur parasysh ngarkesën aktuale të punës, nevojën për specializim dhe përdorimin e gjerë të automatizimit. Përvoja administrative moderne e taksave është që kur funksione të caktuar janë të konsoliduara në një (ose disa) vende, efektiviteti, cilësia e performancës dhe rritja e efikasitetit do të ketë uniformitet më të madh në procese dhe vendimmarrje*”<sup>45</sup>.

Përshkrimi i punës për Drejtorin e DMDPT në DPT dhe në DRT; për përgjegjësin e sektorit në drejtori qendrore dhe rajonale, për inspektorin e parë në drejtori qendrore dhe inspektorin e dytë në drejtoritë rajonale janë të miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MFE dhe për punonjësit e DMDTP në DPT nuk rezulton parregullsi.

Për të parë si kanë qenë plotësuar pozicionet e punës në lidhje me Delegimet në nivel drejtues (drejtor/përgjegjës sektorit) për të gjitha DRT-të paraqitet tabela më poshtë:

Tabela 10: Delegimi në nivel drejtues sipas DRT-ve

Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	DRT	Periudha delegimit
I.T	Drejtor Drejtorie	Tiranë	13.6.2017 deri 4.2.2020

<sup>45</sup> Raportit të Asistencës Teknike për Shqipërinë, i përgatitur nga një ekip i stafit të FMN-së në janar 2019, pika 16, 17.

G.B	P/Sektori DMDTP	Berat	22.6.2017 deri 4.2.2020
E.M	Drejtor Drejtorie	Elbasan	1.11.2017 deri 16.5.2018
H.Ç	Drejtor Drejtorie	Elbasan	23.9.2019 në vazhdim
N.S	Drejtor Drejtorie	Elbasan	22.1.2019 deri 22.9.2019
T.D	Drejtor Drejtorie	Durrës	16.3.2018 deri 21.1.2020
N.M	P/Sektori DMDTP	Sarandë	10.10.2018 në vazhdim
Z.SH	Drejtor Drejtorie	Fier	22.12.2016 deri 18.4.2019
A.C	P/Sektori DMDTP	Durrës	Transf.përkoh (6 muaj) 25.5.2018- 25.11.2018

Burimi: Të dhëna nga DBNJ në DPT

Përpunoi: Grupi i auditimit

Duke u bazuar në data bazën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore mbi trajnimet e vazhdueshme të punonjësve të DMDTP-së për çdo DRT, me qëllim kualifikimin dhe rritjen profesionale si domosdoshmëri në realizimin e misionit dhe funksioneve të saj rezulton se:

Tabela 11: Numri i trajnimeve për punonjësit e DMDTP për çdo DRT për vitet 2017-2019

Nr	DRT	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
1	DPT	-	-	2
2	DTM	1	7	9
3	Tiranë	13	12	10
4	Durrës	-	13	15
5	Elbasan	2	5	2
6	Fier	7	8	14
7	Korcë	4	9	-
8	Shkodër	3	2	10
9	Vlorë	4	4	4
10	Dibër	2	1	3
11	Kukës	2	1	-
12	Gjirokastrë	4	3	1
13	Sarandë	1	2	5
14	Lezhë	4	9	7
15	Berat	9	5	2
	<b>Gjithsej</b>	<b>56</b>	<b>81</b>	<b>84</b>

Burimi i të dhënave: DBNJ në DPT

Përpunoi: Grupi i auditimit

### Gjetje:

- Në total për periudhën 2017-2019, nga analizimi i strukturës në fakt krahasuar me planin, për DMDTP për të gjitha DRT-të konstatohen:
  - Vendet vakante përgjatë vitit 2017 janë 29 pozicione pune.
  - Vendet vakante përgjatë vitit 2018 janë 22 pozicione pune.
  - Vendet vakante përgjatë vitit 2019 janë 14 pozicione pune.
- Drejtoritë për shkak të vendeve vakante të pozicionit Drejtor/Përgjegjës Sektori, kanë funksionuar me delegime në mungesë të plotësimi të tyre sipas procedurave ligjore.
- Në vitin 2017 janë trajnuar 46% e numrit gjithsej të punonjësve të kësaj drejtorie dhe 49 punonjësve kanë ndjekur trajnime në përshtatje me fushën e tyre të punësimit: Mbledhja e të ardhurave tatimore, Organizimi funksioni dhe detyrat, Manuali i mbledhjes me forcë". Në vitin 2018 janë trajnuar 63% e numrit gjithsej të punonjësve të kësaj drejtorie dhe të gjithë punonjësit kanë ndjekur trajnime në përshtatje me fushën e tyre të punësimit: Mbledhja e të ardhurave tatimore, Organizimi funksioni dhe detyrat, Manuali i mbledhjes me forcë". Në vitin 2019 janë trajnuar 60% e numrit gjithsej të punonjësve të kësaj drejtorie. 15 punonjës ose

11% e tyre kanë ndjekur trajnime në përshtatje me fushën e tyre të punësimit: Mbi zbatimin e të gjitha masave shtrënguese të mbledhjes me forcë, Manualin e mbledhjes me forcë.

Në kuadër të implementimit të Projektit të Fiskalizimit si dhe të rekomandimeve të lëna të FMN-së, për vitin 2020 është bërë përqendrimi i funksionit të mbledhjes së detyrimeve të prapambetura në 4 drejtori (rajoni verior qendror, jugor dhe DTM); 3 sektorë dhe një inspektor duhet të ndjekë afërsisht 900 tatimpagues. Gjithsej për 3 rajonet numri punonjësve do jetë 144, për DMDTP në DPT do jetë 12 punonjës. Sipas strukturës organizative Zv.Drejtori i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve mbikëqyr aktivitetin e DMDTP dhe është përgjegjës për përmbushjen e misionit dhe funksioneve të kësaj drejtorie.

### **Konkluzione:**

- *Vendet e lira të punës në DMDTP përgjatë periudhës 2017-2019 tregojnë mangësi në procesin e realizimit të strukturës së miratuar si dhe mangësi në procesin e rekrutimeve në punë të punonjësve. Gjithashtu, mosplotësimi me staf i kësaj drejtorie si dhe kryerja e punës nga specialistët në mungesë të drejtorëve të drejtorive dhe të P/Sektorit në disa DMDTP përgjatë periudhës nën auditim 2017-2019 gjykojmë se shoqërohet me risk të lartë në mirëfunksionimin e punës.*
- *Delegimi i kompetencave është një instrument ligjor i cili parashikohet të përdoret për detyra të caktuara, për një afat të caktuar kohor në funksion të performancës së institucionit dhe jo për t'u përdorur në masë për delegimin e një pozicioni vakant pune me të gjitha atributet e veta dhe në një afat të pacaktuar duke u shndërruar në një mekanizëm të përhershëm. Për sa kohë Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 23.10.2015, ndalon delegimin e detyrave të caktuara të një pozicioni pune nuk mundet këto pozicione të mbahen nga nëpunës të deleguar në periudha afatgjata apo një vjeçare, duke cënuar kështu përmbushjen e misionit të punës së këtij pozicioni.*
- *Trajnimi i punonjësve të mbledhjes me forcë nuk është shtrirë në të gjithë strukturën e DMDTP, dhe për vitin 2019 një përqindje e ulët e stafit janë trajnuar në përshtatje me funksionet që kryejnë, duke mos kontribuar në zhvillimin e të gjithë stafit e mbledhjes me forcë.*

### **Rekomandim:**

4. Titullari i DPT-së të ndërmarrë masat e nevojshme për të plotësuar bazën rregullatore duke nisur me miratimin e rregulloreve mbi funksionimin e komiteteve të punës në DPT ku të përcaktohen rregullat dhe detyrat e secilit komitet të menaxhimit si dhe të Sekretariatit Teknik, si dhe të ndërmarrë masat e nevojshme për plotësimin e vakancave në strukturat e menaxhimit të borxhit tatimor edhe pas riorganizimit të këtyre të fundit.

*Shkurt 2021*

## **3.2 A ka rezultuar efektiv implementimi i masave për mbledhjen e borxhit tatimor?**

### **3.2.1 A janë zbatuar në mënyrë shteruese masat për menaxhimin e borxhit tatimor?**

#### **A. Zbatimi i masave shtrënguese**

- *Informacion i përgjithshëm*

Nga databaza e tatimpaguesve me detyrime tatimore të papaguara në vitin 2019, të vënë në dispozicion nga DPT, grupi i auditimit filtoi 20 tatimpaguesit me detyrimet më të larta tatimore të papaguara, për çdo DRT. Për këta tatimpagues, grupi i auditimit kërkoi përcjelljen e informacionit analitik nga strukturat e mbledhjes me forcë në secilin DRT (14), mbi:

- Statusin e tatimpaguesit (aktiv/ pasiv)
- Borxhin e secilit prej tatimpaguesve për vitet 2017 – 2019,
- Qarkullimin me kasë dhe TVSH-në e deklaruar në shitje,
- Masat shtrënguese të zbatuara gjatë periudhës nën auditim,
- Arkëtimet pas çdo mase shtrënguese,
- Komentet për ndërprerjen e masave shtrënguese, në rastet që rezultojnë të tilla,
- Përcjelljen e rasteve DHT-së dhe përgjigjet përkatëse nga kjo Drejtori.

### **Masat shtrënguese të marra në shqyrtim**

“Drejtoritë Rajonale Tatimore janë përgjegjëse për mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara si dhe për zbatimin e masave të parashikuara në Kreun XI me lëndë Mbledhja me Forcë e Detyrimit Tatimor të Papaguar të Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar”<sup>46</sup>. “Masat shtrënguese duhet të merren për totalin e borxhit të të njëjtit tatimpagues”<sup>47</sup>.

Masat shtrënguese për të cilat është kërkuar informacion nga DRT-të<sup>48</sup> janë:

- Njoftim dhe kërkesë për të paguar
- Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit
- Njoftim Tatimpaguesit për vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor
- Njoftim i Përgjithshëm për vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor
- Njoftim për vendosjen e Barrës Hipotekore
- Njoftim për vendosjen e Barrës Siguruese
- Pezullim të aktivitetit në Doganë
- Urdhër Sekuestro
- Konfiskimi i pasurisë së sekuestruar
- Shitja e pasurisë së konfiskuar

### ➤ **Stoku i borxhit të tatimpaguesve debitorë të marrë në shqyrtim**

Tabela 12: Totali i stokut të borxhit tatimor dhe stoku i borxhit i marrë në shqyrtim nga grupi i auditimit, 2017-2019

000/lekë

<b>DRT</b>	<b>Borxhi 2017</b>		<b>Borxhi 2018</b>		<b>Borxhi 2019</b>	
	<b>Totali</b>	<b>Marrë në shqyrtim</b>	<b>Totali</b>	<b>Marrë në shqyrtim</b>	<b>Totali</b>	<b>Marrë në shqyrtim</b>
<b>Berat</b>	646,900	189,549	695,890	201,147	784,086	238,119
<b>Dibër</b>	671,936	320,578	882,736	382,651	1,050,226	511,833
<b>Durrës</b>	3,658,717	1,930,197	7,860,824	2,309,269	9,166,735	2,887,361
<b>Elbasan</b>	3,889,135	2,419,392	4,339,528	2,487,122	4,674,733	2,645,281
<b>Fier</b>	2,370,748	874,058	2,711,659	1,182,420	2,987,688	1,270,887
<b>Gjirokastrë</b>	747,442	463,278	967,041	480,216	926,673	497,514

<sup>46</sup>Manuali i Mbledhjes me Forcë 2017, DPT, Kapitulli II, pika 2.2 “Drejtoritë Rajonale”, fq.6.

<sup>47</sup>Manuali i Mbledhjes me Forcë 2017, DPT, Kapitulli IV “Procedurat e mbledhjes me forcë”, fq.11.

<sup>48</sup>Referuar Manualit të Mbledhjes me Forcë 2017, DPT, Kapitulli IV “Procedurat e mbledhjes me forcë”.

<i>Korçe</i>	2,482,219	993,065	2,430,808	1,043,226	2,364,166	1,103,784
<i>Kukës</i>	665,217	377,966	682,953	427,833	740,180	454,908
<i>Lezhë</i>	4,267,984	3,988,782	4,567,046	3,703,848	5,649,500	4,589,698
<i>Sarandë</i>	747,432	427,980	799,566	348,810	804,532	350,610
<i>Shkodër</i>	2,165,473	373,465	2,243,046	430,712	2,559,686	763,223
<i>Tiranë</i>	40,425,861	26,016,292	46,631,497	31,066,291	71,148,384	39,353,085
<i>DTM</i> <sup>49</sup>	30,306,801	11,818,734	30,240,315	11,995,472	11,242,411	10,217,826
<i>Vlorë</i>	2,460,078	N/A	2,647,628	N/A	2,895,228	N/A
<b>Totali</b>	95,505,943	50,193,336	107,700,537	56,059,017	116,994,228	64,884,129
<b>Borxhi i marr në shqyrtim në % ndaj totalit të vitit përkatës</b>		53%		52%		55%

Burimi: DPT dhe DRT-të

Përpunoi: Grupi i auditimi

### Gjetje:

- Grupi i auditimit nuk mundi të analizojë ecurinë e borxhit tatimor dhe zbatimin e masave shtrënguese për 20 tatimpaguesit (debitorë) më të mëdhenj të DRT Vlorë pasi kjo Drejtori nuk iu përgjigj kërkesës tonë për informacion.
- Stoku i borxhit i 20 tatimpaguesve më të mëdhenj të 13-DRT-ve marrë në shqyrtim nga grupi i auditimit, rezultojn të përbërë rreth:
  - 53% të totalit të stokut të borxhit për vitin 2017,
  - 52% të totalit të stokut të borxhit për vitin 2018,
  - 55 % të totalit të stokut të borxhit për vitin 2019.
- Stoku i borxhit të 20 tatimpaguesve më të mëdhenj të 13 DRT-ve, në fund të vitit 2018 rezultojn 5,865,681 mijë lekë më i lartë se ai në fillim të vitit.
- Stoku i borxhit të tatimpaguesve të marrë në shqyrtim, në fund të vitit 2019 rezultojn 8,825,112 mijë lekë më i lartë se ai në fillim të vitit.
- Në vitin 2019, në totalin e stokut të borxhit të shtuar të 20 tatimpaguesve të marrë në shqyrtim në DRT Tiranë, 4.400,000 mijë lekë<sup>50</sup>ose 53% e shtesës ka ardhur si rezultat i rivlerësimit tatimor për tatimpaguesin Deveron OIL Albania, në dt. 07/08/2019.
- Në vitin 2018, totali i stokut të borxhit tatimor është rritur me 13%. Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme rezultojn se, stoku i borxhit i marrë në shqyrtim në secilën prej DRT-ve Tiranë (19%), Durrës (20%), Dibër (19%), Fier (35%) dhe Shkodër (15%), gjatë vitit 2018 është rritur me mbi 13%.
- Në vitin 2019, totali i stokut të borxhit tatimor është rritur me 9%. Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme rezultojn se, stoku i borxhi i marrë në shqyrtim në secilën prej DRT-ve Tiranë (27%), Durrës (25%), Lezhë (27%), Berat (18%), Dibër (34%) dhe Shkodër (77%), gjatë viti 2019 është rritur me mbi 9%.

### Konkluzione:

<sup>49</sup>Gjatë periudhës nën auditim, ka patur transferime të tatimpaguesve debitorë nga DTM, në DRT të tjera.

<sup>50</sup>Raporti i performancës DMDTP, në DPT, Janar 2020.

- Si rezultat se DRT Vlorë nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion, grupi i auditimit nuk ka mundur të analizojë ecurinë e borxhit tatimor dhe zbatimin e masave shtrënguese për 20 tatimpaguesit (debitorë) më të mëdhenj të kësaj DRT-je.
- Gjatë viteve 2018-2019 borxhi i marrë në shqyrtim në secilën prej DRT-ve Tiranë, Durrës, Dibër dhe Shkodër rezultoi të jetë rritur me një normë më të lartë se norma e rritjes së totalit të stokut të borxhit tatimor në vitet përkatëse, duke ndikuar negativisht në rritjen e borxhit tatimor.

#### Rekomandim:

5. Titullari i institucionit të iniciojë një auditim të brendshëm mbi veprimtarinë e kryer nga DRT Vlorë gjatë periudhës 2017-2019 për mbledhjen me forcë të borxhit tatimor, për sa kohë kjo drejtori nuk iu përgjigj kërkesave për informacion të grupit të auditimit.

*Shkurt 2021*

#### ➤ *Statusi, arkëtimet dhe nr. i tatimpaguesve debitorë në proces gjyqësor*

Tabela 13: Të dhëna mbi 20 tatimpaguesit e marrë në shqyrtim, në 13 DRT

Dega	Statusi në nr. tatimpaguesish dhe vlerë borxhi 2019 (000/lekë)				Arkëtimet 2019 (000/lekë)	Në proces gjyqësor 2017-2019
	Pasiv		Aktiv			
Durrës	17	2,537,176	3	350,185	772	2
Fier	10	840,091	10	430,796	39,962	3
Kukësi	11	115,384	9	339,524	3,316	2
DTM	2	1,151,753	18	9,066,073	1,000,018	11
Gjirokastrë	11	371,992	9	125,522	44,692	2
Tiranë	10	20,937,234	10	18,415,851	0	1
Korçë	15	1,012,831	5	90,953	314	2
Sarandë <sup>51</sup>	11	266,655	6	45,345	16,301	1
Shkodër	13	454,694	7	308,529	26,259	2
Dibër	0	0	20	511,833	20,000	1
Elbasan	20	2,645,281	0	0	0	0
Lezhë	12	4,336,848	8	252,850	15,897	0
Berat	10	110,579	10	127,540	16,990	5
<b>Totali</b>	<b>142</b>	<b>34,780,518</b>	<b>115</b>	<b>30,065,001</b>	<b>1,184,472</b>	<b>32</b>

Burimi: DRT-të

Përpunoi: Grupi i auditimit

#### Gjetje:

- Nga analizimi i të dhënave të mësipërme rezultoi se, tatimpaguesit me status pasiv përbëjnë 54% të borxhit të marrë në shqyrtim nga grupi i auditimit për vitin 2019.
- Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme, për 20 tatimpaguesit e marrë në shqyrtim në secilën prej 13-DRT-ve, të cilët zënë 55% të totalit të stokut të borxhit dhe e kanë shtuar atë me rreth 8.8 mld lekë në vitin 2019, niveli i arkëtimeve të realizuara nga zbatimi i masave shtrënguese është i ulët, në vlerën 1,184,472 mijë lekë. Peshën më të

<sup>51</sup> 3 tatimpagues në DRT Sarandë janë në proces c' regjistrimi.

lartë të arkëtimeve e zë DTM me 1,000,018 mijë lekë, ku 1 mld lekë janë arkëtuar nga zbatimi i masave shtrënguese për “O”. Vërehet se, megjithëse 20 tatimpaguesit e marrë në shqyrtim në DRT Tiranë kanë një nivel të lartë borxhi dhe 10 prej tyre janë me status aktiv, gjatë vitit 2019 nuk ka patur arkëtime nga zbatimi i masave shtrënguese për këta tatimpagues.

- Nga tabela vërehet se, 34% të tatimpaguesve debitorë në proces gjyqësor gjatë periudhës 2017-2019 rezultojnë në DTM.
- Nga analizimi i të dhënave të përcjella nga DRT-të e marra në shqyrtim, sikurse evidentohet edhe në raportet e inspektimit<sup>52</sup>, masat shtrënguese përgjithësisht kanë vijuar deri në Urdhër Sekuestro.

#### ➤ **Zbatimi i masave shtrënguese në DRT Dibër**

Në DRT Dibër evidentohet se zbatimi i masave shtrënguese nuk është kryer në mënyrë shteruese sikurse parashikohet në Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, Manualin e Mbledhjes me Forcë 2017, të DPT-së dhe Udhëzuesin e Përgjithshëm për Procedurat e Mbledhjes me Forcë 2018, të DPT-së.

Në 20 tatimpaguesit më të mëdhenj, të marrë në shqyrtim nga grupi i auditimit, evidentohen rastet e mëposhtme:

Tabela 14: Borxhi jo i ndjekur me masa shtrënguese në DRT Dibër, gjatë viteve 2017-2019  
000/lekë

NIPT	Tatimpaguesi	Statusi	Borxhi në fund 2017	Borxhi në fund 2018	Borxhi në fund 2019
.....	I	Aktiv	4,331	14,550	24,128
.....	K	Aktiv	15,905	18,766	20,426
.....	SH	Aktiv	9,313	13,932	16,857
<b>Totali</b>			<b>29,549</b>	<b>47,248</b>	<b>61,411</b>

Burimi: DRT Dibër

Përpunoi: Grupi i auditimit

#### **Gjetje:**

- Për tatimpaguesin “I”, me stok të shtuar borxhi në vitin 2018 në vlerën 10,219 mijë lekë, masa e fundit shtrënguese e vendosur “Njoftim Tatimpaguesit për vendosjen e masës së sigurimit” rezulton në 15/01/2018 dhe nuk është vijuar me vendosjen e masave të tjera shtrënguese. Në vitin 2019, ky tatimpagues rezulton me stok të shtuar borxhi në vlerën 9,578 mijë lekë. Referuar e-mailit zyrtar të dërguar nga DRT Dibër më datë 04/08/2020, “Njoftimi dhe kërkesa për të paguar” është realizuar “*nëpërmjet telefonit ose qendrës së thirrjes në Tiranë*”<sup>53</sup>. Gjatë këtij viti, për tatimpaguesin në fjalë, nga DRT Dibër nuk janë raportuar masa të tjera shtrënguese të ndërmarra.
- Për tatimpaguesin “K”, me stok të shtuar borxhi në vitin 2018 në vlerën 2,861 mijë lekë, dhe stok të shtuar borxhi në vitin 2019 në vlerën 1,660 mijë lekë është kryer vetëm njoftimi dhe kërkesa për të paguar nëpërmjet telefonit ose qendrës së thirrjes në Tiranë. Evidentohet se masa “Njoftim Tatimpaguesit për vendosjen e masës së sigurimit”, është vendosur për

<sup>52</sup>Raportet për inspektimet e kryera nga DMDTP gjatë periudhës 2017-2019, të konsultuara nga grupi i auditimit

<sup>53</sup>E-maili zyrtar DRT Dibër, 04.08.2020, drejtuar grupit të auditimit

herë të fundit në datën 17/07/2017. Masat shtrënguese “Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore”, “Njoftim për vendosjen e barrës siguroese” deri në “Pezullim të aktivitetit doganor” rezultojnë të jenë vendosur për herë të fundit në vitin 2015.

- Për tatimpaguesin “SH”, me stok të shtuar borxhi në vitin 2018 në vlerën 4,619 mijë lekë, dhe stok të shtuar borxhi në vitin 2019 në vlerën 2,925 mijë lekë, gjatë periudhës nën auditim është kryer vetëm njoftimi dhe kërkesa për të paguar nëpërmjet telefonit ose qendrës së thirrjes në Tiranë<sup>54</sup>. Masat e fundit shtrënguese të ndërmarra për këtë tatimpagues deri në pezullim të aktivitetit doganor, rezultojnë në vitin 2016.

Tabela 15: Borxhi jo i ndjekur me masa shtrënguese, në DRT Dibër gjatë vitit 2019

000/lekë

NIPT	Tatimpaguesi	Statusi	Borxhi në fund 2018	Borxhi në fund 2019
.....	L	Aktiv	10,879	28,260
.....	I	Aktiv	5,480	11,882
.....	G	Aktiv	12,692	20,221
.....	M	Aktiv	0	7,630
<b>Totali</b>			<b>29,051</b>	<b>67,993</b>

Burimi: DRT Dibër

Përpunoi: Grupi i auditimit

- Për tatimpaguesin “L” me stok të shtuar borxhi në vlerën 17,381 mijë lekë në vitin 2019, referur e-mailit zyrtar të dërguar nga DRT Dibër më 04/08/2020, njoftimi dhe kërkesa për të paguar është realizuar “*nëpërmjet telefonit ose qendrës së thirrjes në Tiranë*”. Gjatë këtij viti, për tatimpaguesin në fjalë nuk rezultojnë masa shtrënguese të tjera, të ndërmarra.
- Për tatimpaguesin “I” me stok të shtuar borxhi në vlerën 6,402 mijë lekë në vitin 2019, është kryer vetëm njoftimi dhe kërkesa për të paguar nëpërmjet telefonit ose qendrës së thirrjes në Tiranë. Gjatë këtij viti, për tatimpaguesin në fjalë nuk rezultojnë masa shtrënguese të tjera, të ndërmarra.
- Për tatimpaguesin “G” me stok të shtuar borxhi në vlerën 7,529 mijë lekë në vitin 2019, është kryer vetëm njoftimi dhe kërkesa për të paguar nëpërmjet telefonit ose qendrës së thirrjes në Tiranë. Gjatë këtij viti, për tatimpaguesin në fjalë nuk rezultojnë masa shtrënguese të tjera, të ndërmarra.
- Për tatimpaguesin “M” me stok të shtuar borxhi në vitin 2019 në vlerën 7,630 mijë lekë është kryer vetëm njoftimi dhe kërkesa për të paguar nëpërmjet telefonit ose qendrës së thirrjes në Tiranë. Gjatë këtij viti, për tatimpaguesin në fjalë nuk rezultojnë masa shtrënguese të tjera, të ndërmarra.

Referuar organigramës së miratuar Urdhër Nr. 86, datë 03.05.2009, Sektori i Mbledhjes me Forcë i DRT Dibër duhet të përbëhet nga 1 Përgjegjës sektori dhe 3 Inspektorë.

Nga konsultimi i organigramës së miratuar me atë faktike rezulton se:

- Në vitin 2017, në këtë sektor ka patur dy vakanca, 1 Përgjegjës Sektori dhe 1 Inspektor.
- Në vitin 2018 në këtë sektor ka patur tre vakanca, 1 Përgjegjës Sektori dhe 2 Inspektorë.
- Në vitin 2019, në këtë sektor ka patur dy vakanca, 1 Përgjegjës Sektori dhe 1 Inspektor.

Nga komunikimet me DRT Dibër, grupit të auditimit iu bë me dije se gjatë periudhës nën auditim kjo DRT ka bërë kërkesa drejtuar DPT-së për plotësimin e vakancave. Grupi i auditimit

<sup>54</sup>E-maili zyrtar DRT Dibër, 04.08.2020, drejtuar grupit të auditimit

ka konsultuar shkresën nr. 1469 prot., datë 18/04/2018, drejtuar DPT-së, sipas të cilës DRT Dibër kërkon plotësimin e vakancës për dy inspektorë në Sektorin e Mbledhjes me Forcë.

- Nga konsultimi i dokumentacionit të përcjellë nga DMDTP në DPT, gjatë periudhës nën auditim rezultoi se në DRT Dibër nuk janë kryer vizita inspektimi. Referuar realizimit të planeve operacionale të DMDTP-së, vizita e inspektimit për këtë DRT ishte planifikuar për vitin 2019, por nuk është realizuar.

#### **Konkluzione:**

- *Për 3 tatimpagues nga 20 të marrë në shqyrtim në DRT Dibër, me stok të shtuar borxhi në 2019 krahasuar me stokun e borxhit në fillim të vitit 2018 në vlerën 31,862 mijë lekë, masat shtrënguese për periudhën 2018 - 2019 nuk janë zbatuar në përputhje me Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara", Manualin e Mbledhjes me Forcë 2017 "Pjesa 4. Procedurat e Masave Shtrënguese", të DPT-së dhe Udhëzuesin e Përgjithshëm për Procedurat e Mbledhjes me Forcë 2018, të DPT-së.*
- *Për 4 tatimpagues nga 20 të marrë në shqyrtim në DRT Dibër, me 38,942 mijë lekë stok të shtuar borxhi në vitin 2019, gjatë këtij viti masat shtrënguese nuk janë zbatuar në përputhje me Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara", Manualin e Mbledhjes me Forcë 2017 "Pjesa 4. Procedurat e Masave Shtrënguese", të DPT-së dhe Udhëzuesin e Përgjithshëm për Procedurat e Mbledhjes me Forcë 2018, të DPT-së.*
- *Në total, në vitin 2019 stoku i borxhi prej 129,404 mijë lekësh i 7 tatimpaguesve në DRT Dibër, nuk është ndjekur me masa shtrënguese sikurse parashikohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.*
- *Në gjykimin e grupit të auditimit, mungesa e stafit të nevojshëm për të zbatuar masat shtrënguese, gjatë periudhës nën auditim ka ndikuar negativisht në realizimin e mbledhjes me forcë të borxhit tatimor në DRT Dibër.*
- *Monitorimi i kryer për DRT Dibër, nuk ka siguruar identifikimin e problematikave dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për zbatimin e masave shtrënguese për mbledhjen e borxhit tatimor për 35% të tatimpaguesve të marrë në shqyrtim nga grupi i auditimit në këtë DRT.*

#### **Rekomandim:**

6. DMDTP në DPT të kryejë një analizë të hollësishme mbi zbatimin e masave shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve të papaguara tatimore në DRT Dibër gjatë periudhës 2017-2019, të identifikojë problematikën e lidhura me zbatimin e tyre, dhe të ndër marrë masa për përmirësime të nevojshme.

#### **Shkurt 2021 dhe në vazhdimësi**

*Në përgjigje të observacionit të dërguar nga DPT, me shkresën nr. 434/3 prot., datë 13.11.2020 me objekt "Observacion për projekt-raportin e auditimit të performancës Ecuria e borxhit tatimor", sqarohet si më poshtë vijon:*

- **Pretendimi i subjektit:** Rekomandimi i mësipërm nuk pranohet pasi në strukturën e re organizative nuk ka më Drejtorin e Mbledhjes me Forcë në DRT Dibër.
- **Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Megjithatë si rezultat i ndryshimit të strukturës organizative, aktualisht në DRT Dibër nuk ka Drejtorin e Mbledhjes me Forcë, është e

nevojshme të analizohen faktorët që kanë ndikuar në moszbatimin e masave shtrënguese nga kjo Drejtori, për të nxjerrë mësimet e nevojshme me qëllim rritjen e efektivitetit të mbledhjes së borxhit tatimor nga strukturat e reja dhe për të ndërmarrë masa për mos përsëritjen e tyre në të ardhmen.

➤ **Vendosja e barrës siguroese**

Referuar Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Neni 91:

- pika 91.1 “...kur administrata tatimore konstaton se detyrimet tatimore nuk janë paguar prej tatimpaguesit në afatin e caktuar, ajo kërkon sigurimin e pagimit të këtij detyrimi nëpërmjet vendosjes së masave të sigurisë për të gjithë pasurinë e tatimpaguesit.”

-pika 91.2.1 “Masat e sigurimit të pasurisë vendosen nëpërmjet barrëve siguroese për pasuritë e luajtshme dhe hipotekës për pasuritë e paluajtshme të tatimpaguesit.”

-pika 91.2.5 “Barra siguroese merret si masë sigurimi për të gjitha pasuritë e luajtshme të debitorit.” “Për të bërë identifikimin e pasurive të luajtshme ndaj të cilave mund të vendoset një barrë siguroese, administrata tatimore, e cila është kompetente për nxjerrjen e vendimit për vendosjen e barrës siguroese, duhet t'i dërgojë njoftim të gjithë zyrave në Republikën e Shqipërisë, të cilat janë të ngarkuara nga ligji për të bërë regjistrimin e pasurive të luajtshme”.

Barrët siguroese mund të vendosen mbi:

- a) Automjetet,
- b) Ciklomotorët,
- c) Makinat bujqësore,
- d) Makinat teknologjike,
- e) Mallrat me numër serie, ku si të tilla do të konsiderohen ato mallrat që renditen si vijon: automjete, ciklomotorë, makina bujqësore, makina teknologjike, mjete fluturimi, mjete lundrimi, motomjete, motorë mjeti fluturimi, rimorkio, trolejbusë.
- f) Mjete fluturimi,
- g) Mjet lundrimi,
- h) Metalet dhe gurët e çmuar,
- i) Tituj pronësie mbi letrat me vlerë publike, si bonot e thesarit, dhe private si aksione, kambiale, çeqe etj.

Për të vendosur barrë siguroese mbi pasuritë e luajtshme të tatimpaguesit debitor, referuar Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” Neni 91, pika 91.2.8 “Administrata tatimore i kërkon informacion zyrave të regjistrimit të pasurive, të mjeteve motorike, mjeteve lundruese, të regjistrimit të aksioneve, të regjistrimit të titujve shtetërore, metaleve dhe gurëve të çmuar, nëse në emër të tatimpaguesit apo personave të tjerë ndaj të cilëve ajo ka nxjerrë vendimin për marrjen e masave të sigurisë, figurojnë të regjistruara në pronësi të tyre sende, të cilat ato janë të detyruara t'i regjistrojnë. Institucionet e mësipërme janë të detyruara brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit, të informojnë administratën tatimore nëse tatimpaguesi apo personat ndaj të cilëve ka dale vendimi kanë pasuri në emër të tyre apo jo.”

Pra, për të identifikuar pasuritë e luajtshme të tatimpaguesve debitorë administrata tatimore kërkon informacion duhet iu drejtuar të gjitha zyrave në R.SH që bëjnë regjistrim të pasurive të luajtshme, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Neni 91, pika 91.2.5 dhe pika 91.2.8.

- Nga të dhënat e përcjella nga 13 DRT-të rezulton se këto të fundit për zbatimin e masave shtrënguese dhe vendosjen e barrëve siguroese i janë drejtuar DRSHTRR/DPSHTRR dhe Bankave të Nivelit të Dytë<sup>55</sup>.
- Në evidencat vjetore të përgatitura nga DMDTP në DPT për vitet 2017-2019, për zbatimin e masave shtrënguese, DRT-të kanë vendosur barrë siguroese për tatimpaguesit debitorë edhe në QKB.
- Në Manualin e Mbledhjes me Forcë 2017 dhe Udhëzuesin e Përgjithshëm të Procedurave të Mbledhjes me Forcë 2018, të DPT-së, nuk identifikohen institucionet specifike të cilave DRT-të duhet t'i drejtohen për të marrë informacion mbi të gjithë pasuritë e luajtshme të tatimpaguesve debitorë. Në formatin “Njoftim për vendosjen e barrës siguroese” të miratuar<sup>56</sup>, si dhe në formatin që rezulton në sistemin C@ts, ky dokument i drejtohet DRSHTRR.

Grupi i auditimit ka kërkuar informacion zyrtar nga strukturat e mbledhjes me forcë në DRT Tiranë, DTM-së dhe DRT Durrës si mëposhtë:

1. “A është kërkuar informacion nga Drejtoria/Spektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, mbi pasuritë e luajtshme të tatimpaguesve debitorë, në të gjitha institucionet përgjegjëse që kanë detyrim ligjor regjistrimin e pasurive të luajtshme, në zbatim të Nenit 91, pika 91.2.5 dhe 91.2.8 të Udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar?”

2. “Cilësoni konkretisht institucionet përkatëse të cilave i jeni drejtuar për marrjen e informacionit dhe vendosjen e barrëve siguroese, gjatë periudhës 2017-2019, si dhe përcillni numrin e rasteve dhe evidencat shkresore që keni referuar në secilin prej këtyre institucioneve...”.

- DTM, përcjellë se “Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara DTM ka dërguar shkresën “Njoftim për Vendosjen e Barrës Siguroese” drejtuar DRSHTRR/DPSHTRR dhe pas përgjigjes zyrtare të këtij institucioni, nëse ky njoftim nuk është ankimuar nga tatimpaguesi, është dërguar Masa e Sigurisë mbi mjetet...”<sup>57</sup>
- DRT Tirana përcjellë se, për vendosjen e barrëve siguroese i janë drejtuar DPSHTRR dhe QKB-së.<sup>58</sup>
- DRT Durrës përcjellë se, “në lidhje me pasuritë e luajtshme DRT Durrës ka dërguar shkresa për vendosjen e barrës siguroese në DPSHTRR”.<sup>59</sup>

#### Gjetje:

- Gjatë periudhës nën auditim Drejtoritë/Sektorët e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara në DRT nuk kanë kërkuar informacion në të gjitha zyrat që regjistrojnë pasuri të luajtshme sipas përcaktimeve të nenit 91, pika 91.2.5 dhe pika 91.2.8 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

#### Konkluzion:

- Sa më sipër, përmban riskun që pasuri të tjera të luajtshme të tatimpaguesve debitorë, si mjete lundruese, etj., të mos jenë identifikuar dhe rrjedhimisht vijuar në fazat e tjera të mbledhjes me forcë, për këto pasuri.

<sup>55</sup>Vendosja e barrës së siguroese në QKB nuk ka qenë pjesë e masave të shqyrtuara nga grupi i auditimit

<sup>56</sup>Vënë në dispozicion grupit të auditimit nga DRT Tirana me e-mailin e datës 21.08.2020

<sup>57</sup>E-mail zyrtar DTM datë 20.08.2020, drejtuar grupit të auditimit.

<sup>58</sup>E-mail zyrtar DRT Tirana datë 21.08.2020, drejtuar grupit të auditimit.

<sup>59</sup>E-mail zyrtar DRT Durrës datë 26.08.2020, drejtuar grupit të auditimit.

### **Rekomandime:**

7. Titullari i institucionit në mbledhjet me Komitetet e punës në DPT të ndërmarrin masa për përditësimin e Manualit të Mbledhjes me Forcë, Udhëzuesit të përgjithshëm, si dhe dokumenteve të tjera të punës, për të siguruar identifikimin e të gjitha pasurive të luajtshme të tatimpaguesve debitorë mbi të cilat mund të vendoset barrë siguroese dhe vijimin me fazat e tjera të mbledhjes me forcë.

### **Qershor 2021**

8. Strukturat e mbledhjes me forcë në DRT, për të gjithë tatimpaguesit debitorë me mangësi në praktikën e ndjekur në lidhje me identifikimin e të gjithë pasurive të luajtshme dhe vendosjen e barrës siguroese për to, të plotësohen hapat e përcaktuara në pikën 91.2.5 të Nenit 91 të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me përparësi tatimpaguesit me nivel më të lartë të borxhit deri tek ata me nivel më të ulët të borxhit.

### **Shkurt 2021 dhe në vazhdimësi**

*Në përgjigje të observacionit të dërguar nga DPT, me shkresën nr. 434/3 prot., datë 13.11.2020 me objekt “Observacion për projekt-raportin e auditimit të performancës Ecuria e borxhit tatimor”, sqarohet si më poshtë vijon:*

- **Pretendimi i subjektit:** Rekomandimi “... përditësojë Manualin e Mbledhjes me Forcë, Udhëzuesin e përgjithshëm, si dhe dokumentet e tjera të punës, për të siguruar identifikimin e të gjitha pasurive të luajtshme të tatimpaguesve debitorë mbi të cilat mund të vendoset barrë siguroese...” pranohet pjesërisht. Pranohet pjesa për përditësimin e Manualit. Në vijim, sjellim në vëmendje se Organi Tatimor kryen veprimet proceduriale sipas përcaktimeve proceduriale në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- **Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Subjekti nuk ka paraqitur fakte të reja. Observacioni nuk pranohet.
- **Pretendimi i subjektit:** Rekomandimi “...për të gjithë tatimpaguesit debitorë me mangësi në praktikën e ndjekur në lidhje me identifikimin e të gjithë pasurive të luajtshme dhe vendosjen e barrës siguroese për to, të plotësohen hapat e përcaktuara në pikën 91.2.5 të Nenit 91 të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 24...” nuk pranohet pasi nga ana e Drejtorive Përgjegjëse të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara ndiqen të gjitha masat e përcaktuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, të Ministrit të Financave, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- **Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Subjekti nuk ka paraqitur fakte të reja. Observacioni nuk pranohet.

### **➤ Bashkëpunimi DRT-ish-ZRPP/ASHK<sup>60</sup>-DRSHTRR/DPSHTRR**

Referuar Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 91:

<sup>60</sup>Për vendosjen e barrës hipotekore strukturat e mbledhjes me forcë në DRT, i drejtohen zyra vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe asaj qendrore, ish-ZVRPP/ish-ZRPP, sot DRASHK/ASHK. Në vijim, grupi i auditimit i është referuar këtyre institucioneve si ish-ZRPP dhe ASHK.

-pika 91.2.3 “Akti me anë të të cilit kërkohet të vendoset hipoteka, i dërgohet Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ku ndodhet pasuria e paluajtshme e tatimpaguesit, apo ku ndodhet selia e tij, si dhe Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Në vendimin e vendosjes së hipotekës, nëse Dega Rajonale Tatimore apo Zyra Vendore e tatimeve nuk disponon të dhëna mbi pasurinë e paluajtshme të debitorit, së bashku me vendimin e saj, i kërkohet Zyrës Qendrore dhe asaj Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, që brenda një afati kohor prej 5 ditëve pune të bëjnë identifikimin e këtyre pasurive, dhe të bëjnë vendosjen në hipotekë të tyre në favor të administratës tatimore, deri në momentin që detyrimi tatimor i papaguar prej tatimpaguesit të jetë shlyer.”

-pika 91.2.5 “Për të bërë identifikimin e pasurive të luajtshme ndaj të cilave mund të vendoset një barrë siguroese, administrata tatimore, e cila është kompetente për nxjerrjen e vendimit për vendosjen e barrës siguroese, duhet t'i dërgojë njoftim të gjithë zyrave në Republikën e Shqipërisë, të cilat janë të ngarkuara nga ligji për të bërë regjistrimin e pasurive të luajtshme.”

-pika 91.2.8 “Administrata tatimore i kërkon informacion zyrave të regjistrimit të pasurive, të mjeteve motorike, mjeteve lundruese, të regjistrimit të aksioneve, të regjistrimit të titujve shtetërore, metaleve dhe gurëve të çmuar, nëse në emër të tatimpaguesit apo personave të tjerë ndaj të cilëve ajo ka nxjerrë vendimin për marrjen e masave të sigurisë, figurojnë të regjistruara në pronësi të tyre sende, të cilat ato janë të detyruara t'i regjistrojnë. Institucionet e mësipërme janë të detyruara brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit, të informojnë administratën tatimore nëse tatimpaguesi apo personat ndaj të cilëve ka dale vendimi kanë pasuri në emër të tyre apo jo”.

Për të siguruar informacion mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të tatimpaguesve debitorë, dhe për të vijuar kështu me zbatimin e masave shtrënguese, si vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese, sekuestrimin e pasurisë, etj, për periudhën nën auditim ka qenë i nevojshëm një bashkëpunim i ngushtë dhe i vazhduar midis A.T, ish-ZRPP/ASHK dhe zyrave të regjistrimit të pasurive të luajtshme.

Në tabelën e mëposhtëm, janë paraqitur tatimpaguesit debitorë për të cilët gjatë zbatimit të masave shtrënguese në periudhën nën auditim, nuk ka patur përgjigje nga ish-ZRPP/ASHK dhe ose DRSHTRR/DPSHTRR lidhur me pasuritë e tyre.

Në kolonën “Vitet” janë paraqitur vitet përkatëse në të cilat DRT-të i kanë dërguar “Njoftimin për vendosjen e barrës hipotekore” dhe “Njoftimin për vendosjen e barrës siguroese”, ish-ZRPP/ASHK-së dhe ose DRSHTRR/DPSHTRR-së.

- Në rastet e paraqitura në tabelën e mëposhtme, DRT Durrës ka përcjellë mungesën e përgjigjeve vetëm nga DRSHTRR-të/DPSHTRR (kjo DRT nuk ka përcjellë komente lidhur me korrespondencat me ish-ZRPP-të/ASHK), ndërsa në rastet e tjera mungesa e përgjigjeve është raportuar për ish-ZRPP-të/ASHK dhe DRSHTRR-të/DPSHTRR.
- DRT-të Dibër, Gjirokastrë dhe Lezhë nuk kanë përcjellë komente mbi korrespondencat me ish-ZRPP-të/ASHK dhe DRSHTRR-të/DPSHTRR, për zbatimin e masave shtrënguese.

#### **Gjetje:**

- Në vitin 2017, për 15 tatimpagues me vlerë borxhi 858,917 mijë lekë nuk ka patur përgjigje nga ish-ZRPP/ASHK dhe DRSHTRR/DPSHTRR.
- Në vitin 2018, për 25 tatimpagues me vlerë borxhi 5,299,170 mijë lekë nuk ka patur përgjigje nga ish-ZRPP/ASHK dhe/ose DRSHTRR/DPSHTRR.
- Në vitin 2019, për 30 tatimpagues me vlerë borxhi 13,411,106 mijë lekë nuk ka patur përgjigje nga ish-ZRPP/ASHK dhe/ose DRSHTRR/DPSHTRR.

- Mungesa e përgjigjeve nga ish-ZRPP-të/ASHK dhe/apo DRSHTRR-të/DPSHTRR, lidhur me pasuri në pronësi të tatimpaguesve të marrë në shqyrtim, vërehet në DRT-të Tiranë, Durrës, Sarandë dhe Kukës.

**Konkluzion:**

- *Për 12% të tatimpaguesve të marrë në shqyrtim me vlerë borxhi 13,411,106 mijë lekë në vitin 2019, si rezultat i mungesës së bashkëpunimit midis institucioneve të përfshira në mbledhjen me forcë të borxhit tatimor, Drejtoritë/Sektorët e Mbledhjes se Detyrimeve Tatimore të Papaguara nuk kanë mundur të identifikojnë nëse këta tatimpagues kanë apo jo pasuri në pronësi të tyre dhe të vijnë me zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese.*

**Barra Hipotekore**

Aktualisht, referuar Urdhrit të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë nr. 153 prot, datë 25.11.2019 *“Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 01.01.2020”*, vendojsa e barrëve hipotekore duhet të bëhet vetëm nëpërmjet aplikimit online në Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik, si dhe Vendimit Nr.389, datë 13.05.2020 *“Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale”*, pika 12, *“Barrët hipotekore dhe sekuestrot mbi pasuritë e paluajtshme, të vendosura nga administrata tatimore... regjistrohen vetëm duke paguar tarifën e shërbimit. I njëjti rregull zbatohet edhe për vendosjen në dispozicion të tyre kopje të kartelave, hartave kadastrale, të informacionit dhe dokumentacionit mbi pasuritë e paluajtshme...”*.

Tabela 16: Tatimpaguesit debitorë për të cilët nuk ka patur përgjigje nga ish-ZRPP-të/ASHK dhe DRSHTRR-të/DPSHTRR (000/ lekë)

Dega	NIPT	Tatimpaguesi	Statusi	Borxhi 2017	Borxhi 2018	Borxhi 2019	Viti
Durrës		K	Pasiv	481,023	481,303	481,318	2018
		T					
			Pasiv				
Durrës						354,561	2019
Durrës		T	Pasiv	291,139	291,268	291,268	2018-2019
Durrës		K	Aktiv	190,086	193,707	197,051	2018-2019
Durrës		A	Pasiv	1	147,872	147,892	2018-2019
		E					
Durrës			Pasiv	138,516	125,594	125,595	2019
Durrës		A	Pasiv	15,275	16,256	114,963	2019
Durrës		S	Pasiv	114,536	114,536	114,536	2018
Durrës		V	Pasiv	70,327	89,266	89,276	2018-2019
Durrës		S	Pasiv	863	87,375	87,375	2018
Durrës		K	Aktiv	314	70,092	71,129	2018-2019
Durrës		S	Pasiv	64,308	64,318	64,318	2018
Durrës		P	Pasiv	413	58,482	58,482	2019
Tiranë		A	Aktiv	834,120	871,056	905,523	2019
		T					
Tiranë			Pasiv	831,590	831,590	831,590	2019
Tiranë		F	Pasiv	855,363	857,603	1,150,907	2018-2019
Tiranë		X	Pasiv	519,074	628,879	737,675	2018-2019
Tiranë		T	Pasiv	1,491,709	1,506,302	2,383,640	2018-2019
Tiranë		D	Pasiv	76,051	148,079	5,055,617	2019
Tiranë		E	Pasiv	487,573	490,898	598,509	2017-2019
Saran da		B	Pasiv	204,046	148,223	148,223	2017 & 2019
Saran da		B	Pasiv	59,655	57,160	57,160	2017-2019
Saran da		B	Aktiv	26,115	24,504	24,022	2017-2019
Saran da		D	Pasiv	25,625	23,760	23,760	2017&2019
Saran da		B	Aktiv	1,411	1,060	5,470	2017&2019
Saran da		a	Aktiv	13,883	10,624	4,153	2017-2019
Saran da		A	Pasiv	4,026	4,016	4,016	2017-2019
Saran da		A	Aktiv	3,713	3,614	3,523	2017-2019
Saran da		A	Aktiv	1,612	1,540	2,847	2017-2019
		A					
Saran da			Pasiv	2,830	2,627	2,627	2017-2019
Saran da		X	Pasiv	14,415	13,055	13,055	2017-2019
Saran da		S	Pasiv	4,907	3,240	3,240	2017-2019
		O					
Saran da			Pasiv	5,727	2,209	2,962	2017-2019
Saran da		V	Aktiv	3,379	2,721	2,771	2017&2019
Kukës		D	Pasiv	702	4,938	4,938	2018

Burimi: DRT-të

Përpunoi: Grupi i auditimit

## Rekomandim:

9. DMDTP në DPT, nëpërmjet vizitave të inspektimit në Drejtoritë Rajonale Tatimore, të analizojë në mënyrë të detajuar dosjet e tatimpaguesve debitorë lidhur me zbatimin e masave shtrënguese dhe ndërveprimin e Drejtorive/Sektorëve të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara të DRT-ve me institucione të tjera, si dhe të kryejë intervista me stafin e Drejtorive/Sektorëve të mbledhjes me forcë. Problematikat e identifikuar të pasqyrohen në raportet e inspektimit, si dhe të ndërmerren masat e nevojshme për përmirësim e mbledhjes me forcë të borxhit tatimor.

### *Me hartimin e planeve të inspektimit*

*Në përgjigje të observacionit të dërguar nga DPT, me shkresën nr. 434/3 prot., datë 13.11.2020 me objekt "Observacion për projekt-raportin e auditimit të performancës Ecuria e borxhit tatimor", sqarohet si më poshtë vijon:*

- ***Pretendimi i subjektit:*** Rekomandimi "...monitorojë ndërveprimin e Drejtorive/Sektorëve të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara të DRT-ve me institucione të tjera, për zbatimin e masave shtrënguese, duke kërkuar raportime periodike nga DRT-të, si dhe të mbajë evidenca për problematikat e shfaqura..." nuk pranohet, nuk mund të mbahen evidenca për problematikat. Nëse konstatohen problematika, ato ndiqen rast pas rasti.
- ***Qëndrimi i Grupit të auditimit:*** Observacioni pranohet.

### ➤ ***Regjistrimi i barrëve siguruese***

Referuar Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Neni 91, pika 91.2.5 "Për vendosjen e barrëve siguruese administrata tatimore do të veprojnë në përputhje me Ligjin Nr.8537 datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese", Rregulloren e Barrëve Siguruese të miratuar nga Ministri i Ekonomisë, Energjetikës dhe Tregtisë Nr. 493, datë 06.07.2006, si dhe në përputhje me Udhëzimet e nxjerra nga Kryeregjistruesi i Barreve Siguruese."

Referuar ligjit Nr. 8537 datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese", Kreu IV, Regjistri i barrëve siguruese, Neni 25: "Regjistri i Barrëve Siguruese krijohet për regjistrimin e barrëve siguruese, pretendimeve dhe të drejtave që lindin nga ky ligj ose nga çdo ligj tjetër i cili kërkon ose lejon regjistrimin në Regjistrin e Barrëve Siguruese. Regjistri i Barrëve Siguruese është zyrë që vepron në varësi të Ministrisë së Financave."

Referuar Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Neni 91, pika 91.2.5 "Për vendosjen e barrës siguruese, në rastet kur administrata tatimore ka dijeni për sende të luajtshme në pronësi të tatimpaguesit apo të personave të tjerë ndaj të cilëve ajo ka nxjerrë urdhrin, vendosja e barrës siguruese bëhet sipas Formularit "Njoftimi C<sup>61</sup>- Regjistrimi i Pretendimeve Shtetërore" të Zyrës së Regjistrimit të Barrëve Siguruese", sipas modelit të përcaktuar në Rregulloren e Barrëve Siguruese të miratuar nga Ministri i Ekonomisë, Energjetikës dhe Tregtisë Nr. 493, datë 06.07.2006".

---

<sup>61</sup>Sipas Rregullores së Barrëve Siguruese, Nr.493, 06.07.2006, Neni 2, Njoftimi C -Regjistrimi i pretendimeve shtetërore.

Referuar Urdhërit të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Nr. 486, datë 29.05.2009, fq.1-2, shërbimet që kryhen në Regjistrin e Barrëve Siguruese bëhen kundrejt tarifave (p.sh. për regjistrimin e pretendimeve shtetërore, tarifa është 350 lekë).

Referuar Udhëzuesit të Përgjithshëm të Procedurave të mbledhjes me forcë të DPT-së, 2018, pika 6: *“Kur nga ana e organeve përgjegjëse identifikohen pasuritë e luajtshme mbi të cilat do të vendoset barra siguruese, Drejtoritë Rajonale janë përgjegjëse për njoftimin pranë Regjistrin të Barrëve Siguruese mbi të cilët është vendosur barra siguruese.”*

Në vijim të informacioneve të marra nga DRT-të, grupi i auditimit i drejtoi e-mail zyrtar Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës në DPT, për të identifikuar nëse ka patur një buxhet të alokuar për vendosjen e barrës siguruese nëpërmjet R.B.S-së. Në e-maili zyrtarë dërguar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në DPT, grupit të auditimit iu bë me dije se<sup>62</sup>:

- *“Nuk ka patur fond të parashikuar për vendosjen e barrës siguruese gjatë periudhës 2017-2019”*
- *“Për periudhën 2017-2019 nuk kemi patur pagesa mbi këtë zë pasi nuk mund të mbulohet me buxhetin e alokuar për tatimet”.*

Në përgjigje të e-mailit zyrtar të dërguar nga grupi i auditimit, strukturat e mbledhjes me forcë në DRT Tiranë, DRT Durrës dhe DTM, kanë përcjellë si mëposhtë:

- DTM<sup>63</sup>, për periudhën 2017-2019 ka bërë 6 regjistrime të barrëve siguruese në R.B.S,
- DRT Tirana nuk ka përcjellë regjistrime të kryera të barrëve siguruese në R.B.S, gjatë periudhës 2017-2019. *“Lidhur me R.B.S, ju bëj me dije se nga DPSHTRR është bërë vendosja e barrave siguruese si masë sigurie mbi mjetet e lëvizshme nga ana e DPSHTRR, pasi ka qënë në akses të kësaj drejtorie. Nga muaj tetor 2019 e në vazhdim në zbatim të ligjit 8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguruese” i ndryshuar Neni 26, Urdhri 493, datë 06.07.2006 “Për miratimin e rregullores së barrës siguruese, si dhe në zbatim të Urdhrit Nr. 486, datë 29.05.2009, pika të Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe në zbatim të shkresës së DPSHTRR-së, me nr. 19341/1 prot. datë 20.09.2019 janë vazhduar procedurat e njoftimit dhe regjistrimit për llogari të Regjistrin të Barrëve Siguruese.”*<sup>64</sup>,
- DRT Durrës nuk ka përcjellë regjistrime të kryera të barrëve siguruese në R.B.S, gjatë periudhës 2017-2019.<sup>65</sup>

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, identifikohet shkresa Nr.1934/1 prot. Datë 20.09.2019, e DPSHTRR drejtuar DPT-së dhe të gjitha DRSHTRR-ve, sipas të cilës:

- *“DPSHTRR me ndryshimet ligjore të administrimit të sistemit nga AKSHI, me implementimin e sistemit të ri elektronik të regjistrimit të mjeteve (për këtë qëllim), ... kryen regjistrimin e pasurive të luajtshme, dhe regjistrimi nuk është gjë tjetër veçse një mjet i nevojshëm për t'i dhënë publicitetin kontratës, për të bërë të njohur ekzistencën e saj dhe të pronarit nga të tretët. Regjistrimi ka funksionin e publikimit deklarativ, në këtë mënyrë DPSHTRR nuk mund të garantojë të drejtat tuaja, pasi nuk është institucioni kompetent që vendos barrë siguruese mbi pasurinë e debitorit.*
- Gjithashtu, me anë të kësaj shkrese DPSHTRR informon *“pas implementimit të sistemit të ri, i cili nuk përthith përmbajtjen mbi urdhrat e bllokimit nga sistemi i vjetër, si dhe në zbatim të Udhëzimit nr.4 datë 28.06.2019 “ Për dokumentet për qarkullim dhe regjistrim të mjeteve rrugore”, neni 4, pika 2/e përcaktohet se në dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim/*

---

<sup>62</sup> E-maili zyrtar dërguar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në DPT, drejtuar grupit të auditimit datë 18.08.2020.

<sup>63</sup>E-mail zyrtar dërguar grupit të auditimit nga DTM, datë 20.08.2020.

<sup>64</sup>E-mail zyrtar dërguar grupit të auditimit nga DRT Tirana, datë 21.08.2020.

<sup>65</sup>E-mail zyrtar dërguar grupit të auditimit nga DRT Durrës, datë 21.08.2020.

*ndryshim pronësie duhet: “konfirmimi nga Regjistri i Barrëve Siguruese sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-RBS”, nga data 01/11/2019 të gjithë urdhrat e bllokimit aktual që figurojnë në sistem do të zhbllokohen”. Lutemi që këto urdhra bllokimi t’i dërgohen organit kompetent që ka si fushë veprimtarie realizimin e kërkesave të tilla, siç është Regjistri i Barrëve Siguruese”.*

Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në DPT në e-mailin zyrtar<sup>66</sup> të dërguar grupit të auditimit, ka përcjellë shkresën nr. 1166, prot., datë 31.01.2020, dërguar nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në Drejtorinë Rajonale Elbasan me lëndë “Kërkesë për kryerje pagese të tarifës së shërbimit dhe dërgim në R.B.S” në të cilën citohet se: “Nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara vazhdojnë të na vijë kërkesa për pagesën e tarifës së shërbimit dhe dërgimit në R.B.S për dhjetëra e qindra subjekte”. Në këtë shkresë DRT Elbasan kërkon mundësinë për alokim fondi për të kryer këtë procedurë.

- Me shkresë nr.2684/1 prot., datë 11.02.2020 me objekt: “Dërgim shkrese”, DMDTP-ja në DPT, informon Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës në DPT lidhur me shkresën e dërguar nga DRT Elbasan.
- Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, në kthimin e përgjigjes për DMDTP-në, shkresa nr. 2684/2. prot. datë 12.02.2020 shprehet se kjo çështje e kalon funksionalitetin e kësaj Drejtorie, dhe për këtë rekomandon që DMDTP t’i drejtohet MFE-së, “pasi ajo është rregullatore e politikave të ndërmarra dhe duhet të ketë element të parashikimit të kësaj çështje.”

Nga dokumentacionet e vëna në dispozicion grupit të auditimit, nuk rezultojnë veprime të tjera të ndërmarra lidhur me këtë çështje. Në vijim të sa më sipër, grupi i auditimit ka kërkuar informacion nga DMDTP lidhur me masat e ndërmarra për të siguruar regjistrimin e barrëve siguruese në R.B.S. Kjo Drejtori nuk ka përcjellë qëndrim zyrtar lidhur me pyetjen e drejtuar nga grupi i auditimit.<sup>67</sup>

#### **Gjetje:**

- Gjatë periudhës nën auditim, DRT-të për vendosjen e barrës siguruese i janë drejtuar kryesisht DRSHTRR-ve/DPSHTRR dhe jo R.B.S. DRSHTRR-ve/DPSHTRR deri në 20.09.2019 kanë bërë bllokimin e mjeteve në emër të Adminsitratës Tatimore. Pas kësaj date, ka qenë i domosdoshëm regjistrimi i barrëve siguruese në R.B.S, për të vijuar me zbatimin e me masave të tjera shtrënguese.
- Deri në shkurt 2020 ngërçi për regjistrimin e barrëve siguresë në R.B.S, dhe vijimi me zbatimin e masave të tjera shtrënguese nuk ka gjetur zgjidhje.

#### **Konkluzion:**

- *Gjatë periudhës nën auditim procedura për regjistrimin e barrëve siguruese në R.B.S nuk është zbatuar dhe ndjekur në vazhdimësi. Gjatë kësaj periudhe nuk ka patur fonde buxhetor të planifikuar për pagesën e tarifave të shërbimit, të nevojshëm për zbatimin e saj.*

#### **Rekomandim:**

---

<sup>66</sup> E-maili zyrtar dërguar nga Drejtoria e Financës në DPT, drejtuar grupit të auditimit, datë 18.08.2020, ora.08:26 AM.

<sup>67</sup> Si rezultat se Përgjegjësja e Sektorit të Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve të Papaguara ishte me raport mjekësor, pika e kontaktit në DPT ia ka përcjellë e-mailin e grupit të auditimit, të gjithë stafit të DMDTP-së. 2 punonjës të kësaj Drejtorie, në përgjigje të e-mait të dërguar, janë shprehur se nuk kanë informacion.

10. DMDTM në DPT të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar regjistrimin e barrëve siguroese nga DRT-të, në Regjistrin e Barrëve Siguroese në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008. “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 91, pika 91.2.5 dhe Udhëzimit të përgjithshëm të procedurave të mbledhjes me forcë të DPT-së, pika 6.

*Shkurt 2021*

### **DMDTP- DHT**

Referuar Manualit të Mbledhjes me Forcë të DPT-së, Nr.14, datë 13/01/2017, pika 4.5.2:“Nëse gjatë zbatimit të masave shtrënguese për evidentimin e pasurisë së tatimpaguesit, nga ana e Drejtorisë/Sektorit të Mbledhjes me Forcë, nuk arrihet të përcaktohet adresa dhe pasuritë, e deklaruar në sistemin C@TS nga ana e tatimpaguesit<sup>68</sup>, subjekt i masave shtrënguese të mbledhjes së borxhit, nga Drejtoria/Sektori e Mbledhjes me Forcë, i drejtohet Drejtorisë së Hetimit Tatimor bazuar në nenin 105, të hetojë dhe të sigurojë informacionin e duhur për tatimpaguesin “

Referuar Udhëzuesit të Përgjithshëm të Procedurave të Mbledhjeve me Forcë të DPT-së, Nr. 5731 prot., datë 15/03/2018, pika 7: “Nëse gjatë zbatimit të masave shtrënguese për evidentimin e pasurisë së tatimpaguesit, nga ana e Drejtorisë/Sektorit të Mbledhjes me Forcë, nuk arrihet të përcaktohet adresa dhe pasuritë, subjekt i masave shtrënguese të mbledhjes së borxhit, nga Drejtoria/Sektori e Mbledhjes me Forcë, i drejtohet Drejtorisë së Hetimit Tatimor bazuar në nenin 105, të hetojë dhe të sigurojë informacionin e duhur për tatimpaguesin.”

Në ndryshim nga Manuali, Udhëzues i Përgjithshëm i dal më vonë në kohë, heq kufizimin për t’iu drejtuar Hetimit Tatimor në rastet kur strukturat e Drejtorisë/Sektorit të Mbledhjes me Forcë nuk përcaktojnë dot adresat dhe pasuritë e deklaruar në sistemin C@ts nga tatimpaguesi, duke udhëzuar përcjelljen tek Hetimi Tatimor për evidentimin e pasurisë të çdo rasti për të cilin nuk përcaktohet adresa/pasuria e tatimpaguesit e deklaruar apo jo në sistemin C@ts. Pas daljes së Udhëzuesit, nuk ka patur përditësim të Manualit.

Referuar Udhëzimit Nr. 41, datë 13.06.2017 “Për bashkëpunim ndërmjet strukturave të administratës tatimor për trajtimin e rasteve që përmbajnë elementë të veprës penale në fushën e tatimeve”, pika 7: “Inspektorët e Mbledhjes me Forcë, përcjellin në rrugë shkresore pranë Drejtorisë së Hetimit të Rajonit përkatës, pas miratimit nga Drejtori i Mbledhjes me Forcë dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore përkatëse, informacionin e disponuar përgjatë kryerjes së detyrave të tyre funksionale, si vijon:

- Rastet e tatimpaguesve të cilët me dashje nuk paguajnë detyrimet tatimore, që janë në procesin e mbledhjes me masa shtrënguese;
- Kur tatimpaguesi me dashje ndërhyt në mbledhjen e tatimit;
- Çdo rast tjetër për të cilin krijohet bindja e arsyeshme se përmban elementë të veprës penale.”

Në takimin e zhvilluar në DPT me Përgjegjësin e Sektorit të Hetimit Tatimor, grupit të auditimit i’u bë me dije se kjo strukturë pranon dosje të përcjella nga Drejtoritë/Sektorët e Mbledhjes me Forcë, në rastet kur janë zbatuar masat shtrënguese dhe kur vërtetohet se tatimpaguesi me dashje nuk paguan detyrimet tatimore. Sipas përfaqësuesit të Sektorit të Hetimit Tatimor, mospagimi me dashje identifikohet nëpërmjet kontrollit të bilancit të tatimpaguesit dhe/apo Deklaratave të Tatim Fitimit.

---

<sup>68</sup>Sipas komunikimeve me DMDTP në DPT, këtu bëhet fjalë për asetet që rezultojnë në bilancin e tatimpaguesit.

Edhe sipas interpretimit ligjor të përcjellë nga Drejtoria Juridike dhe Ligjore e DPT-së<sup>69</sup> grupit të auditimit, Drejtoritë/Strukturat e mbledhjes me forcë i drejtohen DHT-së në rastet kur plotësohen kushtet sipas Udhëzimit 41, datë 13.06.2017 ”Për bashkëpunim ndërmjet strukturave të Administratës Tatimore për trajtimin e rasteve që përmbajnë elementë të veprës penale në fushën e tatimeve”.

Grupi i auditimit i dërgoi e-mail zyrtar Drejtorisë Ligjore dhe Juridike në DPT (dt. 06.08.2020), mbi mënyrën se si identifikohen tatimpaguesit të cilët me dashje nuk paguajnë detyrimin tatimor, si dhe nëse është e përcaktuar në dokumentet zyrtare të punës.

Në e-mailin zyrtar të datës 26.08.2020 Drejtoria Ligjore dhe Juridike në DPT përcjellë “*Strukturat funksionale të administratës tatimore, (Strukturat e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, Kontrollit Tatimor dhe Hetimit Tatimor) verifikojnë dhe konstatojnë edhe rastet kur tatimpaguesi realizon të ardhura, por nuk paguan detyrimin e papaguar*”, duke referuar Udhëzimin 41, datë 13.06.2017 për koordinimin e sa më sipër.

Megjithatë, nga dokumentet e vëna në dispozicion grupit të auditimit, nuk ka një procedurë të mirëpërcaktuar për të identifikuar tatimpaguesit të cilët me dashje nuk paguajnë detyrimet tatimore. Në gjykimin e grupit të auditimit, kjo nuk siguron qartësi për identifikimin e këtyre rasteve.

Në kushtet kur:

- sipas Manualit, DMDTP i drejtohet DHT-së për evidentimin e pasurisë në rastet kur nuk përcaktohet adresa dhe pasuria e deklaruar në C@ts nga tatimpaguesi,
- sipas Udhëzuesit të Përgjithshëm, për evidentimin e pasurisë DMDTP i drejtohet DHT-së në çdo rast që nuk përcaktohet adresa dhe pasuritë e tatimpaguesit,
- sipas DHT-së dhe Drejtorisë Ligjore dhe Juridike, DMDTP i drejtohet DHT në rastet e evidentimit të elementeve të veprës penale,

grupi i auditimit u përpoq të identifikonte si është bërë përcjellja e dosjeve DHT-së deri më tani. Për këtë, grupi i auditimit i drejtoi pyetje zyrtare DHT-së dhe DMDTP-së mbi kushtet/kriteret që duhet të plotësohen që dosja e një tatimpaguesi debitor t'i përcillet Drejtorisë së Hetimit, nga Drejtoria/Spektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, *për të cilat grupi i auditimit nuk mori përgjigje, për pyetjen e drejtuar*<sup>70</sup>

Duke qenë se nuk evidentohet një procedurë e mirëpërcaktuar për të identifikuar tatimpaguesit të cilët me dashje nuk paguajnë detyrimin tatimor, në vijim të informacionit të marrë gjatë takimit të kryer me DHT-në në DPT, grupi i auditimit analizoi TF-të e 7 tatimpaguesve, nga listat e 20 më të mëdhenjve<sup>71</sup> të DRT Tiranë dhe DTM , të cilët rezultonin me xhiro kase, TVSH të deklaruar në shitje dhe që nuk rezultojnë në proces gjyqësor.

- Nga analizimi i 7 rasteve, në DTM u identifikua tatimpaguesi “A” me vlerë borxhi 123,844 mijë lekë, i cili rezulton me fitim gjatë periudhës 2017-2019, dhe nuk rezulton i referuar DHT-së.

Tabela 17: Borxhi dhe fitimi i tatueshëm neto 2017-2019 për subjektin “A”

000/lekë

<i>Tatimpaguesi “A”</i>	<i>Vlerë</i>
Borxhi 2017	9,840
Borxhi 2018	72,571

<sup>69</sup>E-maili zyrtar 30.07.2020, Drejtoria ligjore dhe Juridike në DPT, drejtuar grupit të auditimit.

<sup>70</sup>E-maili zyrtar i dërguar nga grupi i auditimit, datë 29.07.2020, ora 1:23 PM, Përgjegjëses së Sektorit të Standardizimit të Procedurave Ligjore në DMDTP. Në e-mail e datës 07. 08.2020, ora 02:03, Përgjegjësjë e Sektorit të Standardizimit të Procedurave Ligjore përgjigjet se ka pak ditë që ka kaluar në këtë sektor.

<sup>71</sup>Në DRT Durrës tatimpaguesit e marrë në shqyrtim i janë referuar Hetimit Tatimor.

Borxhi 2019	123,844
Fitimi 2017 <sup>72</sup>	254,006
Fitimi 2018	279,021
Fitim 2019	50,929

Burimi: DTM dhe Drejtoria IT në DPT, përpunoi grupi i auditimit

Sipas përgjigjes së ardhur nga DTM<sup>73</sup>, “*ky subjekt do t’i përcillet në vijim Hetimit Tatimor.*”

### Gjetje:

- Manuali i Mbledhjes me Forcë i DPT-së dhe Udhëzuesi i Përgjithshëm i Procedurave të Mbledhjes me Forcë i DPT-së nuk janë të harmonizuar lidhur me rastet e tatimpaguesve të cilët duhet t’i përcillen për ndjekje DHT-së. Pasi, sipas Manualit të Mbledhjes me Forcë, strukturat e mbledhjes me forcë duhet t’i drejtohen DHT-së për të evidentuar pasurinë e tatimpaguesi, të deklaruar në sistemin C@ts, në rastet kur ajo (pasuri) nuk përcaktohet dot. Ndërsa sipas Udhëzuesit të Përgjithshëm, këto struktura duhet t’i drejtohen DHT-së, për të evidentuar pasuria e tatimpaguesit debitor, pavarësisht nëse ajo (pasuria) është e deklaruar apo jo në sistemin C@ts, në rastet kur pasuria nuk përcaktohet dot.
- Nuk ka një procedurë të mirëpërcaktuar për të identifikuar tatimpaguesit të cilët me dashje nuk paguajnë detyrimet tatimore dhe që duhet t’i përcillen për ndjekje DHT-së, për të siguruar zbatimin e Udhëzimit Nr. 41, datë 13.06.2017 “Për bashkëpunim ndërmjet strukturave të administratës tatimor për trajtimin e rasteve që përmbajnë elementë të veprës penale në fushën e tatimeve”.
- Nga analizimi i 7 rasteve, në DTM u identifikua 1 tatimpagues me vlerë borxhi 123,844 mijë lekë, i cili rezulton me fitim gjatë periudhës 2017-2019, dhe nuk i është referuar DHT-së.

### Konkluzion:

- *Diferenca që ekziston midis Manualit të Mbledhjes me Forcë 2017 pika 4.5.2 dhe Udhëzuesit të Përgjithshëm të Procedurave të Mbledhjeve me Forcë 2018 pika 7, të DPT-së, mbi rastet të cilat duhet t’i përcillen DHT-së, si dhe mospasja e një procedure të mirëpërcaktuar për të identifikuar tatimpaguesit të cilët me dashje nuk paguajnë detyrimet tatimore nuk sigurojnë qartësi lidhur me rastet për përcjellje tek DHT, duke ndikuar negativisht në ndjekjen dhe mbledhjen e borxhit tatimor.*

### Rekomandime:

11. Titullari i institucionit në mbledhjet me Komitetet e menaxhimit të punës në DPT të ndërmarrin masat e nevojshme për të njëjshme për të njëjshuar Manualin e Mbledhjes me Forcë dhe Udhëzuesin e përgjithshëm, për rastet e tatimpaguesve debitorë të cilët duhet t’i përcillen për ndjekje DHT-së.

*Shkurt 2021*

12. DHT në bashkëpunim me DMDTP në DPT të ndërmarrin masat e nevojshme për të qartësuar dhe siguruar zbatueshmërinë e Udhëzimit Nr. 41, datë 13.06.2017 “Për bashkëpunim ndërmjet strukturave të administratës tatimor për trajtimin e rasteve që përmbajnë elementë të veprës penale në fushën e tatimeve”, pika 7, nga strukturat e mbledhjes me forcë.

*Shkurt 2021*

<sup>72</sup>Fitimi i tatuashëm neto, referuar TF-ve, përcjellë nga Drejtoria e IT-së në DPT.

<sup>73</sup> E-maili i Drejtorit të DMDTP në DTM, datë 30.07.2020.

13. DHT në bashkëpunim me DMDTP dhe DBNJ në DPT të zhvillojnë trajnime për inspektorët e mbledhjes me forcë, mbi identifikimin e rasteve të tatimpaguesve të cilët përmbajnë elemente të veprës penale, dhe përcjelljen e tyre për ndjekje DHT-së për të siguruar zbatimin e Udhëzimit Nr. 41, datë 13.06.2017.

### *Shkurt 2021 dhe në vazhdimësi*

*Në përgjigje të observacionit të dërguar nga DPT, me shkresën nr. 434/3 prot., datë 13.11.2020 me objekt "Observacion për projekt-raportin e auditimit të performancës Ecuria e borxhit tatimor", sqarojmë si më poshtë vijon:*

- **Pretendimi i subjektit:** Rekomandimet lidhur me rastet për përcjellje hetimit tatimor nuk pranohen për arsye se në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, DMDTP ndjek hapat procedurale të përcaktuara në Kreun XI. Dërgimi i procedurës për ndjekje nga Drejtoria e Hetimit e përcaktuar në nenin 105 kërkon nga DMDTP që t'i referohen Drejtorisë së Hetimit tatimor për tatimpagues objekt të masave shtrënguese për të cilat nuk gjenden adresa dhe pasuritë. Sjellim në vëmendje të KLSH-së se në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, detyrën për identifikimin e veprës penale e ka Drejtoria e Hetimit Tatimor.
- **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**
- Lidhur me rekomandimin nr. 11, sikurse është trajtuar në këtë raport, Manuali i Mbledhjes dhe Forcë dhe Udhëzuesi i Procedurave të Mbledhjes me Forcë nuk janë të harmonizuar midis tyre lidhur me rastet e tatimpaguesve të cilat duhet t'i përcillen hetimit tatimor.
- Rekomandimi nr. 12 bëhet "DHT në bashkëpunim me DMDTP në DPT..."
- Rekomandimi nr. 13 bëhet "DHT në bashkëpunim me DMDTP...". Observacioni pranohet pjesërisht.

## **B. Akt-Marrëveshjet me Këste**

*Auditimi u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:*

Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar.

Udhëzimi nr.24, datë 2.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Udhëzim Nr. 7, datë 10.1.2017 për disa shtesa në Udhëzimin Nr. 24, datë 2.9.2008 "për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Udhëzues i përgjithshëm i procedurave të mbledhjes me forcë, miratuar me nr. 5731 prot, datë 15.03.2018 nga Zv/Drejtori i Përgjithshëm.

Udhëzim nr.23, datë 13.8.2019 Për një ndryshim në Udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Manual i mbledhjes me forcë.

Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër nr. 1482/2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave.

Gjatë auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Databazë e Akt-Marrëveshjeve për vitin 2018.

Databazë e Akt-Marrëveshjeve për vitin 2019.

Bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 77 "Marrëveshja e pagesës me këste" është Akt

Administrativ që aplikohet nga drejtoritë rajonale tatimore për tatimpaguesit që nuk kanë mundësi për të paguar në afat detyrimet tatimore, dhe kanë vërtetuar që janë në kushtet e pamundësisë financiare për të paguar të plotë detyrimin tatimor, me aprovim dhe nënshkrim të Drejtorit të Drejtorisë Rajonale dhe tatimpaguesit. Rregullat për saktësimin e detyrave funksionale të këtij sektori përcaktohen në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore në nenin 113 – “Përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektorit të Sektorit të Monitorimit të Marrëveshjeve, midis të tjerave:

*Përgjigjen për realizimin e detyrave funksionale të Sektorit të Marrëveshjeve. Raportojnë tek Drejtori i Drejtorisë në lidhje me realizimin e detyrave të deleguara.*

*3. Mbajnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, regjistër përmbledhës për të gjitha marrëveshjet e pagesës me këste, lidhur nga çdo DRT, dhe monitorojnë zbatimin korrekt, siç parashikon ligji, të të gjitha marrëveshjeve të lidhura.*

*5. Identifikojnë problemet e lindura gjatë zbatimit të procedurave, dhe ofrojnë alternativa për zgjidhjen e këtyre problemeve, shqyrtojnë gjithashtu dhe shqetësime të ndryshme të adresuara nga tatimpaguesit në lidhje me procedurat e marrëveshjeve të pagesës me këste.*

*7. Nëpërmjet vizitave në DRT-të...- Ofrojnë këshillime dhe udhëzime të specializuara për marrëveshjet të cilat lidhen me tatimpagues në kushte të veçanta, përfshirë hartimin e përbashkët të marrëveshjes. - Analizon dhe kontrollon në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme ecurinë e punës dhe performancën e sektorit të marrëveshjeve në DRT, nxjerrë përgjegjësitë për mangësitë dhe të metat e konstatuara, si dhe përcakton detyra për përmirësimin e mëtejshëm të punëve për periodat në vazhdim.”*

Marrëveshja për pagesë me këste është implementuar në dhjetor të vitit 2018 në sistemin C@ts dhe mbahet për çdo lloj tatimi. Në sistem hidhet plani i marrëveshjes me këste dhe në mënyrë të automatizuar bëhet edhe llogaritja e kamatëvonesës dhe kryhet ndarja e numrit dhe vlerës së kësteve sipas detyrimit për të cilit është aprovuar marrëveshja. Gjithashtu nga sistemi gjenerohet urdhërpagesa duke krijuar kështu mundësinë e ndjekjes dhe monitorimit të çdo kësti pagese për çdo muaj.

Të gjitha analizat e akt- marrëveshjeve janë kryer mbi databazën e dhënë për vitin 2018 dhe 2019 nga Sektori i Marrëveshjes në DPT, pasi analiza e mirëfilltë për lidhjen e akt-marrëveshjeve, ndjekja dhe monitorimi i zbatimit nga tatimpaguesi i marrëveshjes me këste është detyrë e inspektorit të DRT-së që ka në ndjekje tatimpaguesin për mbledhjen me forcë të detyrimit.

- Për vitin 2017 kjo databazë nuk iu vu në dispozicion grupit të auditimit, por vetëm përmbledhëset vjetore.

Tabela 18: Akt-marrëveshjet e lidhura sipas numrit, llojit dhe vlerës për çdo lloj detyrimi të lidhur për vitet 2017-2019

000/lekë

Viti	TVSH		TF		Sig.Shoq & Shënd.		TAP		Të tjera		Shuma total	
	Nr.A-M	Vlera për të cilën lidhet A-M	Nr.A-M	Vlera për të cilën lidhet A-M	Nr.A-M	Vlera për të cilën lidhet A-M	Nr.A-M	Vlera për të cilën lidhet A-M	Nr.A-M	Vlera për të cilën lidhet A-M	Nr.A-M	Vlera për të cilën lidhet A-M
2017	372	427,057	476	1,079,834	487	269,203	111	32,516	459	4,658,946	721	6,467,555
2018	502	379,500	638	1,238,433	598	322,814	65	16,762	797	305,641	1,179	2,263,149
2019	382	310,910	611	1,239,611	464	266,228	36	6,538	557	185,397	1,022	2,008,685
	1256	1,117,467	1725	3,557,878	1549	858,245	212	55,816	1,813	5,149,984	2,922	10,739,389

Burimi i të dhënave: Sektori i Marrëveshjeve në DPT.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga sa më sipër vihet re se për vitet 2017-2019 peshën më të madhe në akt-marrëveshjet për pagesë me këste të lidhura e zë detyrimi për pagesën për “Detyrime të Tjera” në numër (1,813) dhe me vlerë detyrimi 5,149,984 mijë lekë. Si numër akt-marrëveshje të lidhura më shumë vijojnë ato të lidhura për “Detyrim tatim fitim” (1755) dhe më pas “Detyrimet për kontribute për sigurime shoqërore e shëndetësore” (1549), “Detyrimet për TVSH” (1256) dhe “Detyrime për tatim mbi të ardhurat personale” (212).

Në mënyrë analitike sipas viteve akt-marrëveshjet paraqiten si mëposhtë:

**Në vitin 2017** janë lidhur 721 marrëveshje me këste me vlerë totale 6,467,251 mijë lekë nga i cili “Detyrim për TVSH “427,057 mijë lekë, “Detyrim tatim fitimi” 1,079,834 mijë lekë, “Detyrim për kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore” 269,203 mijë lekë, “Detyrim tatim për të ardhura personale” 32,516 dhe “Detyrime të tjera” 4,658,946 mijë lekë. Peshën më të madhe të marrëveshjeve të lidhura sipas llojit të tatimit e zënë “Detyrime të Tjera” në masën 72% dhe rreth 17% e zënë marrëveshjet e lidhura për “Detyrim tatim fitimi”.

Tabela 19: Përmbledhëse e Akt-Marrëveshjeve për çdo DRT për vitin 2017

000/lekë

Nr.	DRT	Progresive Janar-Dhjetor 2017				
		Nr.Akt Marrëveshje të lidhura	Nr.Subjekteve të cilët lidhin A-M	Vlera totale e debisë për të cilën janë lidhur A-M	Paguar në lidhjen e A-M (vlera fillestare e paguar)	Nr.A-M të anuluar për mosrespektim
1	Fier	59	59	203,473	50,387	5
2	DRTM	27	27	950,780	254,913	4
3	Shkodër	20	20	46,607	14,539	9
4	Tiranë	253	253	4,738,656	1,936,972	155
5	Berat	27	27	37,477	9,116	14
6	Dibër	38	38	52,002	9,242	2
7	Durrës	57	57	129,921	58,950	4
8	Elbasan	27	27	60,600	11,684	35
9	Gjirokastrë	14	14	20,192	5,749	3
10	Korçë	47	47	31,887	8,795	0
11	Kukës	9	9	37,654	15,081	0
12	Lezhë	16	16	35,414	7,072	0
13	Sarandë	55	55	23,583	8,231	31
14	Vlorë	72	72	99,006	22,981	26
	<b>Shuma</b>	<b>721</b>	<b>721</b>	<b>6,467,251</b>	<b>2,413,712</b>	<b>288</b>

Burimi i të dhënave: Sektori i Marrëveshjeve në DPT.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga akt-marrëveshjet e lidhura për vitin 2017 janë arkëtuar si parakusht (20%) për lidhjen e tyre 2,413,712 mijë lekë. Nga 721 marrëveshje për pagesë me këste të lidhura me detyrim dhe në vlerë 6,467,251 mijë lekë janë anuluar 288 prej tyre, ose rreth 40% e marrëveshjeve të lidhura gjatë këtij viti.

- Për vitin 2017, Sektori i Marrëveshjeve nuk dispononte regjistër apo evidenca të tjera për evidentimin dhe monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve me këste sipas tatimpaguesve për çdo DRT, kështu që grupi i auditimit e pati të pamundur të bënte një analizë të këtij viti.
- Duke marr parasysh këto mangësi në administrimin, monitorimin, dhe zbatimin e detyrave sipas rregullores për këtë sektor konstatohet se: Për vitin 2017, Sektori i Marrëveshjeve pranë DMDTP (ish-DMF) nuk ka ndjekur procedurat e përcaktuara në nenin 113 të Rregullores së Funkcionimit të Administratës Tatimore Qendrore.

***Marrëveshje të lidhura në vitin 2018.***

**Në vitin 2018** janë lidhur 1179 marrëveshje me këste me vlerë totale 2,263,149 mijë lekë nga i cili “Detyrim për T.V.Sh” 379,500 mijë lekë, “Detyrim tatim fitimi” 1,238,433 mijë lekë, “Detyrim për kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore” 322,814 mijë lekë, “Detyrim tatim për të ardhura personale” 16,762 mijë dhe “Detyrime të Tjera” 305,641 mijë lekë. Peshën më të madhe në vlerë në totalin e marrëveshjeve për pagesë me këste të lidhura e zë “Detyrimi për tatim fitimi” në masën rreth 55%.

Krahasuar me vitin 2017 janë lidhur 458 marrëveshje më shumë në numër, me detyrim dhe në vlerë 4,4204,102 mijë lekë më pak, pasi këtë vit marrëveshjet për pagesë me këste për “Detyrime të Tjera” zënë rreth 14% të totalit nga 72% që zinin në vitin e mëparshëm.

Nga akt-marrëveshjet e lidhura për vitin 2018 janë arkëtuar si parakusht (20%) për lidhjen e tyre 929,275 mijë lekë dhe pagesa të kryera sipas kësteve 1,469,824 mijë lekë, për të cilat nuk mund të evidentohet sa janë arkëtuar nga akt-marrëveshjet e vitit të mëparshëm dhe sa janë arkëtuar nga akt-marrëveshjet e vitit 2018.

Tabela 20: Përmbledhëse e Akt-Marrëveshjeve për çdo DRT për vitin 2018.

000/lekë

Nr.	DRT	Nr.Akt Marrëveshje të lidhura	Nr.Subjekteve të cilët lidhin A-M	Vlera totale e debisë për të cilën janë lidhur A-M	Paguar në lidhjen e A-M (vlera fillestare e paguar)	Vlera e paguar gjatë vitit nga A-M	Nr.A-M të anuluar gjatë vitit për mosrespektim	Vlera e A –M të anuluar	Numri i A-M aktive në fund të vitit	Vlera e A-M aktive në fund të vitit.
1	Berat	41	41	12,994	4,369	9,549	14	5,429	27	5,687
2	Dibër	39	39	55,371	11,118	25,381	0	-	25	21,021
3	DRTM	31	31	619,845	167,566	604,516	4	154,623	52	62,867
4	Durrës	95	95	207,128	124,655	86,197	21	94,733	38	31,393
5	Elbasan	58	58	73,836	29,023	29,919	12	11,575	76	50,623
6	Fier	111	111	157,600	37,802	108,331	17	32,470	32	11,091
7	Gjirokastër	41	41	31,187	10,197	12,261	18	1,160	86	11,929
8	Korçë	136	136	51,511	12,606	46,551	16	6,393	10	6,877
9	Kukës	19	19	23,152	10,617	2,593	8	12,230	15	18,018
10	Lezhë	33	33	61,935	15,605	39,668	5	716	76	8,891
11	Sarandë	129	129	35,606	9,214	14,899	26	8,769	48	6,744
12	Shkodër	61	61	155,348	43,757	49,010	14	18,342	155	185,219
13	Tiranë	283	283	554,818	409,280	419,631	117	300,344	15	196,429
14	Vlorë	102	102	222,817	43,467	21,318	29	124,242	38	2,859
	<b>Shuma</b>	<b>1,179</b>	<b>1,179</b>	<b>2,263,149</b>	<b>929,275</b>	<b>1,469,824</b>	<b>301</b>	<b>771,026</b>	<b>693</b>	<b>619,646</b>

Burimi i të dhënave: Sektori i Marrëveshjeve në DPT.

Përpunoi: Grupi i auditimit

### ***Marrëveshje të anuluar në vitin 2018.***

Nga databaza e akt-marrëveshjeve të mbajtura për këtë vit rezulton se nga 1179 marrëveshje për pagesë me këste të lidhura me detyrim dhe në vlerë totale 2,263,149 mijë lekë janë zgjidhur/anuluar 301 marrëveshje për pagesë me këste (zgjidhur 29 marrëveshje me shumë se viti 2017) me detyrim dhe në vlerë 771,026 mijë lekë, dhe mbeten aktive në fund të vitit 693 akt-marrëveshje me detyrim dhe në vlerë 619,646 mijë lekë.

- Diferenca prej 185 janë akt-marrëveshje të lidhura dhe përfunduara gjatë vitit 2018 të cilat Sektori i Marrëveshjeve nuk i mbante më në regjistër, por i pastronte nga listat duke pasqyruar në fund të çdo muaji marrëveshjet aktive, duke mos bërë të mundur kështu ndjekjen dhe zbatimin e tyre në numër dhe vlerë përgjatë vitit.

### ***Marrëveshje të lidhura në vitin 2019.***

Në vitin 2019 janë lidhur 1022 marrëveshje me këste me detyrim dhe në vlerë totale 2,008,685 mijëlekë nga i cili “Detyrim për T.V.Sh” 310,910 mijë lekë, “Detyrim tatim fitimi” 1,239,611 mijë lekë, “Detyrim për kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore” 266,228 mijë lekë, “Detyrim tatim për të ardhura personale” 6,538 dhe “Detyrime të Tjera” 185,397 mijë lekë. Peshën më të madhe të marrëveshjeve të lidhura sipas llojit të tatimit e zënë “Detyrimet për tatim fitim” në masën rreth 62% ose 7% më shumë se viti 2018.

Krahasuar me vitin 2018 janë lidhur 157 marrëveshje më pak dhe në vlerë 254,464 mijë lekë më pak, ndërsa krahasuar me vitin 2017 janë lidhur 301 akt-marrëveshje më shumë dhe me detyrim në vlerë janë 4,458,386 mijë lekë më pak (si pasojë e numrit dhe vlerës së lartë së marrëveshjeve të lidhura për “Detyrime të Tjera” në vitin 2017).

-Nga akt-marrëveshjet e lidhura për vitin 2019 janë arkëtuar si parakusht (20%) për lidhjen e tyre 804,673 mijë lekë dhe pagesa të kryera sipas kësteve 1,169,776 mijë lekë, për të cilat nuk evidentohet se sa janë arkëtuar nga akt-marrëveshjet e vitit të mëparshëm dhe se sa janë arkëtuar nga akt-marrëveshjet e vitit 2019.

Tabela 21: Përmbledhëse e Akt-Marrëveshjeve për çdo DRT për vitin 2019.

000/lekë

DRT	Progresive Janar- Dhjetor 2019							Nr.Akt Marrëveshje aktive në fund të vitit	Vlera e A-M aktive në fund të vitit
	Nr.Akt Marrëveshje të lidhura	Nr.Subjekteve të cilët lidhin A-M	Vlera totale e debisë për të cilën janë lidhur A-M	Paguar në lidhjen e A-M (vlera fillestare e paguar)	Vlera e paguar gjatë vitit nga A-M	Nr.A-M të anuluar gjatë vitit për mosrespektim	Vlera e A-M të anuluar		
Berat	61	61	12,802	4,748	9,751	19	4,969	22	3,446
Dibër	37	37	129,049	25,030	21,330	17	98,563	17	55,922
Durrës	109	109	281,733	147,184	89,393	57	153,683	42	96,313
Elbasan	92	92	96,319	55,478	24,046	40	73,400	36	44,404
Fier	83	83	175,048	63,983	81,295	31	58,034	53	51,065
Gjirokastrë	13	13	19,200	5,321	10,408	25	17,716	10	3,456
Korçë	90	90	55,037	17,137	28,392	43	6,498	39	14,661
Kukës	15	15	29,256	11,195	10,711	10	19,986	7	5,730
Lezhë	33	33	55,493	15,104	27,446	5	11,275	18	13,514
Sarandë	65	65	17,694	7,789	16,781	18	1,875	19	6,589
Shkodër	63	63	72,141	23,431	56,190	19	35,420	54	18,139
Tiranë	284	284	584,076	289,456	472,670	88	130,780	152	516,603
DRTM	17	17	405,021	111,076	297,774	7	135,408	13	134,308
Vlorë	60	60	75,816	27,740	23,591	37	33,969	29	24,389
<b>Shuma</b>	<b>1,022</b>	<b>1,022</b>	<b>2,008,685</b>	<b>804,673</b>	<b>1,169,776</b>	<b>416</b>	<b>781,576</b>	<b>511</b>	<b>988,539</b>

Burimi itë dhënave: Sektori i Marrëveshjeve në DPT. Përpunoi: Grupi i auditimit

### ***Marrëveshje të anuluar***

Nga databaza e akt-marrëveshjeve të mbajtura për këtë vit rezulton se nga 1022 marrëveshje për pagesë me këste të lidhura me detyrim dhe në vlerë totale 2,008,685 mijë lekë janë zgjidhur/anuluar 416 marrëveshje për pagesë me këste (zgjidhur 115 marrëveshje më shumë me

detyrim 10,500 mijë lekë më shumë se viti 2018) dhe me detyrim në vlerë 781,576 mijë lekë dhe mbeten aktive në fund të vitit 511 akt-marrëveshje me detyrim në vlerë 988,539 mijë lekë.

-Diferenca prej 95 janë akt-marrëveshje të lidhura dhe përfunduara gjatë vitit 2019 të cilat Sektori i Marrëveshjeve nuk i mbante më në regjistër, por i pastronte nga listat duke pasqyruar në fund të çdo muaji marrëveshjet aktive, duke mos bërë të mundur kështu ndjekjen dhe zbatimin e tyre në numër dhe vlerë përgjatë vitit.

### ***Akt-marrëveshje të lidhura në mënyrë të përsëritur dhe akt-marrëveshje të anuluar me 0 këste të paguara***

Referuar :

-Udhëzuesit të përgjithshëm të procedurave të mbledhjes me forcë datë 15.03.2018 “pika 10“Drejtoritë rajonale tatimore mund të lejojnë tatimpaguesit në çdo kohë dhe sa herë që është e nevojshme të lidhë marrëveshje të pagesës me këste, por, në të njëjtën kohë ai duhet të vërtetojë pamundësinë aktuale financiare, si dhe të tregojë që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes”. Për të gjykuar në lidhje me pamundësinë financiare mund të shërbejnë pasqyrat financiare të shoqërisë, gjendja e detyrimeve, kapitaleve të shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditetet etj;

-Udhëzimit nr. 7, datë 10.1.2017 Për disa shtesa në Udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar pika 34 sipas së cilës:“Në kërkesë duhet të paraqiten argumentet për pamundësinë aktuale financiare, si dhe argumentet mbi aftësinë paguese të tatimpaguesit në të ardhmen.”

-Udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pika 78 “Zgjidhja e Marrëveshjes së pagesës me këste” :“Marrëveshja e pagesës me këste mund të zgjidhet nga administrata tatimore, në momentin më të parë që personi i tatueshëm nuk e respekton atë lidhur me rregullshmërinë e pagesave si dhe kur ai nuk paguan detyrimet e tjera tatimore, që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja. Në këtë rast, personi i tatueshëm është i detyruar të paguajë të gjitha detyrimet tatimore të papaguara, që mbulohen nga kjo marrëveshje, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit të zgjidhjes së marrëveshjes. Nëse këto detyrime nuk paguhen, administrata tatimore mbledh detyrimet në përputhje me dispozitat e Kreut XI të Ligjit”.

-Neni 18 të Rregullores së funksionimit të DRT për lidhjen e akt- marrëveshjes pika 2:“struktura përgjegjëse në DRT pasi merr në dorëzim kërkesat për marrëveshje i analizon ato duke përcaktuar riskun përkatës”, dhe pika 3:“nëse plotëson kushtet pas analizës harton draft marrëveshjen përkatëse për pagesën me këste duke analizuar për të parë situatën nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore.”

### **Për vitin 2018, 2019:**

Nga të dhënat e shqyrtuara nga databaza e akt-marrëveshjeve të lidhura, dhe atyre të anuluar për vitin 2018 dhe 2019 janë evidentuar:

- Raste ku për të njëjtin tatimpagues në mënyrë të përsëritur, në periudha të shkurtra kohore, janë lidhur nga ana e strukturave përgjegjëse të drejtorive rajonale tatimore akt-marrëveshje për pagesë me këste, edhe pse nuk kanë paguar detyrimin tatimor sipas kushteve të marrëveshjes së lidhur.
- Disa tatimpagues pas pagesës së menjëhershme së para kushtit (20% të vlerës së detyrimit për të cilën lidhet marrëveshja), kanë lidhur akt-marrëveshje për pagesë me këste dhe rezultojnë me 0 këste të paguara pas lidhjes së saj duke mos zbatuar kështu kushtet nga lidhja e akt-marrëveshjeve për pagesë me këste dhe duke mos arkëtuar vlerën e detyrimeve për të cilën ajo lidhet.

Tabela 22: Akt - marrëveshjeve të lidhur në mënyrë të përsëritur për të njëjtin tatimpagues, sipas DRT-ve, për vitin 2018.

Në/lekë

Nr	Subjekte	Nipt	Detyrimi total për të cilën u lidhur A-M	Data lidhjes A-M	Data përfund A-M	Data e anulimit të A-M	Arsyeja e anulimit të A-M	Vlera e mbetur pa paguar, lekë	DRT
1	E	.....	283,889	13.04.2018	20.12.2018	24.05.2018	Nuk pagoi kestin	283,889	Berat
2	E	.....	296,995	09.08.2018	30.03.2019	28.09.2018	Nuk pagoi detyrimet	254,567	Berat
3	G	.....	1,365,708	19.12.2017	19.12.2018	12.04.2018	Krijoi detyrime të reja	722,137	Berat
4	G	.....	632,529	22.05.2018	21.12.2018	06.09.2018	Nuk pagoi detyrime+kest	447,523	Berat
5	H	.....	3,240,599	08.06.2017	28.06.2018	30.01.2018	Mospagim kesti	2,970,549	Durrës
6	H	.....	2,926,957	27.03.2018	28.01.2019	06.12.2018	Mosrespektim	1,170,787	Durrës
7	X	.....	371,054	Nuk ka regjister të vitit të kaluar	23.01.2018	23.01.2018	Mosrespektim	371,049	Tiranë
8	X	.....	552,657	06.08.2018	25.05.2019	30.10.2018	Mosrespektim	1,310,296	Tiranë
9	E	.....	925,400	17.11.2017	17.05.2018	05.02.2018	Mosrespektim	629,901	Tiranë
10	E	.....	532,620	15.05.2018	20.05.2019	05.07.2018	Mosrespektim	784,562	Tiranë
11	E	.....	1,004,363	08.01.2018	10.07.2018	15.03.2018	Mosrespektim	3,063,766	Tiranë
12	E	.....	1,202,322	11.05.2018	25.03.2019	24.07.2018	Mosrespektim	34,638,198	Tiranë
13	A	.....	705,266	09.02.2018	05.02.2019	15.03.2018	Mosrespektim	1,804,093	Tiranë
14	A	.....	1,078,408	13.04.2019	10.07.2020	23.10.2018	Mosrespektim	1,529,015	Tiranë
15	M	.....	12,860,403	18.09.2017	30.12.2018	15.03.2018	Mosrespektim	22,064,000	Tiranë
16	M	.....	28,770,651	15.05.2018	10.05.2019	28.08.2018	Mosrespektim	31,246,908	Tiranë
17	F	.....	392,933	16.02.2018	20.08.2018	18.04.2018	Mosrespektim	854,413	Tiranë
18	F	.....	340,984	25.06.2018	25.12.2018	30.10.2018	Mosrespektim	931,703	Tiranë
19	M	.....	690,925	13.03.2018	24.03.2018	18.04.2018	Mosrespektim	2,103,566	Tiranë
20	M	.....	1,262,424	20.06.2019	10.04.2019	01.11.2018	Mosrespektim	802,886	Tiranë
21	H	.....	10,717,992	20.03.2018	24.03.2019	18.04.2018	Mosrespektim	20,185,712	Tiranë
22	H	.....	6,755,253	18.06.2018	20.06.2019	05.07.2018	Mosrespektim	7,979,259	Tiranë
23	I.	.....	459,742	30.03.2018	30.09.2018	02.05.2018	Mosrespektim	1,981,270	Tiranë
24	I	.....	403,061	19.06.2018	10.12.2018	18.09.2018	Mosrespektim	1,131,738	Tiranë

Burim i të dhënave: Databasa nga Sektori i Marrëveshjeve në DPT

Përpunoi: Grupi i auditimit

Tabela 23: Akt - marrëveshjeve të lidhur në mënyrë të përsëritur për të njëjtin tatimpagues, sipas DRT-ve, për vitin 2019.

Në/lekë

Nr	Subjekte	Nipti	Detyrimi total për të cilën u lidhur A-M	Data lidhjes A-M	Data përfundimi A-M	Data e anulimit të A-M	Arsyeja e anulimit të A-M	Vlera e mbetur pa paguar, lekë	DRT
1	A	.....	101,200	28.03.2019	20.05.2019	03.05.2019	nuk pagoi kestin	101,200	Berat

2	A	.....	407,465	30.09.2019	25.03.2020	01.11.2019	Nuk pagoi kestin	407,465	Berat
3	H	.....	2,847,414	04.02.2019	28.12.2020	20.03.2019	Mosrespektim i A-M	2,810,283	Durrës
4	H	.....	7,792,901	30.05.2019	28.12.2020	03.09.2019	Mosrespektim i A-M	6,972,595	Durrës
5	I	.....	4,807,594	12.04.2018	28.12.2019	26.03.2019	Mosrespektim i A-M	1,684,670	Durrës
6	I	.....	6,606,555	24.04.2019	24.12.2020	26.05.2019	Nuk pagoi kestin	6,606,555	Durrës
7	B	.....	7,255,826	28.09.2018	20.12.2019	04.04.2019	Mosrespektim i A-M	5,090,879	Durrës
8	B	.....	8,021,700	20.05.2019	24.12.2019	22.07.2019	Mosrespektim i A-M	8,021,700	Durrës
9	K	.....	21,204,933	18.05.2018	20.11.2019	19.03.2019	Detyrim I ri	36,593,564	Elbasan
10	K	.....	12,301,118	28.03.2019	28.12.2020	22.08.2019	Mosrespektim i A-M	11,129,582	Elbasan
11	K	.....	2,217,477	19.07.2018	20.05.2019	19.03.2019	detyrim I ri	2,217,477	Elbasan
12	K	.....	5,258,373	01.07.2019	24.12.2020	09.10.2019	Mosrespektim i A-M	4,381,980	Elbasan
13	XH	.....	6,793,877	17.04.2018	28.12.2018	04.01.2019	nuk pagon detyrim ri	4,755,719	DRTM
14	XH	.....	5,016,749	30.04.2019	27.04.2020	12.06.2019	nuk pagon detyrim ri	5,016,749	DRTM
15	A	.....	685,435	Nuk gjendet e regji 2018		12.02.2019	mosrespektim	571,196	Tiranë
16	A	.....	1,170,008	08.04.2019	25.12.2020	16.09.2019	mosrespektim	2,590,439	Tiranë
17	I	.....	1,099,463	20.11.2018	26.05.2019	07.02.2019	mosrespektim	921,093	Tiranë
18	I	.....	832,164	21.05.2019	15.12.2019	18.07.2019	mos respektim	118,880	Tiranë

Burim i të dhënave: Databaza nga Sektori i Marrëveshjeve në DPT.

Përpunoi: Grupi i auditimit.

Tabela 24: Akt-Marrëveshjet e anuluar, për të cilat janë paguar 0 këste, sipas DRT-ve, në vitin 2018.

Në/lekë

Nr.	Subjektet	Nipti	Detyrimi total për të cilën lidhet A-M	Paguar në fillim të A-M	Data e lidhjes së A-M	Data e anulimit të A-M	Arsyeja e anulimit të A-M	Nr.total këste	Këste të paguar	Vlera e mbetur pa paguar	DRT
1	E	.....	283,889	379,794	13.04.2018	24.05.2018	Mos pagesë	8	-	283,889	Berat
2	B	.....	1,668,123	829,081	nuk rezulton në rregji e vitit 2018 nga viti 2017	12.03.2018	Mos pagesë	6	-	1,688,123	Durrës
3	B	.....	697,010	119,650	17.07.2018	27.09.2018	Mos pagesë	5	-	697,010	Durrës
4	K	.....	1,290,000	334,694	27.08.2018	09.11.2018	Mos pagesë	16	-	1,290,000	Durrës
5	I	.....	291,068	61,720	10.7.2018	01.09.2018	Mos pagesë	4	-	232,000	Elbasan
6	M	.....	1,870,717	514,053	25.04.2018	27.06.2018	Mos pagesë	6	-	1,356,666	Fier
7	T	.....	610,142	161,000	15.10.2018	12.11.2018	Mos pagesë	5	-	449,142	Fier
8	L	.....	150,000	30,000	21.6.2018	20.11.2018	Mos pagesë	12	-	147,000	Korcë
9	G	.....	100,000	20,000	23.10.2018	24.12.2018	Mos pagesë	10	-	80,000	Korcë
10	I	.....	753,148	268,200	27.4.2018	24.07.2018	Mos pagesë	20	-	484,948	Kukës
11	C	.....	1,490,292	1,580,572	24.05.2018	22.10.2018	Mos pagesë	12	-	1,490,292	Kukës

12	H	.....	960,402	257,486	29.08.2018	22.10.2018	Mos pagesë	6	-	960,402	Kukës
13	O	.....	948,500	795,355	02.10.2018	02.12.2018	Mos pagesë	14	-	948,500	Kukës
14	E	.....	92,408	23,000	28.02.2018	04.05.2018	Mos pagesë	22	-	92,408	Sarandë
15	S	.....	100,000	30,000	27.06.2018	28.08.2018	Mos pagesë	10	-	100,000	Sarandë
16	A	.....	40,000	10,000	25.10.2018	06.12.2018	Mos pagesë	13	-	40,000	Sarandë
17	A	.....	58,205	16,276	23.10.2018	06.12.2018	Mos pagesë	5	-	58,205	Sarandë
18	V	.....	48,000	12,000	nuk rezulton në rregj e vitit 2018	07.12.2018.	Mos pagesë, shtim det	6	-	48,000	Sarandë
19	S	.....	1,722,208	800,389	nuk rezulton në rregj e vitit 2018n	23.01.2018	Mosrespektim	10	-	15,035,173	Tiranë
20	T	.....	800,682	322,851	nuk rezulton në rregj e vitit 2018	05.02.2018	Mosrespektim	8	-	477,777	Tiranë
21	E	.....	275,210	50,000	nuk rezulton në rregj e vitit 2018	15.03.2018	Mosrespektim	4	-	275,210	Tiranë
22	O	.....	340,569	50,000	05.01.2018	15.03.2018	Mosrespektim	6	-	340,569	Tiranë
23	E	.....	1,004,363	2,561,837	08.01.2018	15.03.2018	Mosrespektim	6	-	1,004,363	Tiranë
24	F	.....	392,933	402,437	16.02.2018	18.04.2018	Mosrespektim	6	-	392,933	Tiranë
25	M	.....	690,925	2,200,000	13.03.2018	18.04.2018	Mosrespektim	12	-	690,925	Tiranë
26	H	.....	10,717,992	1,436,834	20.03.2018	18.04.2018	Mosrespektim	12	-	10,717,992	Tiranë
27	A	.....	511,698	130,000	13.06.2018	05.07.2018	Mosrespektim	6	-	511,698	Tiranë
28	H	.....	6,755,253	1,306,985	18.06.2018	05.07.2018	Mosrespektim	12	-	6,755,253	Tiranë
29	E	.....	532,620	352,045	15.05.2018	05.07.2018	Mosrespektim	12	-	532,620	Tiranë
30	T	.....	83,937	344,518	07.06.2018	30.08.2018	Mosrespektim	4	-	249,757	Tiranë
31	I	.....	665,016	166,500	24.05.2018	30.08.2018	Mosrespektim	10	-	665,016	Tiranë
32	D	.....	3,794,673	950,000	19.06.2018	27.08.2018	Mosrespektim	6	-	4,231,803	Tiranë
33	M	.....	345,566	500,884	14.06.2018	19.09.2018	Mosrespektim	10	-	414,629	Tiranë
34	E	.....	265,424	63,264	29.03.2018	27.09.2018	Mosrespektim	8	-	273,041	Tiranë
35	G	.....	480,182	754,998	28.06.2018	27.09.2018	Mosrespektim	10	-	750,385	Tiranë
36	J	.....	841,382	530,811	05.07.2018	27.09.2018	Mosrespektim	12	-	1,075,476	Tiranë
37	N	.....	233,124	247,231	02.08.2018	06.09.2018	Mosrespektim	3	-	389,273	Tiranë
38	S	.....	877,579	703,803	27.07.2018	11.09.2018	Mosrespektim	12	-	912,600	Tiranë
39	M	.....	2,275,406	718,369	10.08.2018	18.09.2018	Mosrespektim	17	-	3,673,286	Tiranë
40	D	.....	1,528,633	2,020,000	16.08.2018	23.10.2018	Mosrespektim	16	-	2,668,609	Tiranë
41	h	.....	11,113,901	2,200,000	nuk rezulton në rregj e vitit 2018	30.03.2018	Nuk pagoi këstet	10	-	8,022,510	Vlorë
42	F	.....	85,719,151	-	30.03.2018	02.07.2018	Nuk pagoi këstet	7	-	92,147,458	Vlorë
43	K	.....	809,049	171,769	08.02.2018	30.03.2018	Nuk pagoi këstet	10	-	556,376	Vlorë
44	S	.....	4,087,660	815,800	19.03.2018	18.04.2018	Nuk pagoi këstet	12	-	3,271,860	Vlorë

			146,826,748	23,663,634					166,483,177	
--	--	--	-------------	------------	--	--	--	--	-------------	--

Burim i të dhënave: Databasa nga Sektori i Marrëveshjeve në DPT.  
Përpunoi: Grupi i auditimit.

Tabela 25: Akt-Marrëveshjeve e anuuala, për të cilat janë paguar 0 këste, sipas DRT-ve, në vitin 2019.

Në/lekë

Nr	Subjekte	Nipti	Detyrimi total për të cilën lidhet A-M	Paguar në fillim të A-M	Data e lidhjes së A-M	Data e anulimit të A-M	Arsyeja e anulimit të A-M	Nr.total i kesteve	Këste të paguara	Vlera e mbetur pa paguar	DRT
1	P	.....	587,101	146,775	14.11.2018	01.02.2019	Nuk pagoi kestin	13	-	587,101	Berat
2	A	.....	802,259	388,311	24.01.2019	15.03.2019	nuk pagoi kestin	11	-	802,259	Berat
3	R	.....	642,080	163,156	22.02.2019	29.03.2019	nuk pagoi kestin	5	-	642,080	Berat
4	M	.....	256,000	64,000	06.03.2019	03.05.2019	nuk pagoi kestin	8	-	256,000	Berat
5	A	.....	407,465	67,910	30.09.2019	01.11.2019	Nuk pagoi kestin	6	-	407,465	Berat
6	R	.....	1,576,172	400,000	29.03.2019	29.04.2019	Nuk pagoi kestin	12	-	1,576,172	Dibër
7	M	.....	11,460,565	1,000,000	31.05.2019	31.06.2019	Nuk pagoi kestin	19	-	10,460,565	Dibër
8	K	.....	18,532,909	6,109,000	15.03.2019	04.09.2019	Nuk pagoi kestin	12	-	18,532,909	Dibër
9	K	.....	3,542,771	850,000	31.05.2019	31.10.2019	Nuk pagoi kestin	17	-	3,542,771	Dibër
10	E	.....	271,957	43,524	17.07.2019	26.11.2019	Nuk pagoi kestin	10	-	228,433	Dibër
11	S	.....	6,947,280	12,364,037	04.09.2018	04.01.2019	Nuk pagoi kestin	16	-	6,947,280	Durrës
12	B	.....	387,523	571,655	17.09.2018	21.01.2019	Nuk pagoi kestin	6	-	387,523	Durrës
13	C	.....	533,417	285,360	13.11.2018	04.01.2019	Nuk pagoi kestin	4	-	533,417	Durrës
14	V	.....	2,828,288	732,659	25.10.2018	03.01.2019	Nuk pagoi kestin	5	-	2,828,288	Durrës
15	A	.....	3,498,888	2,464,939	30.01.2019	19.03.2019	Mosrespektim	12	-	3,498,888	Durrës
16	R	.....	578,408	116,000	08.03.2019	19.04.2019	Mosrespektim	4	-	578,408	Durrës
17	M	.....	1,752,730	695,320	12.04.2019	28.05.2019	Mosrespektim	5	-	1,752,730	Durrës
18	E	.....	941,772	402,265	08.03.2019	03.07.2019	Mosrespektim	9	-	941,772	Durrës
19	B	.....	8,021,700	2,174,484	20.05.2019	22.07.2019	Mosrespektim	7	-	8,021,700	Durrës
20	C	.....	715,279	180,000	08.07.2019	01.08.2019	Mosrespektim	6	-	715,279	Durrës
21	C	.....	1,084,550	380,346	17.05.2019	07.08.2019	Mosrespektim	7	-	1,084,550	Durrës
22	B	.....	5,427,423	1,974,192	19.06.2019	24.09.2019	Mosrespektim	12	-	5,427,423	Durrës
23	A	.....	560,834	344,555	12.09.2019	06.11.2019	Mosrespektim	6	-	560,834	Durrës
24	D	.....	670,085	203,647	12.09.2019	06.11.2019	Mosrespektim	6	-	670,085	Durrës
25	S	.....	370,194	245,360	02.10.2019	06.11.2019	Mosrespektim	6	-	370,194	Durrës
26	E	.....	2,692,072	679,462	02.09.2019	06.11.2019	Mosrespektim	11	-	2,692,072	Durrës
27	A	.....	207,375	41,500	27.11.2018	21.01.2019	Mosrespektim	4	-	246,208	Elbasan
28	K	.....	2,265,566	598,816	22.11.2018	26.03.2019	Mosrespektim	13	-	1,733,035	Elbasan
29	SH	.....	330,000	66,000	12.09.2018	20.05.2019	Mosrespektim	15	-	264,000	Elbasan

30	Q	.....	843,789	157,700	23.10.2019	28.10.2019	Nuk u firmos marrev nga tp.	2	-	843,789	Elbasan
31	XH	.....	133,080	30,000	27.02.2019	19.08.2019	Nuk pagoi kestin	10	-	133,080	Korcë
32	J	.....	200,998	50,000	26.06.2019	19.08.2019	Nuk pagoi kestin	6	-	150,998	Korcë
33	T	.....	4,491,098	2,000,000	26.08.2019	19.09.2019	Nuk pagoi kestin	1	-	2,491,098	Korcë
34	B	.....	6,046,558	2,000,000	23.01.2019	25.03.2019	Mosrespektim	23	-	6,046,558	Kukës
35	A	.....	2,184,077	550,000	07.02.2019	23.04.2019	Mos respektim afati	22	-	2,184,077	Kukës
36	B	.....	1,616,819	468,756	18.07.2019	27.12.2019	Mos respektim afati	17	-	1,616,819	Kukës
37	F	.....	827,940	2,388,131	19.08.2019	27.12.2019	Mos respektim afati	16	-	827,940	Kukës
38	E	.....	144,061	36,015	21.05.2019	22.07.2019	Nuk pagoi kestin	15	-	144,061	Sarandë
39	G	.....	440,134	149,203	18.06.2019	13.08.2019	Nuk pagoi kestin	14	-	440,134	Sarandë
40	A	.....	1,049,687	451,334	16.11.2018	07.02.2019	Mosrespektim	10	-	1,083,382	Tiranë
41	I	.....	429,767	1,099,463	20.11.2018	07.02.2019	Mosrespektim	6	-	921,093	Tiranë
42	G	.....	417,706	1,416,107	29.01.2019	10.05.2019	Mosrespektim	15	-	620,555	Tiranë
43	X	.....	439,823	1,139,144	28.03.2019	30.04.2019	Mosrespektim	6	-	439,823	Tiranë
44	D	.....	912,743	357,305	06.06.2019	16.09.2019	Mosrespektim	6	-	1,425,095	Tiranë
45	i	.....	522,274	142,742	24.06.2019	16.09.2019	Mosrespektim	6	-	522,274	Tiranë
46	B.	.....	867,942	2,172,117	04.07.2019	16.09.2019	Mosrespektim	6	-	1,133,442	Tiranë
47	B	.....	1,217,111	1,731,812	23.05.2019	20.09.2019	Mosrespektim	6	-	3,388,392	Tiranë
48	H	.....	536,772	135,000	16.09.2019	21.11.2019	Mosrespektim	6	-	612,543	Tiranë
49	H	.....	874,883	332,584	16.09.2019	21.11.2019	Mosrespektim	6	-	1,143,185	Tiranë
50	B	.....	23,021,569	5,825,758	24.10.2018	12.02.2019	Nuk pagoi kestin	14	-	23,021,569	DRTM
51	XH	.....	5,016,749	1,721,052	30.04.2019	12.06.2019	Nuk pagoi kestin	12	-	5,016,749	DRTM
			<b>124,081,685</b>	<b>56,107,496</b>						<b>130,496,097</b>	

Burim i të dhënave: Databasa nga Sektori i Marrëveshjeve në DPT  
Përpunoi: Grupi i auditimit

Rastet e evidentuara në tabelat e mësipërme tregojnë se tatimpaguesit debitorë nuk kanë respektuar kushtet e marrëveshjeve të lidhura dhe nuk kanë paguar detyrimet që kanë lindur gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja. Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara ata janë të detyruar të paguajnë të gjitha detyrimet tatimore të papaguara, që mbulohen nga kjo marrëveshje, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit të zgjidhjes së marrëveshjes dhe nëse këto detyrime nuk paguhen, administrata tatimore mbledh detyrimet në përputhje me dispozitat e Kreut XI të Ligjit 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

-Arsyetimi që jepet nga ana e institucionit është se duke lidhur akt-marrëveshje kanë një mundësi për mbledhje detyrimesh të papaguara, pasi arkëtonin në mënyrë të menjëhershme 20% të vlerës së detyrimit për të cilën lidhet marrëveshje për pagesë me këste.

**Gjetje:**

- Për vitin 2017, Sektori i Marrëveshjeve nuk dispononte regjistër apo evidenca për evidentimin dhe monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve me këste sipas tatimpaguesve për çdo DRT.
- Për vitin 2018 në 24 raste dhe për vitin 2019 në 18 raste nga ana e strukturave përgjegjëse në drejtoritë rajonale për të njëjtin tatimpagues në mënyrë të përsëritur dhe në periudha të shkurtra kohore janë lidhur akt-marrëveshje për pagesë me këste, edhe pse nuk kanë paguar detyrimin tatimor sipas kushteve të marrëveshjes duke mos respektuar dispozitat ligjore të sipërcituara dhe duke humbur kështu vlerën e akt-marrëveshjes si një akt administrativ i nënshkruar midis Drejtorit të DRT-së dhe tatimpaguesit.
- Në vitin 2018 për 44 tatimpagues janë lidhur akt-marrëveshje për pagesë me këste me detyrim në vlerë 146,827 mijë lekë, arkëtuar si para kusht (20%) 23,664 mijë lekë me 0 këste të paguara dhe rezultojnë me vlerë të mbetur të papagur 166,483 mijë lekë.
- Në vitin 2019 për 51 tatimpaguesit janë lidhur akt-marrëveshje për pagesë me këste me detyrim në vlerë 124,082 mijë lekë, arkëtuar si para kusht (20%) 56,107 mijë lekë, me 0 këste të paguara dhe rezultojnë me vlerë të mbetur të papagur 130,496 mijë lekë.
- Nga analiza e marrëveshjeve të lidhura nuk rezultoi asnjë rast për të cilën të ishte siguruar marrëveshje me këste të detyrimit tatimor të papaguar sipas nenit 77 pika 5 e ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar ku përcaktohet se *Drejtoria Rajonale Tatimore ka të drejtën të kërkojë garanci për përmbushjen e marrëveshjes së lidhura.*
- Në rastet e paraqitura për marrëveshjet e anuluar dhe me 0 këste paguar, në të dy vitet 2018, 2019 vihet re se ka mosrespektim të afateve kohore të anulimit të tyre.
- Në tabelën e rasteve të marrëveshjeve të lidhura, për të cilat janë paguar 0 këste, sipas DRT-ve, në vitin 2018 për tatimpaguesin “F” me Nipt ...me detyrim total për të cilën lidhet marrëveshja 85,719,151 lekë nuk rezulton pagesë për 20% të totalit të detyrimit si parakusht për lidhjen e marrëveshjes për pagesë me këste.
- Raportet të performancës nga DMDTP-ja në DPT nuk përmbanin analiza apo problematika të shfaqura në lidhje me marrëveshjet me këste për të cilat është e drejtë e DRT-ve, por ishin thjesht të dhëna statistikore mbi treguesit e kësaj drejtorie. Ky sektor, nuk ka zbatuar procedurat e përcaktuara në nenin 113 të Rregullores së Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore, pika 5,7 dhe 8.

### **Konkluzione:**

- *Si rezultat se nuk ekziston një databazë analitike për lidhjen e akt-marrëveshjeve për vitin 2017, grupi i auditimit nuk mundi të analizonte ecurinë e tyre në nivel tatimpaguesi, për këtë vit.*
- *Për rastet e evidentuara në këtë raport, mbi akt-marrëveshjet e lidhura dhe të zgjidhura brenda një periudhe të shkurtër kohore për të njëjtin tatimpagues, si dhe për rastet e akt-marrëveshjeve të lidhura dhe të zgjidhura me 0 këste të paguara, nga ana e strukturave përgjegjëse në DRT nuk është kryer ose nuk ka qenë efektive analiza për të vlerësuar riskun lidhur me përmbushjen e kushteve të akt-marrëveshjeve, si dhe nuk është analizuar në mënyrë efektive situata nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore, duke mosrespektuar pikën 2 dhe 3 të Nenit 18 të Rregullores së funksionimit të DRT-ve.*
- *Sa më sipër ka ndikuar në moszgjedhjen e masave më të përshtatshme të mbledhjes, me qëllim arkëtimin e të gjithë detyrimit tatimor për të cilën lidhet akt-marrëveshje për pagesë me këste.*

## Rekomandim

14. DPT të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar një monitorim sa me efikas të marrëveshjeve të lidhura për pagesë me këste me tatimpaguesin debitorë nga strukturat përgjegjëse në drejtoritë rajonale tatimore, duhet të kërkojë nga DRT-të (strukturat përkatëse) hartimin e raporteve periodike mbi ecurinë dhe problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të akt-marrëveshjeve me qëllim evidentimin dhe zgjidhjen në kohë të tyre.

*Shkurt 2021 dhe në vazhdimësi.*

Në përgjigje të observacionit të dërguar nga DPT, me shkresën nr. 434/3 prot., datë 13.11.2020 me objekt “*Observacion për projekt-raportin e auditimit të performancës Ecuria e borxhit tatimor*”, sqarojmë si më poshtë vijon:

- **Pretendimi i subjektit:** Rekomandimi i mësipërm nuk pranohet. Në zbatim të ligjit nr. 83/2019 “*Për disa ndryshime në ligjin nr. 19.05.2008 Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, si dhe në zbatim të Urdhrit nr.33, datë 12.02.2020, të Kryeministrit “*Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore*”, si dhe në zbatim të urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, e drejta për të lidhur marrëveshjen e pagesës me këste është e Drejtorive Rajonale Tatimore dhe strukturave në varësi të kësaj Drejtori. Për zbatimin e kësaj procedure është ngarkuar Drejtoria e Kontrollit Tatimor.
- **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**
  - Në kushtet kur, pas periudhës nën auditim struktura përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të Akt-marrëveshjeve me këste ka ndryshuar, rekomandimi i mësipërm do të jetë: “DPT të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar një monitorim...”. Observacioni pranohet.

### 3.2.2 A është përmirësuar mbledhja e borxhit tatimor gjatë periudhës nën auditim?

Mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara është funksion i rëndësishëm i punës së ATQ, që mbështetet nga legjislacioni tatimor dhe ndikon në realizimin e të ardhurave. Në zbatim të nenit 68 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, dy janë aktet administrative tatimore të cilat prodhojnë detyrime tatimore dhe mospagimi në afat i tyre ose pas ezaurimit të shkallëve të ankimit, inicion ndërmarrjen e masave shtrënguese për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor.

Mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara në afat është drejtimi më i vështirë i punës së organeve tatimore. Peshën më të madhe në krijimin e detyrimeve të papaguara për periudhën objekt auditimi 2017-2019, e zënë detyrimet e akumuluar nga njoftim-vlerësimet e kontrolleve tatimore, vlerësimeve të bëra për tatimpaguesit, verifikimet në terren, gjobat dhe interesat e sistemit informatik, si dhe nga pamundësia në përmbushjen e detyrimit tatimor për shkak të situatës financiare e pasurore të tatimpaguesit.

Objektivat dhe masat për zbatimin e misionit të Administratës Tatimore Qendrore, mbështeten në bindjen se përmbushja vullnetare mundësohet vetëm atëherë kur të gjitha funksionet për shërbimin ndaj klientit, kontrollit tatimor dhe mbledhjes së detyrimeve të prapambetura do të trajtohen si një tërësi veprimesh të ndërvarura dhe të mbështetura në modelin e menaxhimit të riskut.

#### ***Drejtimet kryesore të auditimit;***

- Koncepti i borxhit
- Trendi i borxhit
- Indikatorët e OECD

- Vlerësimet e Bankës Botërore dhe rekomandimet e FMN
- Kostoja e mbledhjes së borxhit.

➤ **Koncepti i Borxhi Tatimor**

Administrata Tatimore si në dokumentet rregullative të veprimtarisë së saj, referuar dhe Strategjisë 2017 -2021 të DPT, si dhe në raportet e publikuara të përvitshme të veprimtarisë së DPT, dhe në faqen e Web-it të DPT përdoret termi “Borxh tatimor”.

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008” Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar , kreu XI , nenet 88-104, Administratat Tatimore ( struktura përkatëse), ka detyrimin ligjor nëpërmjet ushtrimit të kompetencës të mbledhë detyrimet tatimore të papaguara brenda afateve ligjore sipas burimeve të krijimit. Sipas ligjit të cituar më lartë - *konsiderohet borxh tatimor*:

- Detyrimi tatimor i vetëdeklaruar nga tatimpaguesit dhe i papaguar brenda afatit ligjor.
- Detyrimi tatimor i vlerësuar nga administrata tatimore në përfundim të një kontrolli tatimor, verifikimi apo çdo procedure tjetër ligjore, i papaguar brenda afatit ligjor.

Praktikisht ndeshemi me dy lloje të borxhit tatimor:

- a) borxh tatimor i pranuar dhe b) borxh tatimor i kundërshtuar.

Kështu vlerave të borxhit tatimor të pranuar dhe të kundërshtuar mund t’i referohemi si borxh tatimor “neto” dhe borxh tatimor “bruto”, nga ku borxhi tatimor neto është borxhi tatimor bruto ku zbritet borxhi i kundërshtuar.

Borxhi tatimor i pranuar përkufizohet si “...*shuma totale e detyrimeve tatimore (ku përfshihen interesa dhe penalitete) për t’u paguar në fund të vitit dhe që nuk janë kundërshtuar nga tatim paguesit...*”(OECD – 2013).

Borxhi tatimor i pranuar, është një tregues kyç i performancës së mbledhjes së borxhit tatimor, indikator i cili përdoret nga OECD që në v. 2009.

Prandaj në DPT mjaft peshë zenë edhe korigjimet e situatave tatimore detyrimeve të papaguara tatimore, që janë zbatime të vendimeve gjyqësore të fituara nga subjektet për këto detyrime, mbulime të detyrimeve të papaguara me tepricat kreditore të tatimpaguesve, gjoba të vendosura padrejtësisht në sistem, etj.

Kjo është e lidhur ngushtë me klasifikimin që bëhet nga ana e organeve tatimore i borxhit tatimor si “*i mbledhshëm dhe të pambledhshëm*”:

Borxhi tatimor “*i mbledhshëm*” përkufizohet si shuma e përgjithshme e detyrimit tatimor, duke përfshirë interesat dhe gjobat, të cilit i ka kaluar afati i pagesës dhe që nuk paraqet pengesë për arkëtimin. Si rrjedhojë borxhi i mbledhshëm tatimor në përgjithësi përjashton: (a) shumat e kontestuara zyrtarisht nga tatimpaguesi dhe për të cilat veprimi i mbledhjes është pezulluar në pritje të rezultatit, (b) shumat që nuk janë ligjërish të rikuperueshme (p.sh. borxhi që ka kaluar në faliment) dhe (c) borxhi që është i pamundur të arkëtohet (p.sh., debitori nuk ka fonde dhe as asetë).”

Dihet se sa më i vjetër është borxhi tatimor, aq më e vështirë është mbledhja e tij dhe bazuar në rrethanat, gjeneron më pak para.

Ligji nr. 9920, datë 19.08.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcakton detyrimin tatimor: “*Detyrimi tatimor lind kur personi realizon te ardhura, kryen pagesa apo behet pronar i një pasurie, te cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit tatimor*” ndërsa borxhi tatimor përfshin tatimin/kontributin/taksën, kamatëvonesën dhe çdo dënim administrativ të lidhur ose jo me një lloj tatimi/takse/ kontributi, , i ndryshuar, ose ligjeve të tjera tatimore.

Bazuar në nenin 68 të ligjit 9920, datë 19.08.2008, i ndryshuar administrata tatimore ka autoritetin për të mbledhur me forcë detyrimet tatimore të papaguara, kur konstaton se tatimpaguesi nuk ka paguar në afat detyrimet e tij tatimore (pas ezaurimit të shkallëve të ankimit), gjë që nënkupton marrjen e masës shtrënguese më efektive për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor, me koston më të ulët si për administratën edhe për tatimpaguesin dhe që siguron mbledhjen e detyrimeve.

### Gjetje:

- Sikurse është trajtuar dhe në Kapitullin “Pesha në buxhet” në këtë raport, gjatë periudhës nën auditim, *borxhi tatimor në raport me shpenzimet buxhetore* ka vijuar të rritet vit pas viti. Në vitin 2017 ky raport ishte 20.6%, në vitin 2018 ishte 22.6%, ndërsa në vitin 2019 arriti 23.8%. Të njëjtin trend rritës ka patur edhe *raporti i borxhit tatimor me PBB-në*, ku në vitin 2017 ky raport ishte 6.16%, në vitin 2018 ishte 6.58%, ndërsa në vitin 2019 arriti në 6.97%.
- Strukturat e ngarkuara për mbledhjen me forcë janë shumë të shpërndara gjë që ka ndikuar në efektivitetin e punës së tyre për mbledhjen e borxhit ;
- Mospërdorimi i kompetencave që i jep ligji DRT-ve për shlyerjen dhe mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore;
- Rritja e borxhit tatimor nuk është analizuar në mënyrë të duhur nga DPT, ku të shqyrtoheshin metodat e përdorura në mbledhjen e borxhit dhe ajo që është e rëndësishme nuk ka analiza të koston së mbledhjes së borxhit, si një indikator i rëndësishëm i performancës së organeve tatimore.

### Konkluzion:

- *Strukturat e ngarkuara për mbledhjen me forcë janë shumë të shpërndara, mospërdorimi i kompetencave që i jep ligji DRT-ve për shlyerjen dhe mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore dhe mungesa e analizave të koston së mbledhjes së borxhit kanë ndikuar në rritjen e tij.*

Në përgjigje të observacionit të dërguar nga DPT, me shkresën nr. 434/3 prot., datë 13.11.2020 me objekt “*Observacion për projekt-raportin e auditimit të performancës Ecuria e borxhit tatimor*”, sqarojmë si më poshtë vijon:

- ***Pretendimi i subjektit:*** Rekomandimi mbi përkufizimin e borxhit tatimor nuk pranohet. Përkufizimet janë të pasqyruara në kuptim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.
- ***Qëndrimi i Grupit të auditimit:*** Observacioni pranohet.
- ***Pretendimi i subjektit:*** Rekomandimi “*DPT të rishikojë dhe hartojë mënyra të reja për administrimin e procesit të mbledhjes së detyrimeve tatimore, ku të analizohen mjetet reale...*” nuk pranohet. Mjetet janë të përcaktuara në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.
- ***Qëndrimi i Grupit të auditimit:*** Observacioni pranohet.

#### ➤ ***Trendi sipas viteve të detyrimeve tatimore të papaguara ( borxhi tatimor)***

Për realizimin e auditimit për evidentimin e trendit të borxhit është grumbulluar dokumentacioni i nevojshëm nga DMDTP si dhe nga Drejtoritë e tjera të DPT duke i përpunuara, si përgjigje e pyetësorëve me personat përgjegjës të organeve tatimore, nëpërmjet intervistave verbale dhe me shkrim, për periudhën e viteve 2017-2019, rreth:

- Nivelit të detyrimeve të papaguara tatimore i ndarë në vite, në vlerë dhe sipas llojit, në total për DPT dhe për çdo drejtori rajonale tatimore; evidenca të numrit të subjekteve debitore gjithsej dhe për çdo drejtori rajonale tatimore; shtesave dhe pakësimeve të detyrimeve të papaguara tatimore gjithsej dhe për çdo drejtori rajonale tatimore; llojit të masave shtrënguese të marra gjatë periudhës, etj.

- Raporte periodike të DPT, për mbledhjen me forcë të detyrimeve të papaguara tatimore, raporte të auditimit të përputhshmërisë; metodika të hartuara në shërbim të stafit të drejtorisë së mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara tatimore dhe drejtorive rajonale tatimore, materiale që kanë të bëjnë me përvojën pozitive të vendeve të tjera lidhur me menaxhimin e detyrimeve të papaguara tatimore.

Për këtë qëllim auditimi u fokusua në drejtim të :

- a. Organizimit dhe funksionimit të strukturave në mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara.
- b. Sistemin informatik C@TS, menaxhimi dhe përpunimi në kohë i të dhënave.
- c. Mënyrën e administrimit dhe menaxhimit të detyrimeve tatimore nga AQT.

**a-** Funksioni i mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore të pa paguara kryhet në secilën nga 14 Drejtoritë Rajonale Tatimore, nga të cilat në 7 prej tyre mbledhja me forcë është organizuar si drejtori dhe në 7 DRT si sektor.

Struktura e mbledhjes me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara e organizuar sipas Urdhrit nr.126, datë 02.08.2016, ndryshuar me Urdhrin të Kryeministrit nr. 49, dt. 27.02.2019, i ndryshuar me Urdhrin nr.86, datë 03.05.2019 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të punonjësve të ATQ”, si rrjedhojë e ristrukturimit organizativ të DPT dhe në veçanti Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara si në DPT dhe në Drejtoritë Rajonale ka pësuar ndryshime jo vetëm në emërtesë por dhe në numër të punonjësve në organikë që merren me mbledhjen me forcë, nga 147 veta që ishin një vit më parë gjatë periudhës viti 2017-2019 në 152 punonjës në organikë të planifikuar.

Për vitet 2017-2019, organikë nuk është plotësuar, si në nivel drejtuesish dhe në nivel specialistësh, e konkretisht në fund të vitit 2017 rezultojnë në fakt 123 punonjës, në fund të vitit 2018 rezultojnë 128 punonjës dhe në fund të vitit 2019 rezultojnë 138 punonjës, gjë e cila ka ndikuar në monitorimin e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara si në DPT, nëpërmjet (Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara) dhe në nivel DRT duke e ndikuar në rezultatet dhe në ecurinë e punës së mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara tatimore në afat.

**b-**Në kuadrin e sistemit të ri IT (C@TS) të administrimit të integruar në ATQ, u zbatua një Modul i ri i Menaxhimit të Borxhit (DMM), mirëpo një pjesë veprimesh ka vazhduar të kryhet me dorë. Moduli i Menaxhimit të mbledhjes me forcë funksionon brenda sistemit C@TS dhe është pjesë përbërëse e sistemit. Moduli i Mbledhjes me Forcë në sistemin C@TS evidenton në mënyrë automatike detyrimet tatimore për të cilat fillojnë masat shtrënguese të mbledhjes. Po në mënyrë automatike dërgon edhe “Njoftimin dhe kërkesën për pagesë” në faqen *e-filing* të tatimpaguesit. Kjo është faqja në të cilën tatimpaguesi hyn për të kryer deklaratimet e tij dhe është e pamundur që të mos e marrë edhe këtë njoftim. Është e drejtë e menaxherit të ish-DMF delegimi për ndjekjen në sistem të hapave të mëtejshëm procedurale për mbledhjen e borxhit tatimor, por mund të krijohen edhe në mënyrë manuale nga një përdorues në varësi të të drejtave të përdoruesit.

Në përgjigje të observacionit të dërguar nga DPT, me shkresën nr. 434/3 prot., datë 13.11.2020 me objekt “*Observacion për projekt-raportin e auditimit të performancës Ecuria e borxhit tatimor*”, sqarohet si më poshtë vijon:

- **Pretendimi i subjektit:** Drejtoria e Mbledhjes me Detyrimeve Tatimore të Papaguara në përputhje me ligjin nr 9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, “Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë”, është përgjegjëse për zbatimin e masave shtrënguese me qëllim rikuperimin e detyrimeve tatimore të papaguara. DMDTP nuk është përgjegjëse për kontabilizimin e detyrimeve tatimore të papaguara, por për zbatimin e masave shtrënguese lidhur me detyrimet të cilat rezultojnë të kontabilizuara.
- **Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Observacioni pranohet

c- Gjendja e detyrimeve të papaguara në fund të vitit 2017 është 95,505,943 mijë lekë që i përkasin 137,633 subjekte, në fund të vitit 2018 është 107,700,537 mijë lekë, që i përkasin 144,910 subjekteve dhe në fund të vitit 2019 është 116,994,227 mijë lekë, që i përkasin 151,279 subjekteve, trendi paraqitet me një rritje të ndjeshme, në masën 22,4%, krahasuar me vitin 2017. Referuar të ardhurave gjithsej të realizuara nga DPT ndër vite janë 145.8 mld në vitin 2017, në shumën 157.8 mld në vitin 2019 në shumën prej 165.3mld lekë në fund të vitit 2019. Borxhi në fund të vitit 2019 zë rreth 71% të të ardhurave tatimore. Duke analizuar të dhënat nisur nga zbatimi i ligjit rezulton se detyrimet e papaguara tatimore të raportuara nga Drejtorive Rajonale Tatimore nga viti 2017-2019 , është përfshirë dhe vlera e detyrimeve që i përket çështjeve që janë në proces gjyqësor e konkretisht:

- Në vlerën prej 95,5 mld në vitin 2017, vlera e proceseve gjyqësore 10,9 mld dhe i përket 409 subjekteve) ;
- Në vlerën prej 108 mld në vitin 2018, vlera e proceseve gjyqësore 13,9 mld dhe i përket 1,378 subjekteve) ;
- Në vlerën prej 117 mld lekë në vitin 2019, vlera e proceseve gjyqësore 13,7 mld dhe i përket 1,525 raste.

Tabela 26: Detyrimet tatimore të papaguara të vitit 2017.

<i>Në 000/lekë</i>			
Nr	Gjendja e detyrimeve	Nr. subjektesh	Vlera
1.	Gjendja e detyrimeve të papaguara në afat në datë 01.01.2017	146,650	147,068,070
2.	Shtuar detyrime për periudhën Janar- Dhjetor 2017	110,257	49,759,022
3.	Arkëtuar detyrime për periudhën Janar - Dhjetor 2017	67,552	21,652,458
4.	Sistemuar detyrime për periudhën Janar - Dhjetor 2017	2,137,	17,527,162
5.	Falur detyrime për periudhën Janar 2017	135,417	49,825,994
6.	Akcizë kaluar në doganë	39	12,315,535
7.	Gjendja me 31 Dhjetor 2017	137,633	95,505,943

*Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP të përpunuara nga Grupi i Auditimit.*

Borxhi tatimor në total prej 95,505,943 i përket 137,633 subjekteve përbëhet:

- Principali në shumën prej 56, 310,501 mijë lekë
- Gjobë në shumën prej 32,963,509 mijë lekë
- Kamat vonesa në shumën prej 6,231,933 mijë lekë

Në proces gjyqësor është në shumën prej 10,909,017 mijë lekë dhe i përket 409 subjekteve.

Tabela 27: Detyrimet tatimore të papaguara dhe në proces gjyqësor 2017

*Në 000/lekë*

LLOJII	Gjendja e	Detyrime	<i>Detyrime të pakësuara gjatë vitit 2017</i>	Vlera	Ne proces	Vlera
--------	-----------	----------	-----------------------------------------------	-------	-----------	-------

TATIMIT	detyrimeve ne fillim te vitit 2017	te shtuara gjate vitit 2017	Arketuar gjate vitit	Kthyer per sistemim	Akcize kaluar Doganes	Falur nga ligji nr 33/2017	gjithesej e detyrimeve te papaguara ne fund te muajit Dhjetor 2017	gjyqesor	gjithesej e detyrimeve te papaguara ne fund te muajit Dhjetor 2017 (pa proceset gjyqesore)
Tatim Fitimi	34,874,747	13,296,810	4,208,772	1,926,823	-	15,251,734	26,784,229	2,032,125	24,752,104
TVSH	52,129,897	13,502,442	5,432,950	4,720,047	-	20,900,301	34,579,041	5,873,734	28,705,307
Sig.Shoqerore	14,130,847	9,411,424	7,607,661	692,945	-	4,068,227	11,173,438	86,045	11,087,393
TAP	3,109,179	1,294,022	603,646	406,425	-	1,766,954	1,626,176	113,747	1,512,429
Te tjera	42,823,400	12,254,324	3,799,428	9,780,922	12,315,535	7,838,779	21,343,060	2,803,367	18,539,693
<b>Shuma</b>	<b>147,068,070</b>	<b>49,759,023</b>	<b>21,652,457</b>	<b>17,527,162</b>	<b>12,315,535</b>	<b>49,825,994</b>	<b>95,505,944</b>	<b>10,909,018</b>	<b>84,596,927</b>

Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP

Gjatë vitit 2017, administrata tatimore ka aplikuar ligjin e faljes nr.33/2017 datë 19.04.2017 “Për pagesën dhe fshirjen, shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrime të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore”, e cila ka pakësuar detyrimin e akumuluar të stokut të borxhit në shumën 49, 825,994 mijë lekë dhe që i takojnë 135,417 subjekteve.

Njëkohësisht rritja e borxhit gjatë vitit 2017 është 49,759,022 lekë e cila e ka kthyer situatën në gjendjen e mëparshme sikur ligji të mos ishte aplikuar.

Detyrimet e akcizës të mbajtura jashtë sistemit C@TS në fund vitit janë në shumën prej 2,331,447,296 lekë sipas të dhënave nga DRT, që i përket tre subjekteve të përmendura më poshtë, të cilat nuk janë transferuar në DPD pasi në Udhëzimin e MFE nr.9, datë 11.03.2019 “ Mbi modalitetet e transferimit pranë administratës doganore të të dhënave për subjektet e akcizës të cilët rezultojnë me detyrime të papaguara”, është vendosur kushtin që transferohen detyrimet të papaguara të akcizës të periudhës pas vitit 2010 dhe të kontabilizuara para datës 1 Tetor 2012 si dhe borxhet pas datës 1 Tetor 2012.

Kryesisht në totalin e detyrime të mbajtura jashtë sistemit peshën kryesore e detyrimet për “Akcizë” për 3 subjekte, e përbërë nga detyrim principal në shumën prej 589,752,495 lekë dhe kamat vonesa në shumën prej 337,530,745 lekë dhe gjoba inspektori në shumën prej 1,304,164,056 lekë. Sipas subjekteve detyrimi prej 2,331,447,296 lekë sipas vitit të krijimit dhe të ndarë sipas burimeve të krijimit paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela 28: Detyrime të mbajtura jashtë sistemit

Në lekë

NIP T	Subjekti	Viti i krijimit	Periudha	Data e vlerësimit	Lloji i taksës	Lloji i të ardhurës	Kodi global i të ardhurave	Detyrimi në total
.....	I	2010	2010	31.12.2012	Akcizë	Akcizë	Detyrim principal	222,015
.....	I	2010	2010	31.12.2012	Akcizë	Akcizë	Gjobë inspektori	494,030
.....	I	2010	2010	31.12.2012	Akcizë	Akcizë	Kamat vonese (interes)	83,183
.....	A	2009	2009	21.05.2012	Akcizë	Akcizë	Detyrim principal	589,530,480

.....	A	2009	2009	21.05.2012	Akcizë	Akcizë	Gjobë inspektori	1,180,015,286
.....	A	2009	2009	21.05.2012	Akcizë	Akcizë	Kamat vonese (interes)	337,447,562
.....	B	2010	2010	31.12.2011	Akcizë	Akcizë	Gjobë inspektori	123,654,740
	<b>Total Akcize</b>							<b>2,231,447,296</b>

Burimi : Të dhëna nga DRT Tiranë dhe DTM


Lidhur me vlerën e akcizës të kaluar në DPD, KLSH e ka trajtuar më gjerësisht atë në Vendimin nr. 164, datë 18.11.2018 të Kryetarit të KLSH-së, për auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve “*Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare*”, faqja 31-32. Aktualisht nga auditimi referuar të dhënave të DRTT rezultoi se ndaj subjekti ”A” ka filluar procesi i konfiskimit të aseteve sipas të dhënave nga DRTT dhe ndaj subjektit “ B” të cilit nga procesi gjyqësor me vendim gjykate të vitit 2019 i është hequr gjobë inspektori në shumën prej 123, 654,740 lekë.

Nga të dhënat e DPT, Sektorit të Menaxhimit dhe të Analizës së Detyrimeve të Papaguara nëpërmjet pyetësorëve rezulton se në fund të vitit 2017:

- 61,773 subjekte me status **Aktiv** zënë 45%, te numrit totalit te subjekteve debitor dhe me nje vlerë borxhi prej 44,927 milion lekë ose 47% të masës totale.
- 75,860 me status **Pasiv** zënë 55 % të numrit totalit të subjekteve debitor me një vlerë borxhi prej 50,578 milion lekë ose 53% të masës totale.

Gjatë vitit 2017 struktura e borxhit sipas llojit përbëhet nga detyrimi prej 56,310,501 mijë lekë, gjoba prej 32,963,509 lekë dhe interesa prej 6,231,932 mijë lekë.

Grafiku 2: Borxhi sipas llojit të tatimit pa proceset gjyqësore.



Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP

Përpunoi: Grupi i Auditimit.

- Në stokun e borxhit të ndarë sipas llojit të tatimit pa proceset gjyqësore, TVSH zë peshën më të madhe me 34%, e ndjekur nga Tatim fitimi me 29%, zëri Të tjera me 22%, Sigurimet shoqërore & Shëndetësore me 13% dhe TAP me 2%.

Tabela 29: Krahasimi midis viteve 2017 dhe 2016 për gjendjen e stokut në fund të vitit 2017 krahasuar me vitin 2016.


Në /000 lekë

Lloji i Tatimit	Gjendja e detyrimeve në fund të vitit 2016	Vlera gjithsej e detyrimeve të papaguara në fund të muajit Dhjetor 2017	Ndryshimi i Borxhit midis datave 31.12.2017 dhe 31.12.2016
<b>Tatim Fitimi</b>	34,874,747	26,784,229	8,090,518
<b>TVSH</b>	52,129,897	34,579,041	17,550,856
<b>Sig.Shoqerore</b>	14,130,847	11,173,438	2,957,409
<b>TAP</b>	3,109,179	1,626,176	1,483,002
<b>Te tjera</b>	42,823,400	21,343,060	21,480,340
<b>Shuma</b>	147,068,070	95,505,944	51,562,126

Burimi: DPT

Përpunoi: Grupi i auditimit

Grafiku 3: Borxhi tatimor viti 2016 krahasuar me vitin 2017.




Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP

Përpunoi: Grupi i Auditimit.

- Krahasuar me fundin e vitit 2016, gjatë këtij viti rënie të ndjeshme ka patur në zërin Të Tjera ku borxhi është ulur me 21.5 mld lek ndërsa tatimet e tjera janë ulur përkatësisht TVSH me 17.5 mld, Tatim Fitimi me 8.1 mld, Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore me 3 mld dhe TAP me 1.5 mld lek.

Grafiku 4: Stokut të borxhit sipas moshës dhe vlerës respektive më datë 31.12.2017.



Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP  
Përpunoi: Grupi i Auditimit.

- *Borxhi deri në 3 muaj* 13% ndaj totalit të stokut
- *Borxhi nga 3 - 6 muaj* 5 % ndaj totalit të stokut
- *Borxhi nga 6-12 muaj* 11 % ndaj totalit të stokut
- *Borxhi nga 1-2 vjet* 24% ndaj totalit të stokut
- *Borxhi mbi 2 vjet* 48% ndaj totalit të stokut (45.5 mld Lekë)

Tabela 30: Borxhi i regjistruar më 31.12.2017 i ndarë sipas llojit të pronësisë

Në 000/lekë

NR	DRT	Vlera gjithsej e detyrimeve në fund të 2017 pa proceset gjyqësore të muajit Dhjetor 2017		Vlera e detyrimit ndarë në :					
				Subjekte Shtetërore				Subjekte Private	
				Buxhetor		JoBuxhetor (ShA me kapital shtetëror )		Subjekte Private	
				nr. subj.	shuma	nr. subj.	shuma	nr. subj.	shuma
1	<i>Berat</i>	3,482	646,900	76	10,817	9	55,493	3,397	580,590
2	<i>Dibër</i>	2,320	671,936	92	19,970	4	40,880	2,224	611,086
3	<i>Durrës</i>	17,311	3,658,717	110	113,961	25	150,678	17,176	3,394,078
4	<i>Elbasan</i>	6,987	3,889,135	98	32,313	11	25,938	6,878	3,830,884
5	<i>Fier</i>	9,520	2,370,748	167	108,526	6	152,943	9,347	2,109,279
6	<i>Gjirokastrë</i>	3,361	747,442	88	26,422	20	60,769	3,253	660,251
7	<i>Korçë</i>	6,951	2,482,219	98	6,633	11	1,450	6,842	2,474,136
8	<i>Kukës</i>	1,619	665,217	117	316,148	40	2,301	1,462	346,768
9	<i>Lezhë</i>	3,392	4,267,984	69	76,000	4	9,612	3,319	4,182,372
10	<i>Sarandë</i>	3,443	747,432	49	4,955	4	3,653	3,390	738,824
11	<i>Shkodër</i>	7,652	2,165,473	88	12,292	13	312,787	7,551	1,840,394
12	<i>Tiranë</i>	63,126	40,425,861	425	1,028,209			62,701	39,397,652
13	<i>Vip DTM</i>	409	30,306,801	-	-	7	17,581,832	402	12,724,969
14	<i>Vlorë</i>	8,060	2,460,078	58	23244	21	98321	7981	2338513
<b>Totali</b>		<b>137,633</b>	<b>95,505,943</b>	<b>1,535</b>	<b>1,779,490</b>	<b>175</b>	<b>18,496,657</b>	<b>135,923</b>	<b>75,229,796</b>

Burimi i të dhënave: Evidencat të DMDTP  
Përpunoi: Grupi i Auditimit.

Sa më sipër borxhi paraqitet i ndarë në lloj dhe pronësi, subjekte private dhe buxhetorë përfshirë dhe sh.a me kapital shtetërorë.

- Në totalin e detyrimeve DRT Tiranë zë rreth 52% të totalit të detyrimeve të subjekteve private dhe 41% të totalit të borxhit tatimor të vitit 2017. Subjektet shtetërore zënë rreth 1,8 % të totalit të borxhit vjetor.

## Viti 2018

Tabela 31: Detyrimet tatimore të papaguara në vitin 2018.

*Në 000/lekë*

Nr	Gjendja e detyrimeve	Nr. rastesh	Vlera
1.	Gjendja e detyrimeve të papaguara në afat në datë 01.01.2018	137,633	95,505,944
2.	Shtuar detyrime për periudhën Janar- Dhjetor 2018	107,477	33,211,183
3.	Arkëtuar detyrime për periudhën Janar - Dhjetor 2018	76,306	18,370,424
4.	Sistemuar detyrime për periudhën Janar - Dhjetor 2018	5,284	2,342,554
5.	Falur detyrime për periudhën Janar 2018	1,074	303,612
6.	Gjendja me 31 Dhjetor 2018	144,910	107,700,537

Burimi i të dhënave: Evidencat të DMDTP

Përpunoi: Grupi i Auditimit.

Siç shihet nga treguesit e mësipërm gjatë vitit 2018, borxhi ka pësuar një rritje neto me 12,2 mld lek. Në vlerën e borxhit prej 107.7 mld lekë i cili i përket 144,910 subjekteve është e përfshirë edhe vlera prej 13.9 mld lek e cila është në proces gjyqësor dhe që i përket 1,378 rasteve sipas 14 DRT, dhe deri në fund të Dhjetor 2018 zë rreth 13% të stokut të borxhit.

Burimi i krijimit të kësaj shtese të detyrimeve tatimore të papaguara është nga Njoftim-Vlerësimet e sektorëve të kontrollit, vlerësimit, terrenit, gjoba dhe interesa të sistemit informatik (ku përfshihen edhe vetëdeklarimet), nga shtesa të paraportuara me parë (që i përkasin periudhave të mëparshme, por të paevidentuara).

Borxhi tatimor përbëhet :

-Detyrimi në shumën prej	60,606,913 mijë lekë
-Penalitet në shumën prej	40,188,841 mijë lekë
-Kamatë - vonesa në shumën prej	6,904,783 mijë lekë
<b>Totali</b>	<b>107,700,537 mijë lekë.</b>

## Gjetje:

- Gjendja e detyrimeve të papaguara në fund të vitit 2017 është 95,505,943 mijë lekë që i përkasin 137,633 subjekte, në fund të vitit 2018 ishte 107,700,537 mijë lekë, që i përkasnin 144,910 subjekteve dhe në fund të vitit 2019 ishte 116,994,227 mijë lekë, që i përkasnin 151,279 subjekteve.
- Aktualisht gjendja e detyrimeve jashtë sistemit në fund të vitit 2019 është në vlerë 2,196,421 mijë lekë, ku peshën kryesore e zënë detyrimet e akcises në vlerë 2,107,792,556 lekë, më hollësisht:
  - Detyrime nga subjekti “A” në shumën prej 926,978,042 lekë dhe gjobë në shumën prej 1,180,015,286 lekë,
  - Detyrime nga subjekti “ I” sha në shumën prej 305,198 lekë dhe gjobë në shumën prej 494,030 lekë.
- Referuar përgjigjeve të dhëna nga institucioni aktualisht nuk janë kryer veprime për mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara që mbahen jashtë sistemit.

- Për rritjen e detyrimeve tatimore të papaguara në afat nuk ka analiza të detajuara nga ana e strukturave të mbledhjes së borxhit në Drejtoritë Rajonale Tatimore.

#### **Konkuzione:**

- *Mbajtja e këtyre detyrimeve jashtë sistemit informatik të pa mbledhura ndër vite ndikon në rritjen e borxhit tatimor dhe njëkohësisht në shpenzimet e strukturave përkatëse.*
- *Rritja e detyrimeve tatimore gjatë periudhës 2017 – 2019 ka ardhur si rezultat i mos mosndjekjes nga ana e DRT –ve të të gjitha etapave të mbledhjes me forcë në bazë risku sipas ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar .*

#### **Rekomandim:**

15. Titullari i institucionit të ndërmarrë masat e nevojshme që të gjitha rastet e tatimpaguesve të cilat i përcillen prokurorisë në zbatim të nenit 105, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të klasifikohen dhe të trajtohen nga pikëpamja procedurale ndryshe nga detyrimet që përkufizohen si borxh tatimor.

***Qershor 2021 dhe në vazhdimësi***

16. Titullari i institucionit të ndërmarrë masa për kryerjen e analizave të veçanta për rastet e tatimpaguesve debitorë të cilat janë në proces apelimi duke analizuar në përfundim çdo përgjegjësi për vlerat të cilat sjellin risk të shtuar për institucionin.

***Shkurt 2021 dhe në vazhdimësi***

17. Nga ana e strukturave të mbledhjes me forcë në DPT dhe në DRT të kryhen analiza periodike të thelluara mbi gjendjen e detyrimeve tatimore të papaguara në afat, shkaqet e rritjes së tyre dhe parashikimet për vjeljen e tyre në të ardhmen.

***Shkurt 2021 dhe në vazhdimësi.***


Në përgjigje të observacionit të dërguar nga DPT, me shkresën nr. 434/3 prot., datë 13.11.2020 me objekt “*Observacion për projekt-raportin e auditimit të performancës Ecuria e borxhit tatimor*”, sqarojmë si më poshtë vijon:

- **Pretendimi i subjektit:** Rekomandimi “*DPT të rishikojë metodologjinë e vlerësimit të detyrimeve tatimore të papaguara në afat, duke mos përfshirë në këto detyrime vlerën e çështjeve që janë në proces gjyqësor.*”, nuk pranohet pasi në të dhënat e detyrimeve të papaguara janë të evidentuara detyrimet të cilat janë në proces gjyqësor dhe këto të dhëna i janë paraqitur grupit të auditimit për secilin vit.
- **Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Observacioni pranohet.
- **Pretendimi i subjektit:** Rekomandimi “*Nga ana e strukturave të mbledhjes me forcë në DPT dhe në DRT të kryhen analiza periodike të thelluara mbi gjendjen e detyrimeve tatimore të papaguara në afat dhe shkaqet e rritjes së saj me ritme të larta, parashikimet për vjeljen e tyre në të ardhmen, si dhe ndikimin e tyre në të ardhurat e buxhetit.*” pranohet pjesërisht. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara nuk mund të bëjë parashikime se sa do të arkëtojë pasi të gjitha detyrimet në zbatim të ligjit duhet të mblidhen. Gjithashtu, detyrimet e papaguara në afat nuk mund të vendosen në raport me të ardhurat e shtetit.
- **Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Me qëllim përcaktimin e objektivave vjetor dhe strategjik SMART për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara, DMTDP duhet të bëjë parashikime periodike mbi nivelin e arkëtimeve të detyrimeve tatimore të papaguara. Observacioni pranohet pjesërisht.

➤ **Struktura e borxhit sipas llojit të tatimit.**

Në fund të vitit 2018, referuar **ndarjes sipas llojit të tatimit**, borxhi per Tatimin mbi Vlerën e Shtuar është në masën 37% të total stokut te borxhit, ndjekur nga zëri “Tatim Fitimi” 28%, “Të tjera” me 21%, “Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore 13%” dhe “Tatimi mbi të Ardhurat Personale” vetëm 1%.

Grafiku 5: Gjendja e borxhit sipas llojit të tatimit



Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP, përpunoi grupi i auditimit.

Peshën më të madhe në zërin e TVSH e zë DRT Tiranë me 16,1 mld lekë e ndjekur nga NJTM me vlerë 11,5 mld lekë. E njëjta situatë është edhe në TF, Sig. Shoqërore dhe Shëndetësore dhe TAP, ku DRT Tiranë zë peshën më të madhe.


Tabela 32: Gjendja e borxhit në fund të vitit 2018 sipas DRT-ve.

Nr	D.R.T	Gjendja e borxhit 31.12.2018		Pesha specifike e DRT në totalin e borxhit
		Nr. Subjektsh	Vlera 000/lekë	
1	Berat	3,528	695,890	1%
2	Dibër	2,705	882,736	1%
3	Durrës	17,648	7,860,824	7%
4	Elbasan	7,502	4,339,528	4%
5	Fier	8,600	2,711,659	3%
6	Gjirokastrë	3,360	967,041	1%
7	Korçë	7,801	2,430,808	2%
8	Kukës	1,613	682,953	1%
9	Lezhë	3,811	4,567,046	4%
10	Sarandë	3,625	799,566	1%
11	Shkodër	7,964	2,243,046	2%
12	Tiranë	67,120	46,631,497	43%
13	NJTM	310	30,240,315	28%
14	Vlorë	9,323	2,647,628	2%
<b>TOTALI</b>		<b>144,910</b>	<b>107,700,537</b>	<b>100%</b>

Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP  
Përpunoi: Grupi i Auditimit.

- Siç shihet DRT Tiranë zë peshën më të madhe në totalin e stokut të borxhit me 43% e ndjekur nga NJTM me 28% e më pas DRT Durrës me 7%.


Grafiku 6: Borxhi sipas llojit të Tatimit viti 2017 vs 2018.



Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP  
Përpunoi: Grupi i Auditimit.

Krahasuar me fundin e vitit 2017, gjatë këtij viti TAP ka qëndruar në të njëjtin nivel, ndërkohë që TVSH është rritur me 4.7 mld lekë, Tatim Fitimi me 3.4 mld lekë, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore me 2.6 mld lekë dhe zëri “Të Tjera” me 1.4 mld lekë.

Grafiku 7: Mosha e borxhit.



Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP  
Përpunoi: Grupi i Auditimit.

- Në total stoku i borxhit prej 107,7 mld lekë, sipas vjetërsisë paraqitet si më sipër ku: Gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në afat (borxhit) në fund të periudhës 2018 përbëhet kryesisht nga detyrimet tatimore të lindura mbi 2 vjet në vlerë 60,8 mld lekë, të cilat zënë një peshë prej 56% të totalit të borxhit 107,7 mld lekë. Borxhi nga 1-2 vite në vlerë 18,1 mld lekë përbën 17% të stokut të tij ndërsa borxhi deri në 1 vit me vlerë 28,7 mld lekë zë 27%. DTR Tiranë dhe NJTM janë rajonet me peshën më të madhe në borxhin me vjetërsi mbi 2 vjet përkatësisht me 20,6 dhe 19,1 mld lekë. E njëjta situatë paraqitet edhe në fashat e tjera të segmentimit të moshës së borxhit.

Tabela 33: Borxhi i regjistruar më 31.12.2018 i ndarë sipas llojit të pronësisë.

Në 000/lekë

NR.	DRT	Buxhetor		Jo buxhetor		Privat	
		Nr. subj.	Vlerë borxhi	Nr. subj.	Vlerë borxhi	Nr. subj.	Vlerë borxhi
1.	Berat	70	7,831	10	65,642	3,448	622,417

2.	Dibër	99	11,345	56	61,038	2,550	810,353
3.	Durrës	73	9,137	37	70,653	17,538	7,781,034
4.	Elbasan	126	30,623	10	25,055	7,366	4,283,850
5.	Fier	115	13,535	84	157,995	8,401	2,540,129
6.	Gjirokastrë	110	48,031	7	49,763	3,243	869,247
7.	Korçë	110	7,984	13	20,950	7,678	2,401,874
8.	Kukës	70	108,741	6	187,649	1,537	386,563
9.	Lezhe	35	31,000	3	21,000	3,773	4,515,046
10.	Saranda	51	5,736	3	225	3,571	793,605
11.	Shkodër	113	117,629	13	272,514	7,838	1,852,903
12.	Tiranë	449	854,412			66,971	45,777,085
13.	VIP			13	17,075,996	297	13,164,319
14.	Vlorë	61	19,302	64	4,875	9,198	2,623,451
<b>Totali</b>		1,482	1,265,306	319	18,013,355	143,109	88,421,876

Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP

Përpunoi: Grupi i Auditimit.

Sa më sipër borxhi paraqitet i ndarë në lloj dhe pronësi, subjekte private dhe buxhetorë përfshirë dhe sh.a me kapital shtetërorë.

- Konstatohet se në totalin e detyrimeve DRT Tiranë zë rreth 51% të totalit të detyrimeve të subjekteve private dhe 42% të totalit të borxhit tatimor të vitit 2018. Subjektet shtetërore zënë rreth 2% të totalit të borxhit vjetor.

## Viti 2019

Tabela 34: Detyrimet tatimore të papaguara viti 2019.

<i>Në 000/lekë</i>			
Nr	Gjendja e detyrimeve	Nr. rastesh	Vlera
1.	Gjendja e detyrimeve të papaguara në afat në datë 01.01.2019	144,910	107,700,537
2.	Shtuar detyrime për periudhën Janar- Dhjetor 2019	96,920	52,941,261
3.	Arkëtuar detyrime për periudhën Janar - Dhjetor 2019	99,356	22,449,320
4.	Sistemuar detyrime për periudhën Janar - Dhjetor 2019	3,011	21,198,251
5.	Gjendja me 31 Dhjetor 2019	151,279	116,994,227

Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP të përpunuara nga Grupi i Auditimit.


- Siç shihet nga treguesit e mësipërm gjatë vitit 2019, borxhi ka pësuar një rritje neto me 9.2 mld lekë. Në vlerën e borxhit prej 116,994,227mld lekë i cili ndiqet deri më 31 Dhjetor 2019, është e përfshirë edhe vlera prej 13.7 mld lekë e cila është në proces gjyqësor dhe që i përket 1,525 rasteve sipas 14 DRT, dhe deri në fund të Dhjetor 2019 zë rreth 12% të stokut të borxhit.

Borxhi tatimor përbëhet :

- Detyrimi në shumën prej 69,001,015 mijë lekë
- Penalitete 41,026,572 mijë lekë
- Kamatë Vonesa 6,966,641 mijë lekë
- **Total 116,994,227 mijë lekë**

Në borxhin prej 116,994,227 mijë lekë është përfshirë dhe vlera e detyrimit që është në proces gjyqësor prej 13,7 mld lekë për 1525 raste ose 12 % të gjendjes së borxhit gjithsej.

Grafiku 8: Borxhi sipas llojit të Tatimit viti 2018 vs 2019.



Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP  
Përpunoi: Grupi i Auditimit.

Krahasuar me fundin e vitit 2019, gjatë këtij viti TAP ka qëndruar në të njëjtin nivel, ndërkohë që TVSH është rritur me 1.1 mld lekë, Tatim Fitimi me 1.4 mld lekë, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore me 1.3 mld lekë dhe zëri Të Tjera me 5.2 mld lekë.

Tabela 35: Mosha e borxhit.

*000/lekë*

<b>MOSHA E BORXHIT DERI NË 31.12.2019</b>						
	<b>Periudha</b>					
	<b>Borxhi deri në 3 muaj</b>	<b>Borxhi 3 - 6 muaj</b>	<b>Borxhi 6-12 muaj</b>	<b>Borxhi 1-2 vjet</b>	<b>Borxhi 2-5 vjet</b>	<b>Borxhi mbi 5 vjet</b>
<b>Borxhi</b>	5,589,086	8,117,628	8,131,210	16,163,830	51,091,354	27,901,119

Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP të përpunuara nga Grupi i Auditimit.

Në total stoku i borxhit prej 116,994,227 mijë lekë, borxhi sipas vjetërsisë paraqitet si më sipër ku:

- borxhi deri në 3 muaj 5% ndaj totalit të stokut
- borxhi nga 3 - 6 muaj 7% ndaj totalit të stokut
- borxhi nga 6-12 muaj 7% ndaj totalit të stokut
- borxhi nga 1-2 vjet 14% ndaj totalit të stokut
- Borxhi mbi 2 vjet 67% ndaj totalit të stokut (79 mld lekë).

- Peshën më të madhe në krijimin e detyrimeve të papaguara për periudhën objekt auditimi 2017-2019 e zënë detyrimet e akumuluar nga njoftim-vlerësimet e kontrolleve tatimore, vlerësimeve të bëra për tatimpaguesit, verifikimet në terren, gjobat dhe interesat e sistemit informatik, si dhe nga pamundësia në përmbushjen e detyrimit tatimor për shkak të situatës financiare e pasurore të tatimpaguesit

Tabela 36: Borxhi i regjistruar më 31.12.2019 i ndarë sipas llojit të pronësisë.

*Në 000/lekë*

	<b>Buxhetor</b>	<b>Jo buxhetor</b>	<b>Privat</b>

NR.	DRT	Nr. subj.	Vlerë borxhi	Nr. subj.	Vlerë borxhi	Nr. subj.	Vlerë borxhi
1.	Berat	25	1,600	8	73,020	3,494	709,466
2.	Dibër	59	10,746	28	68,519	2,697	970,961
3.	Durrës	64	18,643	6	37,616	18,385	9,110,476
4.	Elbasan	97	19,343	10	54,922	7,763	4,600,468
5.	Fier	76	7,733	95	106,040	10,080	2,873,915
6.	Gjirokastrë	87	40,676	8	54,553	2,943	831,444
7.	Korçë	78	6,964	12	18,858	7,605	2,338,344
8.	Kukës	66	101,915	42	213,930	1,817	424,335
9.	Lezhë	25	6,000	3	15,000	4,994	5,628,500
10.	Saranda	22	2,541	2	55	3,408	801,936
11.	Shkodër	103	104,266	15	302,655	8,572	2,152,765
12.	Tiranë	332	665,002	-	-	69,256	70,483,382
13.	VIP	-	-	10	5,702,905	193	5,539,506
14.	Vlorë	345	15,575	548	4,121	7,906	2,875,532
<b>Totali</b>		1,379	1,001,004	787	6,652,194	149,113	109,341,030

Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP  
Përpunoi: Grupi i Auditimit.

Sa më sipër borxhi paraqitet i ndarë në lloj dhe pronësi, subjekte private dhe buxhetorë përfshirë dhe sh.a me kapital shtetërorë, ku peshën kryesore e zë borxhi privat në masën prej 93% të totalit të borxhit.

- Në totalin e detyrimeve, DRT Tiranë zë rreth 64% të totalit të detyrimeve të subjekteve private dhe 60% të totalit të borxhit tatimor të vitit 2019. Subjektet shtetërore zënë rreth 0,8% të totalit të borxhit vjetor.

#### Gjetje:

- Gjatë vitit 2019, borxhi ka pësuar një rritje neto me 9.2 mld lekë. Në vlerën e borxhit prej 116,994,227 mld lekë i cili ndiqet deri më 31 Dhjetor 2019, është e përfshirë edhe vlera prej 13.7 mld lekë e cila është në proces gjyqësor.
- Gjendja e borxhit në fund të vitit 2019 i përket 151 mijë subjekteve debitore nga ku subjektet debitore aktive zënë rreth 38% të totalit të borxhit ose në vlerë 48,4 mld lekë dhe subjektet pasive zënë rreth 62% të totalit të borxhit ose në vlerë 68,6 mld .
- Për vitin 2019 arkëtimet në krahasim me vitin 2018 janë rritur në vlerë prej 4,078,896 mijë lekë ose 22% më shumë kur treguesi vjetor sipas Planit Strategjik 2017-2021 ishte 10%.

- Administrimi i procesit të masave shtrënguese deri në mbledhjen e detyrimeve tatimore nuk ka rezultuar në shterimin e plotë të hapave të cilat duhet të ndërmerren administrata tatimore për rikuperimin e tij konform përcaktimeve të ligjit nr.9920, datë19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimit në zbatim të tij.
- Drejtoritë e Kontrollit Tatimor (në DPT dhe DRT) nga viti 2017-2019, nuk kanë bashkëpunuar dhe ndihmuar sektorët e mbledhjes me forcë gjatë kryerjes së detyrave të tyre funksionale, për të kontribuar në mbledhjen e detyrimeve të papaguara të subjekteve tatimpagues. Kjo është e domosdoshme edhe për faktin se drejtoritë e kontrollit tatimor janë “burimi” kryesor i krijimit të detyrimeve tatimore të papaguara në afat, ku mbi 2/3 e këtyre detyrimeve kanë rrjedhur si rezultat i kontrolleve tatimore të ushtruara nga Drejtoritë e Kontrollit Tatimor.

#### **Konkluzione:**

- Rritja e borxhit nga viti 2017-2019 është shkaktuar kryesisht nga shtesat që vijnë nga vlerësimet dhe rivlerësimet e Administratës Tatimore, moskryerja e pagesave nga tatimpaguesit e detyrimeve tatimore, moskryerja e masave shtrënguese nga Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe kalimet në regjim pasiv gjithsej 94,500 subjekte në vlerë 68,578,352 mijë lekë ose 59% të numrit total të borxhit total në fund të vitit 2019.
- Për vitin 2019, detyrimet tatimore të papaguara janë rritur jo vetën në numër subjektësh por dhe në vlerë kjo për faktin se menaxhimi i këtyre detyrimeve tepër të vjetruar (mosha e borxhit nga 2-5, dhe mbi 5 vjet) në vlerë 79 mld lekë dhe që zënë 67% ndaj totalit të stokut janë bërë më të vështira dhe si rrjedhojë me më shumë kosto për t’u mbledhur.
- Drejtoritë e kontrollit tatimor, gjatë kryerjes së detyrave funksionale në ushtrimin e kontrolleve tatimore dhe vizitave të subjektet tatimpagues, nuk kanë mbledhur dhe përpunuar të dhëna të detyrimeve tatimore të papaguara për ish-DMF apo Sektorët e MF, duke mos kontribuar kështu në vjeljen dhe parandalimin e krijimit të këtyre detyrimeve

#### **Rekomandim:**

18. DPT dhe DRT-të duhet të përdorin informacionet që mbajnë për tatimpaguesit, për të ndërtuar profile të riskut për secilin prej tyre me borxh, përcaktimin e përparësive dhe përshtatjen e veprimeve të grumbullimit të borxheve. Nga ana e DRT-ve të zbatohen dhe monitorohen të gjitha masat shtrënguese për subjektet që evidentohen me të ardhura nga veprimtari ekonomike me kasë fiskale të në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9920, datë19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 88-101.

#### ***Shkurt 2021 dhe në vazhdimësi.***

19. DRT, të zbatojnë rregullisht metoda e vlerësimit të riskut nëpërmjet strukturave përkatëse të ngarkuara me mbledhjen me forcë, për të përcaktuar dhe zbatuar, në çdo rast, masën më të përshtatshme të mbledhjes me forcë, duke parandaluar krijimin e detyrimeve të papaguara me vlera të vogla, dhe ato të reja ( brenda vitit të krijuara) me qëllim që të maksimalizohet mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara duke i kushtuar kujdes borxhit të ri të krijuar.

#### ***Shkurt 2021 dhe në vazhdimësi.***

Në përgjigje të observacionit të dërguar nga DPT, me shkresën nr. 434/3 prot., datë 13.11.2020 me objekt “Observacion për projekt-raportin e auditimit të performancës Ecuria e borxhit tatimor”, sqarojmë si më poshtë vijon:

- **Pretendimi i subjektit:** Rekomandimi “DPT dhe DRT-të duhet të përdorin informacionet...” nuk pranohet. Marrëveshja e pagesës me këste nuk ndiqet nga strukturat e DMDTP.
- **Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Në kushtet kur, pas periudhës nën auditim, struktura përgjegjëse për ndjekjen e Akt-marrëveshjeve me këste ka ndryshuar, nga rekomandimi hiqet: “ndjekja e akt-marrëveshjeve me këste”. Observacioni pranohet pjesërisht.
- **Pretendimi i subjektit:** Rekomandimi “DRT-të i japin përparësi ndjekjes...” nuk pranohet. DPDTP në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duhet të ndjekë çdo detyrim të lindur dhe të papaguar.
- **Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Observacioni pranohet.

➤ **Borxhi tatimor për vitet 2017 -2019**

Referuar të dhënave të raporteve të paraqitura nga DMDTP dhe përgjigjeve të pyetësorëve për gjendjen e detyrimeve tatimore të papaguara në fund të vitit 2017-2019, të dhënat paraqiten sipas tabelës nr.37, si më poshtë vijon:

Tabela 37:Trendi i borxhit për vitet 2017 -2019.

Vitet	Gjendja e Borxhit Tatimor		Rritja në %
	Nr. subjektsh	Vlerë (000/lekë)	
2016	146,650	147,068,070	-
2017	137,633	95,505,943	-35%
2018	144,910	107,700,537	12,7%
2019	151,279	116,994,227	8,6%

Burimi: Të dhëna të DPT

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Tabela 38: Detyrimet tatimore të papaguara nga viti 2017-2019, progresive deri më 31.12.2019 sipas DRT-ve.

Në 000/lekë

NR	DRT	Gjendja e detyrimeve ne fund të vitit 2017		Gjendja e detyrimeve ne fund te vitit 2018		Gjendja detyrimeve ne fund të vitit 2019	
		nr. subj.	shuma	Nr subj.	shuma	nr. subj.	shuma
1	<i>Berat</i>	3,482	646,900	3,528	695,890	3,527	784,086
2	<i>Dibër</i>	2,320	671,936	2,705	882,736	2,784	1,050,226
3	<i>Durrës</i>	17,311	3,658,717	17,648	7,860,824	18,455	9,166,735
4	<i>Elbasan</i>	6,987	3,889,135	7,502	4,339,528	7,870	4,674,733
5	<i>Fier</i>	9,520	2,370,748	8,600	2,711,659	10,251	2,987,688
6	<i>Gjirokastrë</i>	3,361	747,442	3,360	967,041	3,038	926,673
7	<i>Korçë</i>	6,951	2,482,219	7,801	2,430,808	7,695	2,364,166

8	<i>Kukës</i>	1,619	665,217	1,613	682,953	1,925	740,180
9	<i>Lezhe</i>	3,392	4,267,984	3,811	4,567,046	5,022	5,649,500
10	<i>Sarandë</i>	3,443	747,432	3,625	799,566	3,432	804,532
11	<i>Shkodër</i>	7,652	2,165,473	7,964	2,243,046	8,690	2,559,686
12	<i>Tiranë</i>	63,126	40,425,861	67,120	46,631,497	69,588	71,148,384
13	<i>Vip</i>	409	30,306,801	310	30,240,315	203	11,242,411
14	<i>Vlorë</i>	8,060	2,460,078	9,323	2,647,628	8,799	2,895,228
	<b>Totali</b>	137,633	95,505,943	144,910	107,700,537	151,279	116,994,227

Burimi: Të dhëna nga DMDTP të përpunuara nga Grupi i Auditimit.

Bazuar në evidencat e marra nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara rezulton se gjendja e detyrimeve ka ardhur duke u rritur, 116,994,227 mijë lekë në fund të vitit 2019 nga 95,505,943 mijë lekë në fund të vitit 2017, në vlerë prej 21,488,284 mijë lekë ose 22,5%, kjo si pasojë e rritjes dhe të numrit të subjekteve debitore në fund të vitit 2019, nga 137,633 në fund të vitit 2017 në 151,279 subjekte në fund të vitit 2019.

Për rritjen e detyrimeve tatimore të papaguara në afat nuk ka analiza të detajuara dhe argumentuese nga ana e strukturave të mbledhjes së borxhit në DRT.

Kjo rritje e detyrimeve tatimore të papaguara ka ardhur si pasojë e mosfunksionimit të strukturave të mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara, e trajtimit të mbledhjes efektive dhe efikase të borxhit tatimor jo si objektiv kryesor i Planit Strategjik të Administratës Tatimore 2017 -2021, por si nën objektiv.

Në fund të vitit 2019 borxhi tatimor arrin 116,994,227 mijë lekë mld i cili zë rreth 45% të të ardhurave tatimore vjetore dhe 7 % të PBB.


Tabela 39: Subjektet aktive dhe pasive.

Në 000/lekë

VITI	Subjekte aktive	Vlera e borxhit per subjektet aktive	Subjekte pasive	Vlera e borxhit për subjektet pasive	Borxhi deri me fund të vitit	
					Nr. Sub	Vlerë Borxhi
2017	61,773	44,927,315	75,860	50,578,628	137,633	95,505,943
2018	58,936	46,322,549	85,974	61,377,988	144,910	107,700,537
2019	56,779	48,415,886	94,500	68,578,342	151,279	116,994,227

Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP të përpunuara nga Grupi i Auditimit.

Grafiku 9: Trendi i borxhit



Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP  
Përpunoi: Grupi i Auditimit.


Tabela 40: Mosha e Borxhit.

*Në 000/lekë*

<b>MOSHA E BORXHIT</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>
	<b>Shuma</b>	<b>Shuma</b>	<b>Shuma</b>
<i>borxhi deri ne 3 muaj</i>	12,190,616	7,260,571	5,589,086
<i>borxhi nga 3 - 6 muaj</i>	4,437,572	8,970,691	8,117,628
<i>borxhi nga 6-12 muaj</i>	10,469,771	12,560,827	8,131,210
<i>borxhi nga 1-2 vjet</i>	22,911,955	18,134,358	16,163,830
<i>borxhi nga 2-5 vjet</i>	29,403,816	35,486,080	51,091,354
<i>borxhi mbi 5 vjet</i>	16,092,213	25,288,010	27,901,119
<b>TOTALI</b>	<b>95,505,943</b>	<b>107,700,537</b>	<b>116,994,227</b>

Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP  
Përpunoi: Grupi i Auditimit.

Grafiku 10: Mosha e borxhit.



Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP , përpunoi Grupi i Auditimit.

Tabela 41: Borxhi më i vjetër se 2-vite.

Në 000 / lekë

LLOJI I TATIMIT	Gjendja 31.12.2017	Gjendja 31.12.2018	Gjendja 31.01.2019
	Vlera	Vlera	Vlera
Tatim Fitimi	8,443,474	12,534,884	19,015,188
TVSH	19,430,018	24,704,451	29,365,287
Sig. Shoqërore	5,220,604	8,795,106	9,848,609
TAP	888,481	951,139	1,440,502
Te tjera	11,511,341	13,788,511	19,322,887
<b>Totali</b>	<b>45,493,917</b>	<b>60,774,090</b>	<b>78,992,473</b>

Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP

Përpunoi: Grupi i Auditimit.

Tabela 42: Efektiviteti i masave shtrënguese ndër vite

Në 000/lekë

VITI	Vlerë e Vendosur	Vlerë e Arkëtuar	Diferencë	%
2017	188,914,522	14,114,067	174,800,455	7.4%
2018	347,461,504	14,882,972	332,578,532	4.2%
2019	325,347,143	20,179,037	305,168,106	6.2%

Burimi i të dhënave: Evidenca të DMDTP

Përpunoi: Grupi i Auditimit.

Në vitet 2017-2019, detyrimet e papaguara tatimore janë rritur me shpejtësi, duke tejkaluar të ardhurat tatimore që realizon ATQ, gjë që e bën edhe më kritik këtë problem për ekonominë dhe buxhetin e shtetit, duke kaluar disa herë nivelin e detyrimeve tatimore të papaguara që kanë vendet e Evropës.

DPT duhet të mundësojë dhe të përzgjedhë mekanizma dhe instrumente të përshtatshme për trajtimin e risqeve, si dhe të kuptuarit e arsyeve se pse grupe të caktuara të tatimpaguesve nuk veprojnë në përputhje me legjislacionin tatimor dhe të kontributeve shoqërore, duke i mundësuar administratës tatimore të përdorë dhe përqendrojë burimet e saj në mënyrë efektive.

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DPT ka si detyrë parësore të veprimtarisë së saj në zhvillimin e problemeve të politikave, administrimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së Drejtorive/Sektorëve të Mbledhjes në Rajone.

Drejtoria/ sektori i mbledhjes me forcë në Drejtoritë Rajonale, është pika e parë e kontaktit dhe bashkëveprimi ndërmjet punonjësit të organit tatimor dhe tatimpaguesve të cilët janë kundërvajtës për detyrime tatimore të papaguara në afat dhe që megjithëse kanë dijeni, nuk kanë përmbushur detyrimin.

Drejtoria/ sektori i mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara në Drejtoritë Rajonale përpunon rastet e tatimpaguesve që nuk kanë paguar detyrimin tatimor brenda afatit sipas Njoftimit Vlerësimit dhe Kërkesës për Pagimin e Detyrimeve të Papaguara, duke ballafaquar shumat e deklaruara dhe shumat e paguara për çdo deklaratë. Mbi këtë bazë, përgatiten Raporte

për numrin dhe shumën e borxheve tatimore për Drejtorin/Përgjegjësin e Drejtorisë së Mbledhjes dhe Drejtuesit e tjerë të Drejtorisë Rajonale. Këto informacione, raportohen sipas udhëzimeve përkatëse apo kërkesave edhe në Drejtorinë e Mbledhjes me Forcë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

***Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e detyrimeve kanë ardhur kryesisht:***

**1-** Bazuar në objektivat strategjike të ATQ, menaxhimi i detyrimeve tatimore të papaguara në afat, duhet përqendruar kryesisht në garantimin e mbledhjes së detyrimeve të prapambetura me koston më të ulët të mundshme, duke siguruar respektimin e të drejtave të tatimpaguesve, uljen e ekspozimit ndaj risqeve që lidhen me mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe në të njëjtën kohë, evidentimit sa më real të gjendjes së borxhit tatimor.

Strategjia e DPT 2017-2021, mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara është trajtuar si nën objektivi “Mbledhja efikase dhe efektive e borxhit”, strukturës përkatëse ku borxhi tatimor është rritur në shifra mjaft shqetësuese dhe nga ana e FMN dhe Bankës Botërore jepen rekomandime për masa konkrete dhe efikase për uljen e tij.

Nga ana e Administratës Tatimore për borxhin tatimor nuk ka një objektivi gjithëpërfshirës me strukturat e saj (si bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit Tatimor dhe Drejtorinë e Hetimit Tatimor), të konkretizuar me një plan konkret në mënyrë që borxhi tatimor të monitorohet me tregues konkret, të zbatueshëm referuar dhe treguesve të OECD, në mënyrë që aktivitetet e kryera nga strukturat përkatëse të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara të kenë rezultate të matshme dhe të zbatueshme në monitorimin dhe trajtimin e mbledhjes së borxhit si prioritet të veprimtarisë së DPT.

**2-** Strukturat e caktuara me ligj për mbledhjen e borxhit rezultuan si në nivel drejtues dhe inspektorësh si në DPT dhe DRT për periudhën 2017-2019 të pa plotësuar në organike gjë që ka ndikuar në efektivitetin duke e ndikuar në rezultatet dhe në ecurinë e punës së mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara tatimore në afat.

**3-** Administrata Tatimore Qendrore nuk ka arritur të menaxhojë detyrimet tatimore të papaguara në afat dhe të zbatojë me efektivitet masat organizative dhe shtrënguese për grumbullimin e tyre. Kjo evidentohet qartë në rritjen e konsiderueshme në vlerë dhe në numër të subjekteve me detyrime tatimore të papaguara me vjetërsi mbi 2 vjet, duke ndikuar kështu negativisht në të ardhurat e Buxhetit e Shtetit. Numri i borxheve që duhet të menaxhohen është rritur dhe për tepër janë vjetruar dhe janë bërë më të vështira dhe si rrjedhojë me më shumë kosto për t'u mbledhur. DPT dhe DRT-të duhet të përdorin informacionet që mbajnë për tatimpaguesit, për të ndërtuar profile të riskut për secilin prej tyre me borxh, përcaktimin e përparësive dhe përshtatjen e veprimeve të grumbullimit të borxheve dhe negocimin e akt-marrëveshjeve të pagesave.

**4-** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Strukturat e ngarkuara me ligj për mbledhjen me forcë në nivel rajonal dhe qendror), nuk kanë mundur të mbledhin detyrimet e papaguara nga subjektet tatimpagues e cila ka ardhur :

a- Pasi nuk janë ezauruar të gjitha etapat e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore në DRT-të, dhe nuk ka kryer monitorimin dhe kontrollin e duhur ndaj Drejtorive Rajonale Tatimore të kësaj veprimtarie të rëndësishme.

b- Kjo si rezultat dhe i mosfunksionimit si duhet të bashkëpunimit me institucionet shtetërore si Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme sot ASHK, me Bankat e nivelit të dytë i cili rezulton se ka qenë i pjesshëm, duke ulur ndjeshëm efektivitetin e veprimtarisë së Administratës Tatimore Qendrore në zbatimin e masave ligjore shtrënguese për

mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara në afat. Nga ana e institucionit nuk janë kryer iniciativa për ndërhyrje institucionale si pranë MFE dhe Ministrisë së Drejtësisë për ezaurimin e problemeve me këto institucione të rëndësishme.

-Administrata Tatimore Qendrore mbështetur në Planin Strategjik 2017-2021, ku për herë të parë është përcaktuar një nënobjektiv specifik, lidhur me mbledhjen e borxhit “Mbledhja efektive dhe efikase e borxhit”, por nuk ka arritur të menaxhojë detyrimet tatimore të papaguara në afat dhe të zbatojë me efektivitet masat organizative dhe shtrënguese për grumbullimin e tyre. Kjo evidentohet qartë në rritjen e konsiderueshme në vlerë dhe në numër të subjekteve me detyrime tatimore të papaguara në fund të vitit 2019 në vlerë prej 117 mld lekë , krahasuar me vitin 2017 një rritje në vlerë 22 mld ose 23%, pasi zë rreth 45% të ardhurave vjetore tatimore të vitit 2017 duke ndikuar kështu negativisht në të ardhurat e Buxhetin e Shtetit.

-Gjatë vitit 2017 administrata tatimore ka aplikuar ligjin e faljes e cila ka pakësuar detyrimin e akumuluar të stokut të borxhit në shumën prej 49,825,994 mijë lekë. Njëkohësisht rritja e borxhit gjatë vitit 2017 ishte në shumën prej 49,759,022 mijë lekë. Gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në afat në fund të periudhës (2019) përbëhet kryesisht nga detyrimet tatimore të lindura nga 2-5 vite me një peshë prej 44% të totalit të borxhit, gjë që tregon se sasi të mëdha detyrimeve tatimore të papaguara janë të pambledhshme, për të cilat DPT-së tashmë e ka praktikisht të vështirë të ndërmarrë veprime të mëtejshme ligjore për mbledhjen e detyrimit me forcë.

-Bashkëpunimi me institucionet shtetërore ka qenë i pjesshëm, sikurse është Drejtoria e Kontrollit Tatimor dhe Drejtoria e Hetimit Tatimor si dhe bankat e nivelit të dytë dhe ZQP Paluajtshme (aktualisht ASHK) duke ulur ndjeshëm efektivitetin e veprimtarisë së Administratës Tatimore Qendrore në zbatimin e masave ligjore shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara në afat.

-Drejtoritë e Kontrollit Tatimor (në DPT dhe DRT) nuk kanë bashkëpunuar dhe ndihmuar sektorët e mbledhjes me forcë gjatë kryerjes së detyrave të tyre funksionale, për të kontribuar në mbledhjen e detyrimeve të papaguara të subjekteve tatimpagues. Kjo është e domosdoshme edhe për faktin se drejtoritë e kontrollit tatimor janë “burimi” kryesor i krijimit të detyrimeve tatimore të papaguara në afat, ku mbi 2/3 e këtyre detyrimeve kanë rrjedhur si rezultat i kontrolleve tatimore të ushtruara nga Drejtoritë e Kontrollit Tatimor.

Në përgjigje të observacionit të dërguar nga DPT, me shkresën nr. 434/3 prot., datë 13.11.2020 me objekt “*Observacion për projekt-raportin e auditimit të performancës Ecuria e borxhit tatimor*”, sqarojmë si më poshtë vijon:

- **Pretendimi i subjektit:** Rekomandimi i mësipërm nuk pranohet. Përsa referuar më sipër, janë veprime operationale dhe administrative që DPDTP i ndjek në mënyrë të vijueshme.
- **Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Observacioni pranohet.

➤ **Indikatorët e OECD ( Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik).**

Kjo organizatë, fillesat e veprimtarisë së saj i ka nga viti 2004, dhe publikon dy herë në vit një raport të plotë në lidhje me administrimin të taksave dhe tatimeve duke krahasuar organet tatimore në më shumë se 50 vende të botës.

Për të vlerësuar performacën e mbledhjes së borxhit tatimor sipas OECD në Raportin e Publikuar për analizat e avancuara për Administratën më të mirë të Taksave ( OECD, Raport i vitit 2016) dhe ( OECD ë Raport i vitit 2019) ka përdorur indikatorë ( tregues) të cilat kanë shërbyer për të dhënë një pamje të plotë të mënyrës së administrimit të taksave dhe tatimeve në më shumë se 50

vende të botës nga krahasimi i veprimtarive të shteteve të ndryshme në administrimin e tatimeve dhe taksave dhe si rrjedhojë dhe detyrimet që rrjedhin nga këto.

Detyrimet tatimore të papaguara në vendin tonë kanë patur rritje të ndjeshme nga viti në vit, ku vetëm në v. 2019 ky tregues u rrit pothuaj me 50% krahasuar me vitin 2017 në vlerë 21,488,284 mijë lekë ose 22,5% në krahasim me gjendjen në fund të vitit 2017.

Referuar të dhënave të publikuara të raportit të OECD, rezulton se gama e veprimeve të ndërmarra nga administrata tatimore në më shumë se 50 shtete të botës për të mbledhur borxhin e pashlyer të taksave vazhdon të zhvillohet. Përparimet në modelimin parashikues dhe teknikat eksperimentale sikurse raportohen në Raportin e OECD “Për Analizat e avancuara për administratën më të mirë të taksave” ( OECD 2016) po ndihmojnë shumë administrata që të ndërmarrin më mirë ndërhyrjen me rrezikun specifik të tatimpaguesve. Përdorimi i një numri të qasjeve të ndërhyrjes po ndihmon në parandalimin e borxhit , si dhe trajtimin e detyrimeve të prapambetura të taksave.

Sipas Raportit të Publikuar OECD (2019), totali i detyrimeve në rajon mbetet shumë i madh - rreth 2 trilion euro.<sup>74</sup>

Për qëllime studimi dhe analize krahasuese, “*totali i detyrimeve të prapambetura tatimore*”, përcaktohet si shuma totale e tatimit që është vonuar për pagesë në fund të vitit fiskal dhe përfshin çdo interes dhe gjobë. Termi gjithashtu përfshin dhe pagesa të prapambetura, mbledhja e të cilave është shtyrë ( p.sh. si rezultat i marrëveshjeve me këste).

“Detyrimet e taksave të mbledhura ” ( sipas OECD) ose borxhi i mbledhshëm, janë shuma totale e detyrimeve të prapambetura, më pak se shumatat e kontestuara ose detyrimet e prapambetura, të cilat për arsye të tjera nuk janë në gjendje të arkëtohen, por kur veprimi i shlyerjes nuk ka ndodhur ende.

Indikatorët e përdorura për të matur performancën e mbledhjes së borxhit tatimor sipas OECD janë si më poshtë:

**1. Borxhi në fund të vitit /të ardhurat neto të mbledhura gjatë vitit fiskal.**


- Për vitin 2017 ( 95,5 mld lekë /214,7 mld lekë ) = 44.5%
- Për vitin 2018 (107,7mld lekë /232,2 mld lekë) = 46.4%
- Për vitin 2019 ( 117 mld lekë /236 mld lekë ) = 49.5%

Mesatarja e vendeve të OECD në vitin 2017, ishte 32%. Kjo vlerë është e fryrë si rezultat i vlerave skajore të pak shteteve, mesatarja e normalizuar është 15% ( Figura 3.12).

Figura 1: Të ardhurat e taksave totale të fundvitit si përqindje e totalit të të ardhurave neto, 2017

---

<sup>74</sup> - (OECD – 2019 / Tax Administration 2019: Comparative Information on OECD and other Advanced and Emerging Economies / Ch. 3.5.3. Performance in collecting outstanding debt / pg. 94 – 97 / OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/74dl62b6-en>).



*Shënim:* Për të përmirësuar krahasueshmërinë, TVSH-ja (importet bruto) është hequr nga totali i të ardhurave neto të mbledhura.

Burimi: Tabela D.20 Borxhet dhe borxhet e arkëtueshme.

{OECD (2019), *Tax Administration 2019: Comparative Information on OECD and other Advanced and Emerging Economies*.

Referuar të dhënave të DPT ( Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara), ky raport është përkeqësuar nga vitit 2017 e në vazhdim, pra nga 44,4 % në fund të vitit 2017 dhe në fund të vitit 2019 në 50%, gjë e cila tregon rritjen e detyrimeve tatimore të paguara në krahasim me rritjen e të ardhurave neto nga tatim taksa , ky zë është pothuajse 50 % e të ardhurave tatimore.


**2. Borxhi në fund të vitit – borxhin në çështje gjyqësore – borxhin e pambledhshëm / borxhin në fund të vitit ose raporti i borxhit të mbledhshëm ndaj borxhit në fund të vitit.** Ky është treguesi i borxhit të mbledhshëm( që do të thotë që totali i detyrimeve në fund të vitit sa është i arkëtueshëm).

- Për vitin 2017 ( 95.5 mld lekë - 10,9 mld lekë ) /95,5 mld lekë = 88,5 %
- Për vitin 2018 ( 107,7 mld lekë – 13,9 mld lekë ) /107.7 mld lekë = 87 %
- Për vitin 2019 (117 mld lekë - 13,7 mld lekë ) /117 mld lekë = 88,3 %

Mesatarja e OECD për vitin 2017 për 32 vende ishte 54% .

Ky tregues referuar të dhënave të rezultuara në fund të vitit 2017-2019 në vendin tonë është përkeqësuar. Po të krahasojmë të dhënat, në fund të vitit 2017 vendet si Italia ky raport ishte në masën prej 5% pra niveli i arkëtimit të detyrimeve tatimore në fund të vitit 2017 ishte 5% dhe për Kroacinë ishte 19,6%, ndërsa në vend të parë është Polonia dhe Hungaria që i konsideron të gjitha detyrimet në fund të vitit të arkëtueshme .

Figura 2: Prapambetjet e taksave të arkëtueshme të fundvitit si përqindje e prapambetjeve të tatimeve të fundvitit, 2017



Burimi: Tabela D.20 Borxhet dhe borxhet e arkëtueshme.

Për vendin tonë ky tregues rezulton se është përkeqësuar referuar të dhënave në fund të vitit 2018, pra borxhi i mbledhshëm rezulton në masën 88,3% ose 34,3% më shumë se vendet që trajtohen në raport dhe me vendet fqinjë si Kroacia rreth 69% më i lartë dhe me Italinë rreth 83,3% më i lartë Ky tregues tregon nivelin e lartë të detyrimeve të rezultuara në fund të viteve 2017-2019 si dhe mat në përgjithësi nivelin e borxhit të pambledhshëm dhe nivelin e ulët të përdorimit të masave shtrënguese nga administrata tatimore.

**3. Borxhi në fund të vitit – borxhin në çështjet gjyqësore – borxhin e pambledhshëm / të ardhurat neto të mbledhura gjatë vitit fiskal** tregon gjendjen në vlerë të borxhit të mbledhshëm ose nivelin e borxhit ndaj të ardhurave fiskale të mbledhura apo të realizuara.

- Për vitin 2017 ( 95,5 mld lekë - 10,9 mld lekë ) / 214, 7 mld lekë = 39.5 %
- Për vitin 2018 ( 107,7 mld lekë - 13,9 mld lekë ) / 232,2 mld lekë = 40.4 %
- Për vitin 2019 ( 117 mld lekë - 13,7 mld lekë ) / 236 mld lekë = 44%

Raporti është përkeqësuar gjë që tregon se borxhi i mbledhur në fund të vitit 2019 është rreth 44% të të ardhurave të realizuara tatimore, pra detyrimet tatimore të papaguara zënë rreth 1/2 e të ardhurave të munguara tatimore për vitin 2019 që duhet të ishin në buxhetin e shtetit.

**4. Borxhi në çështjet gjyqësore / borxhin në fund të vitit. Sipas të dhënave të DPT , pesha që zë borxhi në çështjet gjyqësore / borxhin në fund të vitit** paraqitet:

- Për vitin 2017 ( 10,9 mld lekë/ 95,5 mld lekë) = 11,4%
- Për vitin 2018 ( 13,9 mld lekë/ 107,7 mld lekë) = 13 %
- Për vitin 2019 ( 13,7mld lekë / 117 mld lekë) = 12 %

Ky tregues në vendin tonë, pra borxhi i cili është proces gjyqësor zë rreth 12 % të borxhit në fund të vitit 2019 dhe është rritur në krahasim me vitin 2017 me rreth 0,6% dhe krahasuar me vendet e rajonit sipas të dhënave të publikuara nga OECD tendenca është në ulje si p.sh. Kroacia e ka në ulje gjendjen e detyrimeve tatimore të papaguara në proces gjyqësor në masën -13%.

Krahasuar me të dhënat e OECD të raportuara për vitin 2017 në krahasim me vitin 2016, rezultojnë:

- Kroacia niveli i detyrimeve tatimore të papaguara në proces gjyqësor në fund të vitit 2017 janë ulur me 13% në krahasim me gjendjen në fund të vitit 2016;

- Greqia niveli i detyrimeve tatimore të papaguara në proces gjyqësor është ulur në masën 5%;

Të dhënat krahasohen ndaj totalit të detyrimeve sa është ulur borxhi në proceset gjyqësore në raport me borxhin në fund të vitit.

#### **Gjetje:**

- Për vendin tonë, për periudhën 2017-2019, indikatorët e përdorur nga OECD për të matur performancën e institucionit në mbledhjen e borxhit tatimor rezultojnë të përkeqësuar.

#### **Konkluzion:**

- *Si rezultat se, indikatorët e OECD të përdorur nga grupi i auditimit për të matur menaxhimin e borxhit tatimor në vendin tonë, nuk bëjnë pjesë në indikatorët e miratuar të DPT, nuk janë përdorur nga strukturat e mbledhjes me forcë për të vlerësuar ecurinë në drejtim të mbledhjes së borxhit tatimor dhe për të siguruar një analizë krahasimore të rezultateve të arritura nga vendi jonë, me ato të vendeve fqinje apo mesataren e arritur nga vendet e OECD-së.*

#### **Rekomandim:**

20. Titullari i institucionit dhe Komitetet e menaxhimit të punës në DPT, në rishikimin dhe përditësimin e Strategjisë dhe treguesve të performancës në lidhje me borxhin tatimor të marrin në konsideratë edhe treguesit e përdorur nga OECD për këtë qëllim.

**Shkurt 2021**

Në përgjigje të observacionit të dërguar nga DPT, me shkresën nr. 434/3 prot., datë 13.11.2020 me objekt “*Observacion për projekt-raportin e auditimit të performancës Ecuria e borxhit tatimor*”, sqarojmë si më poshtë vijon:

- **Pretendimi i subjektit:** Rekomandimi “*DPT të marrë masa që gjatë hartimit të planeve operacionale dhe raporteve vjetore për të vlerësuar performancën e institucionit në drejtim të mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara ( borxhi tatimor) duhet të përdorë treguesit e OECD për këtë qëllim.*” nuk pranohet. Në lidhje me sa rekomandimi më sipër, vendimmarrja i takon organit tatimor.
- **Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Observacioni pranohet dhe bëhet: “*Titullari i institucionit dhe Komitetet e menaxhimit të punës në DPT, në rishikimin dhe përditësimin e Strategjisë dhe treguesve të performancës në lidhje me borxhin tatimor të marrin në konsideratë edhe treguesit e përdorur nga OECD për këtë qëllim.*”

➤ **Kostoja e veprimtarisë së strukturave të mbledhjes me forcë për periudhën 2017-2019.**

Në bazë të informacionit të paraqitur në lidhje me analiza të kryera për kostot e veprimtarisë së Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara dhe të veprimtarisë së strukturave të mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara në DRT, rezultoi se nuk është kryer kjo analizë.

Referuar strukturave të mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara dhe fondit të pagave vjetore të harxhuar për tre vite objekt auditimi rezultoi:

Tabela 43: Arkëtimet në raport me fondin e pagave të shpenzuara për strukturat e mbledhjes me forcë

*Në lekë*

Vitet	Fondi i pagave	Arkëtimet nga masat shtrënguese	Raporti i arkëtimeve të kryera ndaj fondit të pagave të shpenzuar për strukturat e mbledhjes me forcë
2017	108,349,056	21,652,458,000	199.8
2018	107,632,673	18,370,424,000	170.7
2019	113,224,842	22,449,320,000	198.3

*Burimi i të dhënave: Të dhëna të DPT të përpunuara nga Grupi i Auditimit.*

Referuar të dhënave të tabelës rezultoi se për vitin 2017 për çdo 1 lekë të harxhuar për paga për strukturat që menaxhojnë mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara janë mbledhur 200 lekë borxh tatimor (**raporti 1/200**), për vitin 2018 për çdo 1 lekë të harxhuar për paga personeli janë mbledhur 171 lekë borxh tatimor (**raporti 1/171**), ndërsa për vitin 2019 për çdo 1 lekë të harxhuar për paga personeli janë mbledhur 198 lekë borxh tatimor (**raporti 1 / 198**). Nëse shikojmë eksperiencën e UK – nga Auditimet e bëra nga National Auditing Office – NAO pranë HM Revenues & Customs (HMRC – Agjencia qendrore përgjegjëse për mbledhjen dhe administrimin e detyrimeve tatimore & doganore) rezultoi se situata mbi borxhin tatimor dhe

performancën për mbledhjen e këtij borxhi për periudhën 2018 – 2019, periudhë që është mbyllur me 31 mars 2019 është si më poshtë<sup>75</sup>:

-Janë realizuar të ardhura tatimore gjithsej 627.9 miliard paund, nga këto 585.9 miliard paund janë mbledhur vullnetarisht dhe 34.1 miliard paund (planifikuar për 30 miliard) mbledhur në saj të masave sensibilizuese, promovuese dhe / apo shtrënguese nga strukturat e mbledhjes me forcë të borxhit tatimor;

-Kostoja efektive e realizimit të mbledhjes së detyrimeve tatimore është 0.52p (pens) të shpenzuara për 1 paund të ardhur nga detyrimet tatimore, *çfarë do të thotë se për 1 paund të shpenzuar nga organet tatimore janë mbledhur 192,3 paund të ardhura tatimore.*

-Nuk jepet një raport i drejtpërdrejtë *Kosto efektive e mbledhjes me forcë të borxhit tatimor/ Borxhi i mbledhur me forcë*, por jepet raporti i të ardhurave tatimore shtesë të realizuara këto nga strukturat e mbledhjes me forcë të borxhit ndaj disa kategorive të caktuara të tatimpaguesve, saktësisht:

- Rreth 7:1 është raporti i të ardhurave tatimore shtesë nga tatimpaguesit individualë për çdo paund të shpenzuar nga organet tatimore në 2018-2019;
- Rreth 12:1 është raporti i të ardhurave tatimore shtesë nga individët e pasur për çdo paund të shpenzuar nga organet tatimore në 2018-2019;
- Rreth 11:1 është raporti i të ardhurave tatimore shtesë nga bizneset e vogla për çdo paund të shpenzuar nga organet tatimore në 2018-2019;
- Rreth 19:1 është raporti i të ardhurave tatimore shtesë nga bizneset e mesme për çdo paund të shpenzuar nga organet tatimore në 2018-2019;
- Rreth 44:1 është raporti i të ardhurave tatimore shtesë nga bizneset e mëdha për çdo paund të shpenzuar nga organet tatimore në 2018-2019.

Pra, për vendin tonë rezulton se:

- Për vitin 2017 për çdo 1 lekë të harxhuar për paga për strukturat që menaxhojnë mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara janë mbledhur 200 lekë borxh tatimor (*raporti 1/200*), për vitin 2018 për çdo 1 lekë të harxhuar për paga personeli janë mbledhur 171 lekë borxh tatimor (*raporti 1/171*), ndërsa për vitin 2019 për çdo 1 lekë të harxhuar për paga pesoneli janë mbledhur 198 lekë borxh tatimor (*raporti 1 / 198*).

Në përgjigje të observacionit të dërguar nga DPT, me shkresën nr. 434/3 prot., datë 13.11.2020 me objekt “*Observacion për projekt-raportin e auditimit të performancës Ecuria e borxhit tatimor*”, sqarojmë si më poshtë vijon:

- ***Pretendimi i subjektit:*** Rekomandimi “DPT të rishikojë dhe hartojë mënyra të reja për administrimin...” nuk pranohet. Organi tatimor ndjek dhe zbaton procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- ***Qëndrimi i Grupit të auditimit:*** Observacioni pranohet.

<sup>75</sup> - HM Revenue & Customs - Annual Report and Accounts 2018-19 - NAO Report 16 July 2019 /Pg. 15-18 / 26-27 / 56-58

HM Revenue & Customs - “Tackling the tax gap” - NAO Report 15 July 2020 / Pg. 35 – Figure 14

#### 4. PËRMBLEDHJE

Lidhur me pyetjen kryesore u arrit në këtë mesazh auditimi:

*Menaxhimi i borxhit tatimor në nivel strategjik është mbështetur në një planifikim të dobët si rezultat i mungesës së një angazhimi të kujdesshëm dhe të efektshëm në ndarjen e strukturave përgjegjëse për kryerjen e aktiviteteve strategjike, si dhe mungesës së treguesve të matshëm për të vlerësuar realizimin e këtyre aktiviteteve vit pas viti, duke shkaktuar kështu pamundësinë për të monitoruar dhe vlerësuar realizimin e nën objektivit strategjik “Mbledhja efikase dhe efektive e borxhit”, nëpërmjet treguesve të përcaktuar në strategji. Mungesa e stafit të nevojshëm në Drejtoritë/Sektorët e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në drejtoritë rajonale, gjatë periudhës nën auditim 2017-2019, ka ndikuar negativisht në zbatimin e masave shtrënguese për mbledhjen e borxhit tatimor, si dhe në monitorimin e procesit. Për 20 tatimpaguesit me vlerë më të lartë borxhi të secilës prej 13 DRT-ve të marrë në shqyrtim nga grupi i auditimit, të cilët gjatë vitit 2019 kanë shtuar borxhin tatimor me 8,825,112 mijë, niveli i arkëtimeve nga zbatimi i masave shtrënguese ka qenë i ulët. Mos identifikimi i të gjitha pasurive të luajtshme të tatimpaguesve debitorë, si dhe mos regjistrimi i barrëve siguroese në Regjistrin e Barrëve Siguroese ka ndikuar negativisht në mbledhjen dhe menaxhimin e borxhit tatimor. Në vitin 2019, për 30 tatimpagues me vlerë borxhi 13,411,106 mijë lekë, si rezultat i mungesës së bashkëpunimit midis institucioneve që regjistrojnë pasuri të luajtshme/të paluajtshme dhe Drejtorive/Sektorëve të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, këto të fundit nuk kanë mundur të zbatojnë masat shtrënguese në mënyrë shteruese. Problematika janë evidentuar edhe në marrëveshjet me këste të lidhura, dhe rastet e tatimpaguesve debitorë për përcjellje tek DHT. Në vitin 2019, në DRT Dibër borxhi në vlerë 129,404 mijë lekë i 35% të tatimpaguesve debitorë të marrë në shqyrtim, nuk është ndjekur me masa shtrënguese në mënyrë shteruese.*

*Kjo situatë ka sjellë që niveli i borxhit tatimor në fund të vitit 2019 të ketë arritur në vlerën 116,994,227 mijë lekë, çka tregon se procesi i mbledhjes së borxhit tatimor nga strukturat e mbledhjes me forcë në Drejtoritë Rajonale Tatimore nuk ka qenë efektiv.*

Plani Strategjik 2017-2021 është dokumenti më i lartë në hierarkinë e dokumenteve të Administratës Tatimore Qendrore, i miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.12.2016 në mbledhjen e Komitetit të Reformave si menaxhmenti më i lartë i ATQ, i publikuar në faqen zyrtare të internetit të saj, dhe si i tillë konsiderohet version final dhe i gatshëm për implementim gjatë viteve në vijim. Për shkak se në Planin Strategjik strukturat përgjegjëse (DMDTP dhe DMR) janë përcaktuar në nivel nën-objektiv dhe nuk janë të lidhura në mënyrë të qartë dhe specifike me aktivitetet të cilat ato duhet të kryejnë, të paktën njëri prej aktiviteteve strategjike për mbledhjen e borxhit tatimor, nuk është reflektuar në planet vjetore të asnjërës prej strukturave përgjegjëse për periudhën 2017-2019 dhe rrjedhimisht nuk ka gjetur zbatim. Treguesit e performacës të vendosur në strategji nuk janë të matshëm, ato nuk janë përdorur për të monitoruar arritjen e nën-objektivit strategjik 2.3, sikurse parashikohet në Planin Strategjik 2017-2021 të DPT-së. Mungesa e targetave vjetor e bën të pamundur vlerësimin e realizimit të këtyre aktiviteteve vit pas viti. Mospërcaktimi i rezultateve të synuar për asnjë prej aktiviteteve/treguesve të performancës të parashikuar në Strategji nuk krijon mundësinë për të krahasuar (benchmarking) rezultatet e arritura nga implementimi i aktiviteteve me rezultatet e pritshme dhe e bën të pamundur vlerësimin nëse aktivitetet janë përmbushur apo jo. Gjithashtu,

targetat operacionalë të vendosur për vitet 2018-2019 nuk janë të miratuar duke mos siguruar kështu relevancën e tyre për të matur arritjen e objektivave operacionalë.

Mungesa si në DMDTP ashtu edhe në disa drejtori rajonale e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale, e Përgjegjësit të Sektorit dhe inspektorëve të mbledhjes me forcë gjatë periudhës së auditimit 2017-2019 ka bërë që të mos sigurohet mbikëqyrja e monitorimi i punës për secilin punonjës. Vendet e lira të punës në DMDTP përgjatë periudhës 2017-2019 (në vitin 2017 rezultojnë 29 pozicione pune, në vitin 2018 janë 22 pozicione pune, në vitin 2019 janë 14 pozicione pune) tregojnë mangësi në procesin e realizimit të strukturës së miratuar, si dhe mangësi në procesin e rekrutimeve në punë të punonjësve. Gjithashtu, mosplotësimi me staf i kësaj drejtorie/sektori si dhe kryerja e punës nga specialistët në mungesë të drejtorëve të drejtorive dhe të P/Sektorit në disa DMDTP përgjatë periudhës nën auditim 2017-2019 shoqërohet me risk të lartë në mirëfunksionimin e punës. Përgjithësisht Drejtoritë për shkak të vendeve vakante të pozicionit Drejtor/Përgjegjës Sektori, kanë funksionuar me delegime në mungesë të plotësimit të tyre sipas procedurave ligjore, duke përdorur në masë delegimin e një pozicioni vakant pune me të gjitha atributet e veta dhe në një afat të gjatë, duke cënuar kështu përmbushjen e misionit të punës së këtij pozicioni.

Në këtë auditim, u analizua zbatimi i masave shtrënguese për 20 tatimpaguesit më të mëdhenj debitorë të secilës Drejtorie Rajonale Tatimore. Si rezultat se DRT Vlorë nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion, grupi i auditimit nuk ka mundur të analizojë ecurinë e borxhit tatimor dhe zbatimin e masave shtrënguese për 20 tatimpaguesit më të mëdhenj të kësaj DRT-je. Stoku i borxhit i 20 tatimpaguesve më të mëdhenj të 13-DRT-ve marrë në shqyrtim nga grupi i auditimit, rezulton të përbëjë rreth 53% të totalit të stokut të borxhit për vitin 2017, 52% të totalit të stokut të borxhit për vitin 2018, 55 % të totalit të stokut të borxhit për vitin 2019. Stoku i borxhit të 20 tatimpaguesve më të mëdhenj të 13 DRT-ve, në fund të vitit 2018 rezulton 5,865,681 mijë lekë më i lartë se në fillim të vitit. Stoku i borxhit të tatimpaguesve të marrë në shqyrtim, në fund të vitit 2019 rezulton 8,825,112 mijë lekë më i lartë se ai në fillim të vitit. Në vitin 2018, totali i stokut të borxhit tatimor është rritur me 13%. Nga analizimi i të dhënave rezulton se, stoku i borxhit i marrë në shqyrtim në secilën prej DRT-ve Tiranë (19%), Durrës (20%), Dibër (19%), Fier (35%) dhe Shkodër (15%), gjatë vitit 2018 është rritur me mbi 13%. Në vitin 2019, totali i stokut të borxhit tatimor është rritur me 9%. Nga analizimi i të dhënave rezulton se, stoku i borxhi i marrë në shqyrtim në secilën prej DRT-ve Tiranë (27%), Durrës (25%), Lezhë (27%), Berat (18%), Dibër (34%) dhe Shkodër (77%), gjatë viti 2019 është rritur me mbi 9%. Nga analizimi i të dhënave për 20 tatimpaguesit e marrë në shqyrtim, të cilët zënë 55% të totalit të stokut të borxhit dhe e kanë shtuar atë me rreth 8.8 mld lekë në vitin 2019, niveli i arkëtimeve të realizuara nga zbatimi i masave shtrënguese është i ulët, në vlerën 1,184,472 mijë lekë. Megjithëse 20 tatimpaguesit e marrë në shqyrtim në DRT Tiranë kanë një nivel të lartë borxhi dhe 10 prej tyre janë me status aktiv, gjatë vitit 2019 nuk ka patur arkëtime nga zbatimi i masave shtrënguese, për këta tatimpagues.

Për 3 tatimpaguesit nga 20 të marrë në shqyrtim në DRT Dibër, me stok të shtuar borxhi në 2019 krahasuar me stokun e borxhit në fillim të vitit 2018 në vlerën 31,862 mijë lekë, masat shtrënguese nuk janë zbatuar në përputhje me Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, Manualin e Mbledhjes me Forcë dhe Udhëzuesin e përgjithshëm për procedurat e mbledhjes me forcë. Për 4 tatimpagues nga 20 të marrë në shqyrtim në DRT Dibër, me 38,942 mijë lekë stok të shtuar borxhi në vitin 2019, gjatë këtij viti masat shtrënguese nuk janë zbatuar në përputhje me Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në

Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, Manualin e Mbledhjes me Forcë 2017, të DPT-së dhe Udhëzuesin e Përgjithshëm për Procedurat e Mbledhjes me Forcë 2018, të DPT-së. Në total, në vitin 2019 stoku i borxhi prej 129,404 mijë lekësh i 7 tatimpaguesve në DRT Dibër, nuk është ndjekur me masa shtrënguese sikurse parashikohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në gjykimin e grupit të auditimit, mungesa e stafit të nevojshëm për të zbatuar masat shtrënguese, gjatë periudhës nën auditim ka ndikuar negativisht në realizimin e mbledhjes me forcë të borxhit tatimor në DRT Dibër. Monitorimi i kryer gjatë periudhës nën auditim për DRT Dibër, nuk ka siguruar identifikimin e problematikave dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për zbatimin e masave shtrënguese për mbledhjen e borxhit tatimor për 35% të tatimpaguesve të marrë në shqyrtim nga grupi i auditimit në këtë DRT.

Gjatë periudhës nën auditim, Drejtoritë/Sektorët e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara nuk kanë kërkuar informacion në të gjitha zyrat që regjistrojnë pasuri të luajtshme dhe rrjedhimisht nuk është vendosur barrë siguroese mbi këto pasuri, sipas përcaktimeve të Nenit 91, pika 91.2.5 dhe pika 91.2.8 të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Kjo përmban riskun që pasuri të tjera të luajtshme të tatimpaguesve debitorë, si mjete lundruese, etj., të mos jenë identifikuar dhe rrjedhimisht vijuar në fazat e tjera të mbledhjes me forcë.

Nga analizimi i të dhënave të përcjella nga 13 DRT-të, për 12% të tatimpaguesve të marrë në shqyrtim me vlerë borxhi 13,411,106 mijë lekë në vitin 2019, si rezultat i mungesës së bashkëpunimit midis institucioneve të përfshira në mbledhjen me forcë të borxhit tatimor, Drejtoritë/Sektorët e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara nuk kanë mundur të identifikojnë pasuritë e tatimpaguesve dhe të vijojnë me zbatimin e masave shtrënguese.

Gjatë periudhës nën auditim procedura për regjistrimin e barrëve siguroese në R.B.S nuk është zbatuar dhe ndjekur në vazhdimësi. Gjatë kësaj periudhe nuk ka patur fond buxhetor të planifikuar për pagesën e tarifave të shërbimit, të nevojshëm për zbatimin e saj. DRT-të i janë drejtuar për vendosjen e barrës siguroese DRSHTRR-ve/DPSHTRR, të cilat deri në 20.09.2019 kanë bërë bllokimin e mjeteve në emër të Administratës Tatimore. Pas kësaj date, ka qenë i domosdoshëm regjistrimi i barrëve siguroese në R.B.S, për të vijuar me masat e tjera shtrënguese. Deri në shkurt 2020 ngërçi për regjistrimin e barrëve siguroese në R.B.S dhe vijimin me zbatimin e masave të tjera shtrënguese, nuk ka gjetur zgjidhje.

Diferenca që ekziston midis Manualit të Mbledhjes me Forcë 2017 pika 4.5.2 dhe Udhëzuesit të Përgjithshëm të Procedurave të Mbledhjeve me Forcë 2018 pika 7, të DPT-së, si dhe mospasja e një procedure të mirëpërcaktuar për të identifikuar tatimpaguesit të cilët me dashje nuk paguajnë detyrimet tatimore, nuk sigurojnë qartësi lidhur me rastet për përcjellje tek DHT, duke ndikuar negativisht në ndjekjen dhe mbledhjen e borxhit tatimor. Tatimpaguesi “A” me vlerë borxhi 123,844 mijë lekë në vitin 2019, i cili rezulton me fitim gjatë periudhës 2017-2019, nuk rezulton i referuar DHT-së.

Nga analizimi i akt-marrëveshje rezultoi se :

- lidhja e akt-marrëveshjeve nga ana e strukturave përgjegjëse në drejtoritë rajonale për 24 raste në vitin 2018, dhe për 18 raste për vitin 2019 për të njëjtin tatimpagues në periudha të shkurtra kohore, dhe zgjidhja e tyre në aq herë sa është lidhur akt-marrëveshja si rezultat i mosrespektimit të kushteve të marrëveshjes, si dhe
- 44 akt-marrëveshje të lidhura në vitin 2018, dhe 51 akt-marrëveshje të lidhura në vitin 2019 me 0 këste të paguara dhe me detyrim të mbetur papaguar përkatësisht 166,483 mijë lekë për vitin 2018 dhe 130,496 mijë lekë në vitin 2019, tregon se:

nga ana e strukturave përgjegjëse në DRT, për këta tatimpagues nuk është kryer analiza për vlerësimin e riskut lidhur me përmbushjen e kushteve të marrëveshjes, si dhe nuk është analizuar situata nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore, duke mosrespektuar pikën 2 dhe 3 të Nenit 18 të Rregullores së funksionimit të DRT-ve. Sa më sipër ka ndikuar në moszgjedhjen e masave më të përshtatshme të mbledhjes, me qëllim arkëtimin e të gjithë detyrimit tatimor për të cilën lidhet akt-marrëveshje për pagesë me këste.

Shtesat që vijnë nga vlerësimet dhe rivlerësimet e Administratës Tatimore, moskryerja e pagesave nga tatimpaguesit e detyrimeve tatimore, moskryerja e masave shtrënguese nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, kalimet në regjim pasiv gjithsej të 94,500 subjekte në vlerë 68,578,352 mijë lekë ose 59% të numrit total të borxhit në fund të vitit 2019 kanë shkaktuar rritjen e borxhit nga viti 2017-2019. Gjithashtu, mungesa e bashkëpunimit me strukturat si ajo e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor dhe Drejtorisë së Hetimit ka sjellë arritjen e nivelit të borxhit në vlerë 107.7 mld lekë për vitin 2018 dhe 116,994,227 mijë lekë në fund të vitit 2019.

Indikatorët e përdorur nga OECD për të matur performancën e institucionit në mbledhjen e borxhit tatimor, të përdorur nga grupi i auditimit për të analizuar borxhin tatimor në vendin tonë rezultojnë të përkeqësuar për vitet 2017-2019.

Në përgjigje të pyetjes: *“A janë formuluar siç duhet Planet strategjike dhe ato operacionale për mbledhjen e borxhit tatimor?”*, rekomandimet i janë drejtuar kryesisht Titullarit të institucionit dhe Komitetit të Reformave për përditësimin e Planit Strategjik me qëllim përcaktimin e strukturave përgjegjëse në mënyrë të qartë dhe specifike me aktivitet strategjike që duhet të kryejnë, parashikimin e indikatorëve të matshëm, të arritshëm dhe relevant, si dhe përcaktimin e targetave/rezultateve të pritshme, me shifra dhe narrative, për çdo vit në të cilën shtrihet Strategjia.

Në përgjigje të pyetjes *“A janë zbatuar në mënyrë shteruese masat për menaxhimin e e borxhit tatimor?”*, rekomandimet i janë drejtuar kryesisht strukturave të mbledhjes me forcë në Drejtoritë Rajonale Tatimore me qëllim identifikimin e të gjithë pasurive të tatimpaguesve debitorë mbi të cilat mund të vendoset barrë siguroese, si dhe regjistrimin e këtyre të fundit në Regjistrin e Barrëve Siguroese. Rekomandime i janë drejtuar edhe DHT-së dhe DMDTP-së, me qëllim marrjen e masave për zbatimin e Udhëzimit Nr. 41, datë 13.06.2017 *“Për bashkëpunim ndërmjet strukturave të administratës tatimor për trajtimin e rasteve që përmbajnë elementë të veprës penale në fushën e tatimeve”*.

Në përgjigje të pyetjes: *“A është përmirësuar mbledhja e borxhit tatimor gjatë periudhës nën auditim?”* rekomandimet i janë drejtuar kryesisht strukturave të mbledhjes me forcë në DRT-të me qëllim kryerjen e analizave periodike të thelluara mbi gjendjen e detyrimeve tatimore të papaguara në afat, shkaqet e rritjes së tyre, parashikimet për vjeljen e tyre në të ardhmen, dhe ndërtimin e profileve të riskut për tatimpaguesit debitorë.

*Aneksë*

*Intervistë zyrtare*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT**

*Adresa: Rr. Abdi Toptani, nr. 1, Tiranë; Tel-Fax: 0694057089*

*E-mail: [mnaco@klsh.org.al](mailto:mnaco@klsh.org.al); Web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)*

Tiranë më, 11/06/2020

**MBI AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË  
“Ecuria e borxhit tatimor”**

**Lënda:** Intervistë Zyrtare

**Drejtuar:** Z. K.SH

Zv/Drejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve  
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

**Tiranë**

I nderuar Z. Zv/Drejtor!

Në pamundësi për të zhvilluar intervistat paraprake me stafin e DMDPT kërkojmë nga stafi përgjegjës, përgjigjen me shkrim për pyetjet e kësaj interviste. Në përputhje me dispozitat e nenit 15, pikat dh), e), të ligjit nr. 154/2014 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, grupi i auditimi kërkon përgjigjen zyrtare dhe plotësimin e tabelës bashkëlidhur, së bashkë me dokumentet mbështetëse ***brenda datës 18.06.2020***.

**A. Objektivat strategjik dhe operacional**

1. Lutemi, listoni *objektivat strategjik të DPT-së* për menaxhimin e detyrimeve të papaguara tatimore (borxhit tatimor), që mbulojnë periudhën 2017-2019. Vini në dispozicion dokumentin/at në të cilin/at janë përcaktuar këto objektiva.
2. Çfarë vlerësimesh janë kryer për të konkluduar në këto objektiva? Vini në dispozicion dokumentet mbështetëse.
3. Lutemi, listoni *objektivat vjetor të Drejtorisë për Mbledhjen e Detyrimeve të Papaguara Tatimore (DMDPT)* dhe të dy Sektorëve në përbërje, për secilin prej viteve 2017, 2018, 2019. Vini në dispozicion dokumentin/at në të cilin/at janë përcaktuar këto objektiva.
4. Çfarë vlerësimesh janë kryer për të konkluduar në këto objektiva vjetor, me qëllim arritjen e objektivave strategjik? Vini në dispozicion dokumentet mbështetëse.

**B. Realizimi i objektivave**

5. Lutemi plotësoni në formë tabelare *objektivat strategjik* për menaxhimin e detyrimeve të papaguara tatimore (borxhit tatimor), indikatorët e përdorur për të matur arritjen e tyre, dhe rezultatet e arritura. (Tabela në excel bashkëlidhur me këtë intervistë, fq. 1. seksioni A).
6. Lutemi plotësoni në formë tabelare, *objektivat vjetor të DMDPT*, indikatorët e përdorur për të matur arritjen e tyre, dhe rezultatet e arritura. (Tabela bashkëlidhur me këtë intervistë, fq1. seksioni B).
7. Çfarë rezultatesh ka shënuar DPT në mbledhjen e borxhit tatimor sipas indikatorëve të TADAT?<sup>76</sup> (Tabela bashkëlidhur me këtë intervistë, fq.1, seksioni C).
8. Cili është periodiciteti i publikimit të rezultateve të arritura sipas këtyre indikatorëve të TADAT?
9. Cili ka qënë trendi i stokut të borxhit tatimor gjatë periudhës 2017-2019? Lutemi, plotësoni të dhënat mbi detyrimet taimore të papaguara në afat, sipas tabelës bashkëlidhur me këtë intervistë (fq. 2).
10. Cila është gjendja e borxhit në sistem për vitet 2017, 2018, 2019? Cila është gjendja e borxhit jashtë sistemit për vitet 2017, 2018, 2019? Si mbahet borxhi jashtë sistemit? Bashkëlidhni evidencat (regjistrimin), për çdo DRT.

### **C. Përbushja vullnetare (TADAT- POA3) dhe parandalimi i krijimit të detyrimeve të reja të papaguara në afat (OECD 2020)**

11. A është hartuar strategjia e komunikimit në mbështetjet të tatimpaguesve për të përbushur në kohë detyrimet tatimore?<sup>77</sup> Lutemi, vini në dispozicion dokumentin.
12. A aplikohet qasja për të komunikuar me tatimpaguesin përpara afatit të pagesës? Si realizohet kjo? Vini në dispozicion dokumentet mbështetëse.
13. Çfarë qasje keni aplikuar për të siguruar përbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit, për të shmangur fillimin e masave shtrënguese?<sup>78</sup>
14. A është bërë e mundur zbatimi i masave të mbledhjes me forcë, vetëm për ato taksapagues që qëllimisht nuk pajtohen me legjislacionin tatimor?<sup>79</sup> Si është realizuar kjo?
15. Nëse është bërë e mundur sa më lartë, sa është numri i taksapaguesve që qëllimisht nuk pajtohen me legjislacionin tatimor dhe sa është numri i atyre që kanë paaftësi paguese?
16. Çfarë aktiviteteve ndërmerrni për të parandaluar krijimin e detyrimeve të reja të papaguara në afat?<sup>80</sup> Lutemi, vini në dispozicion dokumentet mbështetëse.
17. A janë të informuar tatimpaguesit për të lidhur marrëveshje me këste? Si është kryer informimi i tyre?

### **D. Menaxhimi në bazë risku i detyrimeve të papaguara në afat (TADAT-POA2)**

18. Si është ka bashkëpunuar Drejtoria juaj me Drejtorinë e riskut gjatë periudhës 2017-2019? Ku ka konsistuar ky bashkëpunim? Lutemi, vini në dispozicion produktet e prodhuara si rezultat i këtij bashkëpunimi
19. Çfarë planesh strategjike apo operacionale janë përgatitur nga DMDTP gjatë periudhës 2017-2019, për menaxhimin dhe vlerësimin e riskut në drejtim të mbledhjes së detyrimeve tatimore

<sup>76</sup> Plani strategjik i DPT, 2017-2021, fq. 12.

<sup>77</sup> Plani strategjik i DPT 2015-2019, fq. 9.

<sup>78</sup> Plani strategjik i DPT, 2017-2021, fq.4.

<sup>79</sup> Plani strategjik i DPT, 2017-2021, fq.4.

<sup>80</sup> Strategjia e përbushjes DPT, 2015-2019. fq.3.

të papaguara që rezultojnë të larta nga viti 2017-2019, si dhe mbi çfarë kriteresh është bërë analiza e riskut ?

20. Cilat aktivitete të menaxhimit të detyrimeve të papaguara tatimore mbështeten nga vlerësimi i riskut?<sup>81</sup>
21. Çfarë politikash janë hartuar dhe propozuar nga DMDTP për të menaxhuar riskun në seleksionimin e rasteve për mbledhje, që mbulojnë periudhën 2017-2019?<sup>82</sup>
22. Si përcaktohet dhe zbatohet masa më e përshtatshme e mbledhjes me forcë, bazuar në riskun e vlerësuar?<sup>83</sup>
23. Si funksionon modeli i segmentimit të tatimpaguesve, në bazë të riskut? Cilat janë segmentet e tatimpaguesve? Si kryhet ndjekja e përmbushjes së detyrimeve tatimore në bazë të riskut?<sup>84</sup>
24. Si është realizuar aktiviteti “Rritja e mundësive për analizën e të dhënave nga burime të ndryshme në vlerësimin e riskut të sjelljes së tatimpaguesve me detyrime të papaguara”, referuar Planit strategjik i DPT, 2017-2021, nënobjektivi 2.3 (Mbledhja efikase dhe efektive e borxhit). Lutemi, vini në dispozicion dokumentet mbështetëse.

#### **E. Bashkëpunim me struktura të tjera në DPT, DRT, publike, ekspertë etj.**

25. A ka struktura të tjera në DPT apo struktura të tjera publike, me të cilat DMDTP bashkëpunon për të menaxhuar mbledhjen e detyrimeve të papaguara tatimore. Lutemi, listoni ato, duke treguar ku konsiston bashkëpunimi.
26. Si ka qenë bashkëpunimi juaj me Drejtorinë e Hetimit Tatimor, për të siguruar zbatimin e masave shtrënguese?<sup>85</sup> Po me Drejtorinë e Kontrollit Tatimor?
27. Si ka qenë bashkëpunimi i Administratës Tatimore me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe ZRPP, për zbatimin e masave shtrënguese? Lutemi listoni problematikat e hasura.
28. A ka raste të ç’regjistrimit të subjekteve pa shlyer detyrimet e papaguara tatimore dhe si është zgjidhur ky problem? Si ka qenë bashkëpunimi me QKB?
29. Aktualisht a mbliidhen detyrimet tatimor të papaguara nëpërmjet personave juridik?<sup>86</sup> Si % e detyrimeve tatimore të papaguara në kohë janë mbledhur me nëpërmjet angazhimit të personave juridik, në raport me ato të mbledhura nga vet administrate tatimore, në secilin prej viteve 2017, 2018, 2019? Vini në dispozicion dokumentet mbështetëse.
30. Cilat janë problematikat që lidhen me mbliidhen e detyrimit tatimor të papaguara nëpërmjet angazhimit të personave juridik?
31. A janë ngritur komitete këshillimore me ekspertë fiskalë etj., në të cilat janë diskutuar sfidat e mbledhjes së detyrimeve të tatimore?<sup>87</sup> Lutemi, vini në dispozicion vërejtjet dhe sugjerimet e marra nga këto komitete, për mbledhjen e borxhit tatimor.
32. A ka patur bashkëpunim me strukturën e Avokatit të Tatimpaguesve në MFE?<sup>88</sup> Lutemi, vini në dispozicion raportet, rekomandimet, informacionet e përcjella në DPT nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesve, në lidhje me mbledhjen e detyrimeve të papaguara tatimore.

---

<sup>81</sup> Rregullorja e brendshme e DPT, neni 108, pika 1.

<sup>82</sup> Rregullorja e brendshme e DPT, neni 110, pika 6.

<sup>83</sup> Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 88, pika 2 dhe 3.

<sup>84</sup> Plani strategjik i DPT 2015-2019, fq. 10.

<sup>85</sup> Manuali i mbledhjes me forcë DPT, pika 4.5.2.

<sup>86</sup> Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 88, pika 4.

<sup>87</sup> Plani Strategjik 2015-2019.

<sup>88</sup> Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 105/2.

## **F. Monitorimi dhe kostot administrative të strukturave përgjegjëse për MDPT**

33. Cilat janë struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të planeve strategjike? Po atyre vjetore?
34. Cila është përbërja e komiteteve drejtuese të reformës, operacioneve dhe përmbushjes?<sup>89</sup> A janë ngritur këto komitete me Urdhëro të posatshtëm? Lutemi vini në dispozicion dokumentet ku përcaktohet përbërja e komiteteve.
35. Cilat janë përgjegjësitë dhe detyrat e secilit prej komiteteve të mësipërme në drejtim të menaxhimit të mbledhjes efektive dhe eficientë të borxhit tatimor? Lutemi, vini në dispozicion minuat e takimit dhe rekomandimet e dala nga këto komitete, në lidhje me mbledhjen e detyrimeve të papagura tatimore në afat.
36. Cfarë aktiviteteve janë ndërmarrë për të “Monitoruar në mënyrë të veçantë ecurinë e stokut të borxhit dhe rishikimi i proceseve të mbledhjes me forcë”?<sup>90</sup> Lutemi, vini në dispozicion produktet e këtij monitorimi.
37. A keni konsultuar dhe zbatuar praktika të për monitorimin e borxhit tatimor apo metodologji bashkëkohore për këtë qëllim? Lutemi vini në dispozicion, praktikat e konsultuara.
38. A është rritur numri i punonjësve të administratës tatimore të cilëve u ngarkohet detyra e mbledhjes me masa shtrënguese?<sup>91</sup> Lutemi, vini në dispozicion të dhëna mbi ecurinë e këtij treguesi për vitet 2016-2019.
39. Lutemi paraqisni në formë tabelare strukturat e menaxhimit të borxhit në DPT dhe në DRT. (Tabela bashkëlidhur, “Monitorimi”)

## **G. C@TS**

40. A menaxhohet në mënyrë të plotë mbledhja e detyrimeve të papaguara tatimore në afat, në sistemin C@TS? Lutemi, përcaktoni listën toatale të aktiviteteve që duhet të menaxhohen, dhe ato që aktualisht kryhen?
41. A është i implementuar në sistem informatik tatimor marrëveshja për pagesë me këste, dhe nëse po çfarë të dhënash përditësohen?
42. Sa ndihmon sistemi IT në strukturat e mbledhjes me forcë në punën e tyre të përditshme? A është praktik për evidentimin, analizën e problemeve dhe marrjen e masave shtrënguese?
43. Ç’mendim keni për përmirësimin e tij në drejtim të rubrikave, a do t’i shërbente më mire krijimi i një portali të veçantë për borxhin tatimor? A ka ndikuar përpunimi me dorë i të dhënave në lidhje me borxhin tatimor në evidencat e përgatitura në DMDTP në DPT në kohë dhe saktësi? Argumentoni.

Për sa më sipër, do të kërkonim nga ana juaj bashkëpunimin maksimal me qëllim realizimin me sukses të këtij misioni auditimi në përfitim të punës së gjithsecilit.

Për çdo paqartësi mund të na kontaktoni personalisht, ose me anë të adresave e-mail: .....

### **Grupi i auditimit:**

M.K (përgjegjëse grupi);

V.S (anëtare);

XH.K (anëtare).

---

<sup>89</sup> Plani strategjik i DPT 2015-2019 fq.3 & 6 dhe Raporti i fundit i FMN.

<sup>90</sup> Plani strategjik i DPT 2017-2022, nënobjektivi 2.3.

<sup>91</sup> Plani strategjik i DPT 2015-2019, fq. 11.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT**

*Adresa: Rr. Abdi Toptani, nr. 1, Tiranë; Tel-Fax: 0694057089*

*E-mail: [mnaco@klsh.org.al](mailto:mnaco@klsh.org.al); Web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)*

Tiranë më 13/07/2020

**MBI AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË**  
**“Ecuria e borxhit tatimor”**

**Lënda:** Intervistë Zyrtare

**Drejtuar:** Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara  
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

**Tiranë**

Në vijim të auditimit të performancës “Ecuria e borxhit tatimor”, kërkojmë nga stafi përgjegjës, përgjigjen me shkrim për pyetjet e kësaj interviste. Në përputhje me dispozitat e nenit 15, pikat dh), e), të ligjit nr. 154/2014 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, grupi i auditimit kërkon përgjigjen zyrtare dhe plotësimin e tabelës bashkëlidhur, së bashkë me dokumentet mbështetëse **brenda datës 20.07.2020.**

**A. Përkufizimi i borxhit/detyrimeve tatimore të papaguara në afat**

1. Në dokumentet rregullatore të DPT, si dhe në ato strategjike përdoret termi “Borxh tatimor”, a ka DPT një përkufizim të përcaktuar për Borxhin tatimor? Lutemi vini në dispozicion dokumentin mbështetës.
2. Çfarë është borxhi tatimor (përcaktoni në mënyrë specifike zërat që e përbëjnë atë)?
3. Çfarë janë “Detyrimet tatimore të papaguara në afat”? A ka DPT një përkufizim të përcaktuar për Detyrimet tatimore të papaguara në afat?
4. Çfarë përfshihen tek Detyrimet tatimore të papaguara në afat? Lutemi vini në dispozicion dokumentin mbështetës.
5. Gjendja e detyrimeve të papaguara në afat prej 107.7 mld lek (publikuar në raportin vjetor 2018 të DPT), dhe gjendja prej 117 mld lek (publikuar në raportin vjetor 2019 të DPT), a përfaqësojnë vetëm detyrimet tatimore, të cilave në dt. 31.12, u ka kaluar afati për tu paguar?
6. A përfshijnë këto vlera të ngrira në dt. 31.12 (referuar pyetjes më lart), edhe detyrime tatimore të cilat e kanë afatin e pagimit pas kësaj date? Nëse po, sa është vlera e detyrimeve tatimore të papaguara në afat në fund të vitit 2018 dhe vitin 2019?
7. Bazuar në cilat dokumente/evidenca përlllogaritet borxhi që deklarohet në fund të vitit?

## **B. Trendi i borxhit, për periudhën 2017-2019**

8. Gjendja e borxhit tatimor (detyrim/gjobë/interes) për çdo DRT, sipas tatimit për 2017.
9. Ecuria e borxhit gjatë viteve sipas llojit të tatimit (duke evidentuar gjendjen në fillim, shtimet, arkëtimet, kthimet për sistemin, falur, në proces gjyqësor, gjendja në fund) për vitin 2017.
10. Moshja e borxhit për çdo DRT, në vlerë, klasifikuar në 0-3 muaj, 3-6 muaj, 6-12 muaj, 1-2 vite, 2-5 vite dhe mbi 5 vite, për vitin 2019.
11. Masat shtrënguese të vendosura dhe të arkëtuara, në nr. rastesh dhe vlerë për çdo DRT, për 2017.
12. Klasifikimi i borxhit tatimor sipas madhësisë<sup>92</sup>, në numër subjektesh dhe sipas statusit.

## **C. Borxhi i pambledhshëm**

13. A janë publikuar çdo vit vlera totale e detyrimeve tatimore të deklaruara si të pambledhshme, numrin i kërkesave në total dhe numrin i kërkesave të pranuar. gjatë periudhës 2017-2019?<sup>93</sup>
14. Lutem vini në dispozicion të dhënat vjetore për periudhën 2017-2019, mbi detyrimet e pambledhshme, numrin e kërkesave në total dhe numrin e kërkesave të pranuar
15. Nëse jo (referuar pyetjes më lart), lutem listoni duke argumentuar arsyet e mospublikimit të borxhit të pambledhshëm.
16. Si bëhet vlerësimi i borxhit si “i pambledhshëm”?
17. A është përgatitur strategjia për shuarjen e detyrimeve të prapambetura që janë të pambledhshme, pas bërjes së ndryshimeve legjislativë?<sup>94</sup> Lutemi vini në dispozicion evidencat mbështetëse.
18. Nëse jo, listoni arsyet duke argumentuar.

## **D. Rekomandimet e FMN**

19. A ka hartuar DPT një plan veprimi për të vendosur në zbatim rekomandimet e FMN për periudhën 2017-2019? Lutemi vini në dispozicion dokumentin mbështetës.

## **E. Plani strategjik dhe planet operacionale**

20. A ka DPT një objektiv/nën objektiv strategjik të matshëm për borxhin tatimor, të deklaruar në dokumentet institucionale? Sa është ky target, dhe kur duhet të arrihet? Lutemi vini në dispozicion dokumentin.
21. Mbi cilat vlerësime është mbështetur vendosja e targetave vjetor 15% për 2018 dhe 10% për 2019<sup>95</sup> për arkëtimin e detyrimeve të papaguara në afat? Lutemi vini në dispozicion analizat përkatëse.
22. Përse në vitin 2019 targeti vjetor për arkëtimin ishte 5% më pak se ai i vitit 2018? Lutemi vini në dispozicion në formë të skanuar, dokumentin origjinal (të miratuar) ku janë të deklaruara targetat vjetor të çdo viti (pra 15% për 2018 dhe 10% për 2019).

---

<sup>92</sup>< 500 leke, 500-10,000, 10,000-50,000, 50,000-500,000, 500,000-1,000,000, 1,000,000-5,000,000, >5,000,000.

<sup>93</sup> Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 103.

<sup>94</sup> Rekomandimi i FMN 2018.

<sup>95</sup> Referuar planeve operacionale të vëna në dispozicion grupit të auditimit nga Stafi i DPT, në vitin 2018 objektiv i vjetor ishte 15 % më shumë arkëtime se në 2017, dhe në 2019-tën, ky objektiv ishte 10% më shumë se në 2018.

23. A ka ndikuar arritja e targetave të mësipërm, reduktimin e borxhit tatimor gjatë periudhës 2017-2019? Argumentoni.
24. Si monitorohet zbatimi i Strategjisë 2017-2021? Në cilin dokument është parashikuar monitorimi i Strategjisë? Lutemi vini në dispozicion dokumentin mbështetës.
25. A janë vlerësuar indikatorët e parashikuar në Planin Strategjik 2017-2021, për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve (të parashikuara në këtë dokument) gjatë periudhës 2017-2019, me qëllim mbledhjen efektive dhe efikase të borxhit tatimor?
  - a. Nëse po, vini në dispozicion indikatorët e përlogaritur për çdo vit 2017-2019.
  - b. Nëse jo, argumenton arsyet e mos përlogaritjes për secilin indikator.

## **F. Borxhi jashtë sistemit**

26. Sa është borxhi që figuron në sistem dhe jashtë sistemit, në totalin e detyrimeve tatimore në fund të viteve 2017, 2018, 2019? Lutemi vini në dispozicion këto vlera, për cdo DRT.
27. Si evidentohet borxhi jashtë sistemit? A ka evidenca për vjetërsinë e tij, strukturën dhe masat shtrënguese të ushtruara për këtë borxh, sipas DRT? Lutemi, vini në dispozicion evidencat.

## **G. Masat shtrënguese**

28. Në sa raste, subjekte dhe vlerë janë zbatuar të gjitha masat shtrënguese në mënyrë shteruese gjatë periudhës 2017-2019, për çdo DRT? Vini në dispozicion materialet mbështetëse.
29. Cilat janë problematikat kryesore të lidhura me “Njoftimin dhe kërkesën për të paguar”?
30. Cilat janë problematikat kryesore të lidhura me aplikimin e masës “Urdhri i Bllokimit Të Llogarive Bankare Të Tatimpaguesit”?
31. Cilat janë problematikat kryesore për aplikimin e secilës prej masave të mëposhtme:
  - “Njoftim Tatimpaguesit për vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor;
  - “Njoftim për vendosjen e Barrës Hipotekore”;
  - “Njoftim për vendosjen e Barrës Siguruese”;
  - “Pezullim të aktivitetit në Doganë”;
  - “Urdhri i sekuestrimit;
  - “ Konfiskimi i pasurisë së sekuestruar”;
  - “ Shitja e pasurisë së sekuestruar”?
32. Cilat janë problematikat kryesore të lidhura me mbledhjen e detyrimit të transferuar?
33. Në sa raste është kërkuar në gjykatë fillimi i procedurës së falimentimit (parashikuar nga neni 104, LPT) gjatë periudhës 2017-2019?
34. Cilat janë problematikat kryesore të lidhura me procedurën e falimentimit?
35. Sa raste i janë dërguar DPD për pezullim të veprimtarisë me qëllim arkëtimin e detyrimeve tatimore gjatë periudhës 2017-2019? Sa prej tyre janë arkëtuar? Vini në dispozicion dokumentacionin për rastet e dërguara dhe arkëtimin për çdo rast.
36. A janë përgatitur qarkore nga DMDTP gjatë periudhës 2017-2019?<sup>96</sup> Lutemi, vini në dispozicion qarkoret e miratuara.

## **H. Marrëveshjet e pagesës me këste**

37. A ka DPT një regjistër përmbledhës për të gjitha marrëveshjet e pagesës me këste<sup>97</sup>, lidhur nga çdo DRT (që përfshinë: numrin gjithsej i kërkesave dhe sa prej tyre aprovuar; detyrimet

<sup>96</sup> Rregullorja e DPT: neni 110, pika 14; neni 111, pika 2&4; neni 112 pika 10; neni 113 pika 4.

<sup>97</sup> Rregullorja e brendshme e DPT, neni 113, pika 3.

total; detyrimi sipas llojit të tatimit; data e lidhjes dhe përfundimit; numri dhe vlera e kësteve; shuma e paguar në fillim; detyrimet koherente; shuma e mbetur në A-M; numri dhe vlera e anuluar sipas A-M, etj.)? A është ky regjistër i përditësuar në mënyrë periodike?

38. Cilat janë problematikat kryesore të konstatuara për zbatimin e marrëveshjet me këste?

39. Cilat janë shqetësimet kryesore që mund të jenë adresuar nga tatimpaguesve?<sup>98</sup>

40. Sa vizita janë kryer në DRT për çdo vit 2017, 2018, 2019 për të monitoruar ecurinë punës dhe performancën e sektorit të marrëveshjeve në DRT-ë? A janë lënë rekomandime për të përmirësuar funksionimin e Sektorit të Marrëveshjeve, si në DRT ashtu dhe DPT?

41. Si i ndiqni rekomandimet e lëna? Lutemi, vini në dispozicion materialet mbështetëse.

42. Si ka qenë performanca e Sektorit të Marrëveshjeve në DRT-ë, referuar analizave të kontrolleve të kryera. A janë nxjerrë përgjegjësit për mangësitë dhe të metat e konstatuara.<sup>99</sup>

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

---

<sup>98</sup> Rregullorja e brendshme e DPT, neni 113, pika 5.

<sup>99</sup> Rregullorja e brendshme e DPT, neni 113, pika 7.